



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 31/2022 regjistër (JR)
Datë 13.07.2022

Nr. 31 i vendimit
Datë 23.04.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 23.04.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Theo Jacobs, me sekretare gjyqësore Anisa Sejdini, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 31/2022 (JR), datë 13.07.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 529, datë 09.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës; nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59, 63 dhe 66, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse si vijon.

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit¹, në të cilin ka konstatuar se: *i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ii. nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii. ka kryer fshehje të pasurisë; iv. ka kryer deklarim të rremë; v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin² në konkluzion të të cilit ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar raportin³ për vlerësimin e aftësive profesionale.

3. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, me vendimin nr. 529, datë 09.05.2022, vendosi “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë*”. Ky vendim u mor bazuar⁴ në nenin 58, pikat 1, shkronja “c” dhe 3, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, mbi konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit: *a) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; b) ka kryer deklarim të rremë të pasurisë dhe veprime fiktive; c) ka kryer fshehje pasurie. Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i tij dhe i personave të lidhur me të, subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve të deklaruara në shumën 12.405.424 lekë, nga e cila 12.347.866 lekë para fillimit të detyrës dhe 57.558 lekë gjatë ushtrimit të detyrës, por pavarësisht se kjo balancë negative është krijuar më së shumti përpara ushtrimit të detyrës, marrë për bazë edhe parimin e proporcionalitetit, konsiderohet nga Komisioni si*

¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 02.07.2019, e ILDKPKI-së.

² Shkresë nr. {***} prot., datë 14.04.2022, e DSIK-së, për përcjelljen e raportit mbi kontrollin e figurës nr. {***} prot., datë 02.03.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. {***}, datë 02.04.2022, të KDZh-së.

³ Shkresë nr. {***} prot., datë 18.01.2019, e Prokurorisë së Përgjithshme, për përcjelljen e raportit me nr. {***} prot., për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

⁴ Referuar bazës ligjore të cituar në vendimin e Komisionit.

më se e mjaftueshme për të vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit Emror Kasaj nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel minimal kualifikues, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

3.4 Komisioni, në një vlerësim tërësor të procesit të rivlerësimit, si dhe të problematikave të konstatuara për secilin kriter rivlerësimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit⁵, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”): “*Prishjen e vendimit nr. 529, datë 09.05.2022 dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me tjetër trup gjykues, ose, ndryshimin e vendimit nr. 529, datë 09.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj*”. Ankimi i subjektit të rivlerësimit, i shoqëruar me dy shtojca⁶, përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave.

5. Shkaqet e ankimit, që i përkasin aspekteve procedurale dhe parimeve të cenuara të procesit të rregullt ligjor, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

5.1 Komisioni ka cenuar parimin e gjykatës së krijuar me ligj, të pavarur dhe të paanshme, pasi dy anëtarë të trupit gjykues nuk plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtarë, sipas nenit 6 të ligjit nr. 84/2016, si dhe për shkak kompetencave të vetë Komisionit në hetimin paraprak të çështjes e njëkohësisht vendimmarrës mbi bazueshmërinë e akuzës;

5.2 Procesi ka qenë i paragjykuar dhe vendimmarrja e paracaktuar, pasi Komisioni ka kryer një hetim të mangët për kriterin e pasurisë, duke u bazuar vetëm te gjetjet e ILDKPKI-së dhe nuk i ka trajtuar provat e mëvonshme të dorëzuara nga ana e tij;

5.3 Është cenuar e drejta e një procesi të rregullt ligjor nga një vendim i paarsyetuar, pasi Komisioni, jo vetëm që nuk ka marrë në trajtim çdo provë dhe nuk ka arsyetuar mbi vlerën e tyre provuese, por edhe ka shtrembëruar e deformuar shpjegimet e provat e paraqitura;

5.4 Komisioni ka cenuar parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, pasi nisur nga rrethanat e provuara të çështjes, vendimi objekt ankimi dhe masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, është jo vetëm i pabazuar në prova, por nuk është as i përshtatshëm dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë;

5.5 Komisioni ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ka trajtuar çështje jashtë periudhës së rivlerësimit, çështje në fazën hetimit dhe gjykimin, si dhe çështje për të cilat ka nisur hetimi

⁵ Ankimi është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 05.07.2022.

⁶ Shtojca 1 e titulluar “Përmbledhje e pretendimeve të ankuesit Emror Kasaj në procesin gjyqësor para KPA-së, për sa iu përket parimeve të cenuara nga ky komision” dhe shtojca 2 e titulluar “Sqarime të hollësishme në lidhje me marrëdhënien time të pronësisë me shtetasin H. A. dhe shtetasin M. L.”.

nga organi kompetent Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”), apo për të cilat ka vendosur gjykata.

6. Shkaqet e ankimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

6.1 *Në lidhje me pasurinë “Tokë arë, me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Tiranë”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: (i) vlera e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m² së bashku me shpenzimet për ndërtimin e objektit 3-katësh në proces legalizimi mbi këtë tokë është 300.000 euro, vlerë e cila nuk është paguar plotësisht; (ii) në mënyrë të gabuar përfshihet si shpenzim i paguar prej tij shuma 2.500.000 lekë për blerjen e gjysmës së sipërfaqes së tokës prej 1.000 m², ndërkohë që vlera e vërtetë e konsideruar e paguar prej tij është 15.000 euro, si shpërblim për angazhimin e tij për gjetjen e një shoqërie ndërtuese; (iii) Komisioni ka gabuar në mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortes nga përkthimi në shumën 986.378 lekë, me arsyen se nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore;*

6.2 *Në lidhje me pasurinë “Banesë dykatëshe, me sipërfaqe 185,8 m² në çdo kat, me sipërfaqe trualli 500 m²”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: (i) nuk ka pasur ndonjë motiv apo interes për të fshehur një pasuri që nuk është bërë me kontributin e tij; (ii) nuk është bashkëkontribuues në ndërtimin e kësaj banese, që t’i ngarkohet si shpenzim gjysma e kostos së banesës; (iii) ndodhet në kushtet nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/206, pasi me gjithë përpjekjet e bëra nuk ka mundur të gjejë të dhënat e sigurimeve shoqërore të babait të tij në shtetin grek;*

6.3 *Në lidhje me huadhënien në shumën 4.300 euro shtetasit A. Sh., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se deklarimi i tij, që si burim krijimi për dhënien e kësaj huaje kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit {***}, përbën një lapsus, pasi realisht burim krijimi janë të ardhurat nga shitja e automjetit me targa të huaja tip Opel Vectra;*

6.4 *Në lidhje me pasurinë “Motoçikletë me targa {***}, prodhim i vitit 2004”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka qenë një harresë e parëndësishme mosdeklarimi si burim krijimi për këtë mjet edhe i vlerës 50.000 lekë nga kursimet e tij;*

6.5 *Në lidhje me pasurinë “Mercedes-Benz me targa {***}, prodhim i vitit 2002”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: (i) konkluzioni se ai si bashkëpronar i këtij automjeti nuk ka kontribut është i gabuar, pasi ai ka paguar doganën dhe detyrimet e mirëmbajtjes dhe se interesi ka qenë i dyanshëm; (ii) Komisioni ka keqinterpretuar me dashje faktet, duke i ngarkuar në bilanc çmimin e referencës 250.000 lekë dhe vlerën e doganës rreth 90.000 lekë;*

6.6 *Në lidhje me huan në shumën 50.000 euro, dhënë shtetasit M. L. dhe në lidhje me detyrimin ndaj nënës së bashkëshortes, znj. L. P., në shumën 50.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: (i) konkluzioni në lidhje me huanë e marrë nga vjehrra është i gabuar, pasi ai ka deklaruar kreditorin e fundit (vjehrrën) dhe debitorin e fundit (M. L.), duke qenë se në datën e deklarimit shoqëria “{***}” ShPK nuk ka qenë më debitor; (ii) përveç kontratës së huasë të lidhur mes tij dhe shtetasit Sh. F., si dhe deklaratës noteriale të këtij të fundit ekzistojnë një sërë provash që provojnë marrëdhënien e huasë; (iii) fakti që i ka marrë paratë prej vjehrrës përmes bankës, provon në mënyrë të padyshimtë ekzistencën e marrëdhënies së huasë; (iv) prindërit e bashkëshortes së tij kanë pasur aftësi paguese për shumën e dhënë hua, pasi kanë ushtruar aktivitet privat që në kohë të hershme; (v) e motra M. E. nuk është “person i lidhur” i tij, pasi mes tyre nuk ka marrëdhënie interesi;*

6.7 *Në lidhje me analizën financiare, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: (i) Komisioni ka*

llogaritur në mënyrë të gabuar shpenzime qiraje në shumën 180.000 lekë për vitin 2016, ndërkohë që ai është larguar nga banesa me qira në Rugën e Durrësit për në Yzberisht që në shtator të vitit 2015; (ii) shuma prej 2.000 USD e marrë hua nga tezja nuk duhet përfshirë në bilanc, pasi nuk i përket subjektit, por nënës së tij, e cila i ka përdorur për mobilimin e shtëpisë; si dhe (iii) Komisioni ka gabuar në llogaritjen e shpenzimeve gjyqësore në vlerën 1.402.100 lekë.

7. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionet e Komisionit në lidhje me pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, dy çështjet penale të referuara nga denoncimet e publikut, si dhe tri çështje penale të analizuara mbi bazën e indicieve nga mjete të informimit publik.
8. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur ankimit disa akte shkresore⁷, për të cilat i kërkon Kolegjit të merren në shqyrtim dhe të vlerësohen në cilësinë e provës. Më datë 28.03.2025, subjekti i rivlerësimit ka depozituar parashtrime shtesë regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.03.2025 dhe kërkesë për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe shqyrtimin e çështjes në seancë publike, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.03.2025, me qëllim marrjen e provave të reja të paraqitura bashkëlidhur kësaj kërkesë.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është

⁷ (i) fatura tatimore të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA (në vijim "OShEE") të muajve janar- dhjetor 2016, për kontratat nr. {***} dhe nr. {***}, në emër të Emror Kasaj me adresë rruga "{***}", Tiranë; (ii) printim tekst mesazhi telefonik (SMS) që mban datën 10.05.2022; (iii) komunikim elektronik i datës 23.03.2022, për njoftimin e subjektit për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit; (iv) kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.09.2006, me qiradhënë B. F. dhe qiramarrës K. P.; (v) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 01.07.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar subjektit, e shoqëruar me 4 (katër) listëpagesa dhe 5 (pesë) fatura tatimore; (vi) prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2022, në gjuhën shqipe dhe greke, për autorizimin e avokatit grek A. S., si përfaqësues i posaçëm i të përfaqësuarit Emror Kasaj; (vii) vërtetime për bazën e vlerësuar të datës 02.04.2022 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim "ISSh"), për shtetasit A. G., A. N. dhe E. M., punonjës të Drejtorisë së Policisë; (viii) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 25.11.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë (në vijim "DRT Vlorë") drejtuar znj. L. P..

depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 529, datë 09.05.2022, të Komisionit, për shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit Emror Kasaj, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
12. Trupi gjykues, fillimisht, mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit, që do të cenonte procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si vijon.
13. *Komisioni ka cenuar parimin e gjykatës së krijuar me ligj, të pavarur dhe të paanshme*, argumentuar me faktin se dy anëtarët e trupit gjykues O. K. dhe V. S. nuk i plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtar, sipas nenit 6 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri O. K. pretendohet nga subjekti se ka qenë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale “Shpërdorim detyre”, sipas vendimit nr. {***}, datë 07.05.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa komisionerja V. S. është vlerësuar me vetëm 85 pikë në konkursin e Shkollës së Magjistraturës në vitin 1997, kur në atë konkurim magjistratët fitues kanë qenë mbi 300 pikë, dhe se është proceduar penalisht mbi bazën e një kallëzimi penal të KLSH-së, fakte që nuk janë bërë prezente gjatë fazës së kandidimit të tyre si komisionerë. Komisioni, sipas tij, nuk i plotëson kushtet për të qenë *gjykatë e krijuar me ligj dhe e paanshme*, edhe për shkak të kompetencave në hetimin paraprak të çështjes e njëkohësisht vendimmarrës mbi bazueshmërinë e akuzës, duke sjellë në vëmendje parimin e së drejtës *nemo potest esse simul actor et iudex* (që do të thotë se askush nuk mund të jetë në të njëjtën kohë paditësi dhe gjykatësi). Në mbështetje të pretendimit mbi mosplotësimin e kriterëve për të qenë gjyqtar nga ana e anëtarëve të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me parashtrimet e datës 28.03.2025 disa akte shkresore⁸ lidhur me anëtarin e trupit gjykues, komisionerin O. K..

13.1 Trupi gjykues çmon se këto pretendime, të pangritura në ndonjë fazë të procesit të rivlerësimit në Komision, lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit në rivlerësimin e subjektit individualisht. Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji⁹, në të njëjtën linjë me GjEDNj-në¹⁰, duke i analizuar dhe vlerësuar këto pretendime në disa këndvështrime, nën dritën

⁸ Kërkesë e datës 23.01.2025 dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 03.02.2025, e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për dërgimin e vendimit penal nr. {***}, datë 07.05.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; kërkesë e datës 23.01.2025 dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.02.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dërgimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2011.

⁹ Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 43, datë 15.11.2022, (JR) nr. 3, datë 06.02.2023 dhe (JR) nr. 54, datë 19.12.2023.

¹⁰ Vendimet e GjEDNj-së, çështja Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë, çështja Besnik Cani kundër Shqipërisë, çështja Sevdari kundër Shqipërisë, si dhe çështja Admir Thanza kundër Shqipërisë.

e garancive procedurale që gëzon subjekti i rivlerësimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe jurisprudencës së GjEDNJ-së, ndër të tjera, çështjet *Astradsson kundër Islandës dhe B. Cani kundër Shqipërisë*. Konkretisht, në rastin e trajtimit të pretendimeve analoge, Kolegji ka vlerësuar si vijon: [...] trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNJ-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj [...]. Bazuar në këtë arsyetim, edhe aktet shpresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj në lidhje me anëtarin e trupit gjykues O. K., përpos faktit se nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas së cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, në vlerësimin e trupit gjykues u gjetën të panevojshme për zgjidhjen përfundimtare edhe vlerësuar nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016¹¹.

13.2 Kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit kalimtar, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe kreu VII “Procedura e rivlerësimit”, ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit, konfirmuar ky qëndrim edhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit. Përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNJ-së, në drejtim të garantimit të paanësisë dhe pavarësisë është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e, së fundi, është konfirmuar edhe nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNJ-ja në vendimin që i përket *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, përmes konkluzionit se institucionet e krijuara për të kryer rivlerësimin përmbushin garancitë e sanksionuara nga KEDNJ-ja, për sa i përket gjykatës së krijuar me ligj. Në të njëjtën mënyrë ka konkluduar edhe Kolegji në

¹¹ Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: “a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”.

jurisprudencën e deritanishme¹² në analizën e pretendimeve të ngjashme nga subjekte të tjera rivlerësimi.

14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *procesi i rivlerësimit ka qenë i paragjykuar dhe vendimmarrja e paracaktuar*, për arsye se Komisioni ka kryer një hetim të mangët për kriterin e pasurisë, duke u bazuar vetëm te gjetjet e ILDKPKI-së dhe nuk i ka trajtuar provat e mëvonshme të dorëzuara nga ana e tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, megjithëse vendosi të riçelë hetimin edhe për dy kriteret e tjera, nuk kreu asnjë hetim apo ndryshim qëndrimi për kriterin pasuror, duke vendosur përsëri shkarkimin e subjektit mbi konkluzionet për këtë kriter. Paragjykimin e procesit të tij, subjekti i rivlerësimit e lidh edhe me sulmet e pandërprera nga emisioni investigativ “{***}” në televizionin {***} dhe lajmeve në portalin {***}, pronari i të cilit ka qenë në cilësinë e avokatit apo të pandehurit në disa çështje penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

14.1 Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues vëren se Komisioni ka marrë në analizë gjatë procesit të rivlerësimit, jo vetëm aktet e administruara nga ILDKPKI-ja dhe raportin me gjetjet e këtij institucioni, por edhe provat shkresore/dokumente të administruara nga organet publike dhe private, shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe fizike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, duke kryer një hetim më të detajuar nga ai i ILDKPKI-së, në përputhje me interpretimin pajtues të mbajtur në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese, mbi rolin e raporteve të organeve ndihmëse në procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se procesi i rivlerësimit në rastin konkret ka nisur me shortimin e tij më datë 16.12.2019¹³ dhe, në një hark kohor prej të paktën 2 (dy) vjet e 2 (dy) muaj nga kjo datë, deri në datën e përfundimit të hetimit administrativ më 14.02.2022, Komisioni ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me subjektin e rivlerësimit përmes dërgimit të 4 (katër) pyetësorëve dhe administrimit të shpjegimeve të subjektit lidhur me to. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni ka administruar të gjitha dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk rezulton të ketë refuzuar ndonjë prej tyre, rast në të cilin do t'i kishte lindur edhe detyrimi për të argumentuar shkaqet e refuzimit të tyre, sipas përcaktimeve të nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se Komisioni, pasi dëgjoi shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 17.03.2022 dhe administroi provat e paraqitura nga subjekti në këtë seancë në lidhje me kriterin e pasurisë, me vendimin e datës 23.03.2022, ka vendosur të riçelë hetimin administrativ për kriterin e pasurisë, si dhe të pranojë kërkesën¹⁴ e subjektit për përfshirjen e dy komponentëve të tjerë të rivlerësimit duke riçelur hetimin për to. Si pasojë e vendimmarrjes për riçeljen e hetimit administrativ, subjektit i është dhënë mundësia të paraqesë prova e prapësime shtesë për të tria kriteret, si dhe të dëgjohet në seancën dëgjimore të radhës të datës 05.05.2022. Pas administrimit e analizimit të provave të paraqitura nga subjekti në lidhje me kriteret e vlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni ka përmbushur edhe detyrimin ligjor, duke i kaluar sërish barrën e provës subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Kjo veprimtari procedurale e Komisionit, e shtrirë në një hark kohor me ndërveprim aktiv të subjektit, duke iu garantuar të gjitha të drejtat procedurale për një proces të rregullt ligjor, dëshmon se ka qenë kohë më se e mjaftueshme për Komisionin për të

¹² Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 4, datë 09.02.2021 dhe (JR) nr. 29, datë 27.06.2024.

¹³ <https://kpk.al/njoftim-per-shortin-e-dates-16-dhjetor-2019/19/>

¹⁴ Me kërkesën nr. {***} prot., datë 01.03.2022, subjekti i ka kërkuar Komisionit administrimin e provave të reja bashkëlidhur prapësimeve, si dhe çeljen e hetimit gjyqësor për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë profesional.

pasur një vendimmarrje pa paragjykime.

14.2 Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson, gjithashtu, të sjellë në vëmendje jurisprudencën e GjEDNj-së, e cila, në lidhje me paanësinë objektive, ka mbajtur qëndrimin se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete, nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor¹⁵. Ndërsa në çështjen *Craxi kundër Italisë*, 2003, GjEDNj-ja është shprehur se: *Në një kuptim të përgjithshëm, gjyqtarët nuk mund të funksionojnë në një vakum: megjithëse ata kanë në kompetencë të vendosin mbi fajësinë ose pafajësinë e një të akuzuari, nuk rrjedh nga kjo që, çështjet për të cilat ata janë vënë në dijeni, nuk mund të diskutohen, qoftë në revista të specializuara, në shtypin kryesor ose në publik. Me kusht që të mos tejkalohen kufijtë e caktuar për një administrim të mirë të drejtësisë, publiciteti i raporteve të procedurave gjyqësore, duke përfshirë dhe komentet e palëve, janë të pajtueshme me nevojën e publicitetit për seancën gjyqësore, përcaktuar në nenin 6/1 të Konventës. Funksionit të medias, që konsiston në komunikimin e këtyre informacioneve, i shtohet e drejta e publikut për t'i marrë këto informacione. Kjo është edhe më e vërtetë kur procesi, siç është rasti në fjalë, është për një person të njohur, një ish-kryeministër. Këta njerëz, në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije, ekspozohen ndaj një kontrolli të vëmendshëm, si nga gazetarët, ashtu edhe nga masa e qytetarëve. [...] Është e paevitueshme në një shoqëri demokratike, që shtypi, në disa raste të bëjë komente të ashpra mbi një çështje të ndjeshme si kjo në fjalë, e cila vë në pikëpyetje etikën e funksionarëve të lartë publikë dhe raportet mes botës politike dhe asaj të biznesit. Nën dritën e kësaj jurisprudence, por edhe vetë qëllimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se interesi i medias për procesin e rivlerësimit ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve është më se i kuptueshëm, ndërsa Komisioni vendos bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme. Sa i takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për sulme të pandërprera ndaj tij nga emisioni investigativ në fjalë, në vlerësimin e trupit gjykues, janë çështje që nuk lidhen me procesin e rivlerësimit e, për pasojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga ana e tij.*

15. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *i është cenuar e drejta e një procesi të rregullt ligjor nga një vendim i paarsyetuar*, pasi Komisioni, jo vetëm që nuk ka marrë në trajtim çdo provë dhe nuk ka arsyetuar mbi vlerën e tyre provuese, por edhe ka shtrembëruar e deformuar shpjegimet e provat e paraqitura e, për këtë arsye, i kërkon Kolegjit të lexojë vetë dhe të rishqyrtojë nga e para të gjitha provat e paraqitura e të dorëzuara prej tij në Komision dhe në seancë dëgjimore. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë provat e tërthorta në mungesë të provave të drejtpërdrejta, sipas rregullave procedurale civile apo penale, ndër të cilat raportin financiar të kryer nga eksperti privat. Në argumentimin e këtyre pretendimeve, subjekti ka referuar në ankim edhe disa vendime të Komisionit të formës së prerë¹⁶, si dhe ka cituar për çdo pasuri të analizuar në pjesën e kriterit të pasurisë, provat e paraqitura dhe të administruara nga Komisioni, që, sipas tij, nuk janë marrë në konsideratë, duke u përjashtuar nga analiza e provueshmërisë.

¹⁵ Vendimin *Hauschildt kundër Danimarkës*, datë 24.05.1989; vendimin *Fey kundër Austrisë*, datë 24.02.1993; Vendimin *Gautrin e të tjerë kundër Francës*, datë 20.05.1998.

¹⁶ Vendimet nr. 91, datë 20.12.2018; nr. 153, datë 07.06.2019; nr. 188, datë 24.07.2019; nr. 20, datë 04.06.2018.

15.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, veç sa argumentuar më lart në paragrafin 14.1, trupi gjykues vëren se vendimi i Komisionit përmban në tërësinë e tij, analizën e shpjegimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, duke mbajtur qëndrim për vlerën apo efektin që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas së cilit *organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ*. Fakti që në vendimin e Komisionit nuk janë cituar në mënyrë analitike të gjitha shpjegimet apo aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si pasojë edhe e një volumi të madh të dhënash që Komisioni administron gjatë hetimit administrativ apo fakti që Komisioni nuk ka mbështetur në vendimin e tij pretendimet e subjektit, të cilin ai ka menduar se e ka provuar me provat e sjella, nuk dëshmon për mungesë të analizës së provave e shpjegimeve apo *apriori* një vlerësim të gabuar të tyre, por një analizë që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga qëndrimet e subjektit. Po ajo që është e rëndësishme dhe duhet garantuar, lidhet me moscenimin e vërtetësisë së deklarimeve dhe mosnxjerrjes së tyre jashtë kontekstit, në të cilat ato janë bërë. Në rastin konkret nga analizimi i përmbajtjes së vendimit, trupit gjykues nuk i rezulton që shpjegimet e subjektit të paraqitura në mënyrë të përmbledhur nga Komisioni të krijojnë ndonjë imazh të deformuar të tyre. Sa i takon raportit financiar të ekspertit privat¹⁷, të cituar nga subjekti në ankim, veç sa arsyetuar më lart në këtë paragraf, trupi gjykues vlerëson se akti i ekspertimit në vetvete nuk ka një vlerë provuese në procesin e vendimmarrjes, për sa kohë që ekspertja private është bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion nga vetë subjekti i rivlerësimit, të cilat nuk janë të ndryshme nga ato të administruara në dosjen gjyqësore e që i janë nënshtruar hetimit administrativ në Komision dhe verifikimit në Kolegj, për sa kohë studimin e dosjes nga pikëpamja ligjore e financiare /ekonomike, Komisioni e kryen përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor. Lidhur me pretendimet për mënyrën se si Komisioni ka analizuar provat, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se nën dritën e parashikimit të pikës 4, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i provave përfaqëson në thelb autoritetin e Komisionit për marrjen e vendimit, bazuar në dokumente të njohura, të besueshme dhe në pajtueshmëri me provat e tjera, vlerësim që në çdo rast nuk lë jashtë provat e tërthorta. Edhe nëse do të prezumohej e provuar që konkluzionet e Komisionit janë jo të bazuara siç pretendon subjekti, për sa vendimi i nënshtrohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, të gjithë pretendimet dhe kërkimet e tij në këtë drejtim do të zgjidhen nëpërmjet vendimit përfundimtar të Kolegjit. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për cenim të procesit të rregullt ligjor, bazuar vetëm në mënyrën dhe peshën që Komisioni u ka dhënë provave të ndryshme, vlerësohen të pabazuara.

15.2 Sa i takon vendimeve të formës së prerë të referuara nga subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese, vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi, në përputhje edhe me nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: *“Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor”*. Nuk është roli i Kolegjit, madje edhe në rastet që në pamje të parë duken të krahasueshme ose të ngjashme, në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura në to, të krahasojë vendimet e ndryshme të dhëna nga Komisioni, për subjekte të

¹⁷ Subjekti i rivlerësimit ka depozituar me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit akt ekspertimi për analizën e pasurisë dhe të ardhurave për periudhën 01.02.2000 – 31.12.2010, të përgatitur nga audituese ligjore A. P., si dhe akt ekspertimi teknik të datës 28.02.2022 të përgatitur nga ing & vpp E. L..

ndryshme. Çdo vendimmarrje e ankimuar e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, bazuar në veçantitë e fakteve të dala nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike.

16. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni ka cenuar parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka argumentuar se vendimi objekt ankimi nuk ishte i nevojshëm e as i përshtatshëm për arritjen e qëllimit të përcaktuar në ligj, për më tepër që masa e shkarkimit është masa më e rëndë, e cila cenon thelbin e të drejtave dhe interesave legjitime të ankuesit, kur qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është në thelb skualifikimi i subjekteve që mund të kenë nivel të ulët besueshmërie në secilin nga kriteret themelore të këtij procesi rivlerësimi. Shkarkimi nga detyra për pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 është krejtësisht i pabazuar në prova dhe në fakte dhe është rezultat i një keqinterpretimi me dashje i situatës, ndërsa aplikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 kërkon, jo vetëm vlerësimin tërësor të të tria kriterëve të vlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e këtij ligji, por edhe që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, për shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit të parashikuara prej nenit 61, pikat 1,2,3 e 4 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni nuk ka arsyetuar mbi ç‘kriter ka konstatuar cenimin e besimit të publikut apo mbi ekzistencën e mangësive të rënda dhe të dukshme në aspektin profesional dhe pamundësinë e plotësimit të tyre përmes programit trajnues. Një tjetër argument i subjektit në drejtim të cenimit të parimeve të mësipërme lidhet me vlerësimin e tij se edhe nëse gjetjet në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale do të qëndronin ato nuk janë vlerësuar në harmoni me gjithë punën e bërë prej tij në cilësinë e prokurorit për rreth 6 vjet e gjysmë në Prokurorinë e Rrethit Gjykostrës, kohë në të cilën kjo prokurori ka funksionuar me dy ose tre prokurorë, ndërkohë që duhet të kishte shtatë prokurorë, fakt që e ka bërë ngarkesën e punës krejtësisht të papërballueshme.

16.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar dispozitave të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, çmon se aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, i referohet vlerësimit tërësor të çështjes dhe synon që masa disiplinore e dhënë, të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara, dhe e bazuar vetëm në standarde objektive. Në vendimin objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u kualifikuar në 4 (katër) nga situatat e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, dhe në një vlerësim tërësor ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr.84/2016. Siç do të shtjellohet rast pas rasti në vijim të këtij vendimi, këto shkelje, qoftë më vete apo në vlerësimin harmonik dhe të përgjithshëm të tyre, vlerësohen nga trupi gjykues si të tilla që nuk lejojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Sa i takon aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sikurse shtjelluar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, dispozitat e ligjit nr. 84/2016 nuk e lidhin aplikimin e këtij konkluzioni në formë kumulative me secilin prej kriterëve. Në mbështetje të këtij qëndrimi, në rastin objekt gjykimi trupi gjykues vëren se cenimi i besimit të publikut të drejtësia lidhet me vlerësimin tërësor të problematikave të evidentuara në kriterin e kontrollit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale për shkaqe që nuk janë përfshirë në vlerësimin autonom të secilit kriter. Këto problematika do të vlerësohen nga trupi gjykues në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, për të konkluduar në përfundim të shqyrtimit të saj, nëse

mangësitë në këto dy kritere së bashku, do të jenë të mjaftueshme për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni ka shkelur parimin e sigurisë juridike*, duke argumentuar se: (i) ka trajtuar dhe ka konkluduar për çështje jashtë periudhës së vlerësimit të përcaktuar në nenin 41 të ligjit nr. 84/2016; (ii) një pjesë e këtyre çështjeve është ende në fazën e hetimit dhe gjykimin, fakt që bën të zbatueshëm nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, referuar edhe vendimit nr. 33, datë 03.11.2021, të Kolegjit; (iii) për këto çështje, pas publikimit të tyre nga palët që kanë interes për mënyrën e përfundimit të saj, ka filluar hetimi nga organi kompetent ILD, raporti i të cilave do t'i paraqitet prej tij Kolegjit sapo ai të njoftohet lidhur me to; (iv) për këto çështje ka vendosur gjykata si i vetmi organ që jep drejtësi dhe që konkluzioni i saj është i detyrueshëm për gjithë shtetasit dhe organet shtetërore, qoftë ky edhe Komisioni, dhe nuk mund të vihet në diskutim më vonë nga këta të fundit.

17.1 Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues sjell në vëmendje se situatat e evidentuara më sipër gjejnë rregullim të plotë, jo vetëm në kuadrin kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit, por edhe në jurisprudencën e Kolegjit. Konkretisht, neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit të subjektit. Edhe Gjykata Kushtetuese, në kuadër të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë dispozitë, ka arsyetuar se: “[...] *Megjithatë, edhe pse ky nen, në pikën 4 ka parashikuar shtrirjen e këtij vlerësimi për një periudhë më të gjatë kohore, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet, kjo dispozitë duhet të zbatohet vetëm në raste përjashtimore dhe në bazë të një vendimi të marrë gjithashtu nga organet e reja kushtetuese të rivlerësimit. Po ashtu, sipas kësaj dispozite, edhe në raste të tilla informacionet merren parasysh nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit*”. Gjithashtu, në një qëndrim të konsoliduar tashmë¹⁸, Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se [...] *Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Kolegji sjell në vëmendje se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, Kolegji çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: “*Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet*”, dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Zbatueshmëria e këtyre dispozitave, në rastin konkret, do të jenë objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, lidhur me çështjet penale të marra në analizë nga Komisioni.

18. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për shkelje procedurale dhe për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të

¹⁸ Vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019 dhe nr. 16/2020 (JR), datë 13.07.2020.

procesit të rivlerësimit në Komision, u gjetën të pabazuara në fakte e në ligj. Për rrjedhojë, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve.

19. Në lidhje me aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit së bashku me ankimin, edhe pse jo plotësisht në formën e duhur ligjore, trupi gjykues konstaton se një pjesë e tyre¹⁹ janë akte të administruara nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit dhe përmbajnë fakte të njohura për të e, për këtë arsye, nuk mund të cilësohen si prova të reja, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Aktet e tjera të depozituara bashkëlidhur ankimit²⁰, megjithëse paraqiten për herë të parë në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar apo as argumentuar pamundësinë e paraqitjes së këtyre akteve që në fazën e hetimit administrativ në Komision, që do të lejonte kalimin e testit të vendosur nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012. Pavarësisht mosplotësimit të këtij kriteri formal, nga analiza e këtyre akteve në raport me faktet që subjekti kërkon të provojë, siç shtjellohet në vijim të vendimit sipas shkaqeve respektive të ankimit, këto akte nuk kapërcejnë as kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e tyre duket e panevojshme apo pretendojnë të provojnë fakte që edhe nëse pranohen të vërteta nuk ndikojnë në vendimmarrjen përfundimtare. Sa i takon aktit tjetër²¹, të paraqitur nga subjekti në funksion të shkaqeve të ankimit që lidhen me pasurinë tokë me sipërfaqe 1.000 m² dhe objekt me 3-kate ndërtuar mbi të, ndonëse përbën një fakt të ndodhur pas përfundimit të procesit të rivlerësimit në Komision, analizuar nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet si një provë e panevojshme për sa kohë që një akt i tillë nuk provon as çmimin e shitjes së pasurisë në kuptim të dispozitave të Kodit Civil e as faktin nëse ky çmim është paguar ose jo.
20. Pas njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj në datën 28.03.2025, parashtrime me shkrim dhe kërkesë “Për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe shqyrtimin e çështjes në seancë publike, me qëllim marrjen e provave të reja”, bashkëlidhur të cilës ka paraqitur akte shkresore, një pjesë e të cilave gjenden në dokumentacionin e administruar nga Komisioni ose janë paraqitur së bashku me ankimin. Aktet e tjera të paraqitura për herë të parë nga subjekti, trupi gjykues vendosi të mos i pranojë në cilësinë e provës, pasi vlerësoi se bazuar në nenet 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në këtë fazë të procesit, palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo fakte dhe prova të reja.
21. Për sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit. Për këtë arsye, shqyrtimi i ankimit të subjektit u zhvillua në dhomë këshillimi në bazë dokumentesh.

¹⁹ Komunikim elektronik i Komisionit i datës 23.03.2022, për njoftimin mbi riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, si dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 01.07.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar subjektit e shoqëruar me listëpagesa dhe fatura tatimore.

²⁰ Fatura tatimore të OShEE-së të muajve janar- dhjetor 2016, për kontratat nr. {***} dhe nr. {***}, në emër të Emror Kasaj; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.09.2006, me qiradhënës B. F. dhe qiramarrës K. P.; prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2022, në gjuhën shqipe dhe greke, për autorizimin e avokatit grek A. S.; vërtetime për bazën e vlerësuar të datës 02.04.2022, të ISSh-së të shtetasve A. G., A. N. dhe E. M.; shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 25.11.2021, e DRT-së Vlorë, drejtuar znj. L. P..

²¹ Printim mesazhi telefonik (SMS) i datës 10.05.2022.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

Pasuria “Tokë arë, me sipërfaqe 1.000 m², në {*}, Tiranë, në bashkëpronësi me shtetasin M. L.”**

22. Në përfundim të kontrollit dhe vlerësimit të kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: (i) Problematikat e konstatuara, në lidhje me vlerën e pasurisë tokë arë me sip. 1.000 m² dhe ndërtesë 3-katëshe mbi të, si dhe ndryshimi i deklarimit të subjektit gjatë hetimit, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, krijojnë bindjen se subjekti ka bërë deklarim të rremë në lidhje me vlerën reale të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, duke e vendosur në kushtet e gërmës “ç”, pika 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Tërësia e veprimeve dhe e deklarimeve të subjektit në lidhje me këtë pasuri, si dhe vlerësimi i provave të siguruara, pavarësisht se kemi të bëjmë me një pasuri të krijuar përpara se subjekti të bëhej prokuror, por të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, krijojnë bindjen e Komisionit se nga ana e subjektit janë konsumuar sjellje jo të përshtatshme dhe jo etike që kanë cenuar besimin e publikut te drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
23. Nga kontrolli i arsyetimit të vendimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni konkluzionin e mësipërm ia atribuon: (i) deklarimeve kontradiktore në lidhje me vlerën e pasurisë, pagesën e saj dhe burimin e krijimit, duke iu referuar deklaratës së pasurisë vetting, deklaratave të interesave private periodike (në vijim “DIPP”), deklarimeve gjatë hetimit administrativ, si dhe dokumentit “Sqarim ankese” drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti mbi këtë dokument; (ii) mungesës së besueshmërisë së çmimit total të pasurive (tokë arë me sipërfaqe 1.000 m² dhe ndërtesë 3-katëshe mbi të) në vlerën 300.000 euro dhe faktit se subjekti nuk e ka paguar pjesën e tij prej 150.000 eurosh; (iii) mungesës së logjikës ekonomike e të qenit pronar me ½ pjesë i një pasurie me vlerë të pranuar prej 300.000 eurosh, për të cilën nuk është paguar asnjë vlerë monetare prej tij; (iv) mungesës së provueshmërisë me dokumentacion ligjor të pagesës së tatimit në burim për të ardhurat nga paga të bashkëshortes E. K., në shumën 746.378 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit dhe argumentet e përdorura prej tij, duke parashtruar në ankim disa pretendime që trajtohen në vijim.
24. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m² së bashku me shpenzimet e vlerësuara nga palët blerës-shitës për ndërtimin e objektit trekatësh në proces legalizimi ndërtuar mbi këtë sipërfaqe toke, është 300.000 euro dhe jo 5.000.000 lekë, por ai nuk e ka paguar pjesën e tij takuese të çmimit prej 150.000 euro, duke konsideruar të paguar nga kjo vlerë vetëm shumën prej 15.000 euro ose 2.100.000 lekë (5% e çmimit të shitjes) si shpërblim i caktuar nga shitësi për gjetjen e një shoqërie ndërtimi për të zhvilluar pronën e këtij të fundit. Edhe kjo e fundit pretendohet se nuk është paguar cash, por është rezultat i shuarjes së detyrimeve reciproke në masën e detyrimit më të vogël, sipas parashikimeve të kapitullit 4 “Shuarja e detyrimeve”, neni 514 “Kompensimi” të Kodit Civil. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka argumentuar se çmimi i pasurisë në këtë vlerë (por jo fakti se ky çmim është paguar plotësisht apo se ai ka paguar pjesën e tij takuese në vlerën 150.000 euro), provohet qoftë edhe në mënyrë të tërthortë nga provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ,

të cilat nuk janë interpretuar saktë²² ose nuk janë trajtuar²³ nga Komisioni. Lidhur me dokumentin “sqarim ankese” drejtuar Ministrit të Drejtësisë, subjekti ka shpjeguar se ky është i vetmi dokument në të cilin deklarohet pagesa e gjithë shumës, por Komisioni nuk ka marrë parasysh rrethanat objektive mbi marrëdhëniet e tij me ish-ministrin në atë kohë.

25. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori fillimisht në analizë deklaratimet e tij²⁴ në momente të ndryshme, sa i përket vlerës së pasurisë objekt shqyrtimi dhe pagimit të saj, nga ku rezultoi si më poshtë.

25.1 Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Arë me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Tiranë, nr. pasurie {***}, vol. {***}, fq. {***}, z.k. {***}, në bashkëpronësi me M. L.. Blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2013, me çmim total 5.000.000 lekë. Mbi këtë sipërfaqe ndodhet një objekt në proces legalizimi, për të cilin është lëshuar deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2013. Burimi: Kursimet e mija dhe të bashkëshortes ndër vite. Vlera: 2.500.000 lekë. Pjesa: 50%*”. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka bashkëlidhur: (i) kontratë shitje toke bujqësore me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 25.03.2010, sipas së cilës Emror Kasaj dhe M. L. kanë blerë nga H. A. dhe Z. A., pasurinë me nr. {***}, vol. {***}, fq. {***}, z.k. {***}, tokë “arë”, me sip. totale 1.000 m²”, ndodhur në {***}, Tiranë, me çmim 5.000.000 lekë, shumë e cila i dorëzohet shitësit në praninë e noterit dhe blerësit bëhen bashkëpronarë me nga 1/2 pjesë takuese; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***} e datës 26.03.2010 dhe kartelë pasurie, sipas së cilave pasuria me nr. {***}, e llojit “arë”, me sipërfaqe 1.000 m², ndodhur në {***}, është regjistruar më datë 26.03.2010 në bashkëpronësi të Emror Kasaj dhe M. L. me nga ½ pjesë takuese;

25.2 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës për vitin 2015 (në vijim “DIPPFĐ e vitit 2015”), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Arë me sipërfaqe 1.000 m², {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, vol. {***}, fq. {***}, zotëroj 50%. Blerë me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2013, me çmim 5.000.000 lekë (Mbi këtë tokë është ndërtuar një objekt*

²² Video e emisionit “{***}”, në faqen youtube në internet, e titulluar “prokurori që ka mashtruar dy palë”; ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 27.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi nr. {***} akti., datë 15.02.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***} të vitit 2019; vendimi nr. {***}, datë 29.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dy draft kontratat e noteres D. K..

²³ Dosja nr. {***}, datë 02.02.2010, e Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror; urdhër sekuestrimi nr. {***} prot., datë 03.03.2010, e DRT-së Tiranë, sektori i mbledhjes së borxheve; kartelë e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m² në pronësi të H. A.; vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. {***}, datë 30.11.2010, për sigurimin e padisë dhe vendim nr. {***}, datë 09.02.2011, të Gjykatës së Apelit; kontratë huaje ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë {***} ShPK”; deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2021; material audio dhe i transkriptuar i bisedës së datës 09.12.2010 ndërmjet subjektit dhe shtetasit M. L.; pjesë e marrë nga faqja e internetit google ku pasqyrohet lajmi i gazetës “{***}” i datës 26.07.2012; kërkesë e datës 06.12.2010, për ekzekutimin e vendimit të gjykatës nr. {***}, datë 30.11.2010; kërkesëpadi e shtetasve H. dhe Z. A. datë 27.12.2010; kundërpadi e datës 23.07.2012 e shtetasve Emror Kasaj dhe M. L.; kërkesë ankimore, datë 19.02.2013, e vëllezërve A. drejtuar Prokurorit të Rrethit Tiranë, z. A. K.; ankim i datës 04.06.2013, ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. {***}, datë 27.05.2013; vendim nr. {***}, datë 26.11.2013, i Gjykatës së Apelit; kallëzim penal i datës 02.09.2010, i shtetasit H. A. ndaj shtetasve Emror Kasaj dhe M. L.; kallëzim penal, datë 09.12.2010, i Emror Kasaj ndaj D. A. etj.; vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, datë 20.11.2010.

²⁴ Subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2004, me emërimin në detyrën e Oficerit të Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”), pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 01.02.2000 dhe ka dorëzuar me datë 09.06.2004 deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, si dhe DIPF-në e vitit 2004 në datën 04.03.2005. Në datën 02.11.2015, ai është emëruar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë Gjyrokastër dhe ka plotësuar DIPFD-në e vitit 2015.

në proces legalizimi blerë me deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2013). Burimi kursimet e mia dhe të bashkëshortes ndër vite. Vlera: 2.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %”. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më datë 22.09.2016²⁵, subjekti ka konfirmuar të njëjtin deklaram duke korrektuar datën e kontratës nga 25.03.2013 më 25.03.2010;

25.3 Nga aktet në fashikull të administruara në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se në të njëjtën datë me kontratën e shitblerjes së lartcitur, palët kontraktore H. A., Z. A., Emror Kasaj dhe M. L. kanë nënshkruar edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.3.2010²⁶, në të cilën deklarojnë: *Kemi lidhur kontratë shitje pasurie të paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2010, për shitjen e pronës pasuria nr. {***} z.k. {***}, {***}, Tiranë, lloji i pasurisë tokë “arë” me sipërfaqe totale 1.000 m². Mbi këtë pasuri ndodhet e ndërtuar një godinë me tre kate, pa leje ndërtimi, në proces legalizimi. Deklarojmë se godina me tre kate, e cila funksionon si shkollë “{***}”, është likuiduar (shitur) në momentin e shitjes së pasurisë së cituar më sipër, dhe të gjitha të drejtat mbi këtë godinë i kalojnë shtetasve Emror Kasaj dhe M. L.. Këtyre të fundit ju kalojmë të drejtën për të ndjekur procedurat e legalizimit për objektin në fjalë. Emror Kasaj dhe M. L. deklarojnë se e lejojnë zotin H. A. ta përdorë godinën e mësipërme pa qira deri në fund të vitit shkollor 2009-2010”;*

25.4 Në denoncimet e adresuara pranë ILDKPKI-së nga anëtarë të familjes A.²⁷, ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi M. L. kanë përfituar me mashtrim pronën e tyre (ish-shkollë “{***}”, e përbërë nga një dynym tokë dhe një objekt trekatësh, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë), për një vlerë prej 5 milion lekë të reja. Për të mbështetur pretendimet e tyre, ata kanë paraqitur një dokument të titulluar “Sqarim ankese” që mban datën 06.09.2010 përmes së cilit subjekti ka informuar Ministrin e Drejtësisë asokohe mbi konfliktin e lindur mes tij dhe familjes A. për objektin e ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës 1.000 m², ku mes të tjerash sqaron se: *Pretendimi se gjoja e kemi bërë kontratën vetëm për 50.000.000 lekë të vjetra është absurd [...]. Shitësit, në prani edhe të vëllait L., janë likuiduar totalisht për shumën 50.000.000 lekë të vjetra për tokën dhe 250.000 euro për objektin, megjithëse qëllimi është për ta prishur këtë objekt dhe për të ndërtuar mbi të [...]. Ankuesit kanë informuar, gjithashtu, se për këtë pronë ndodhen aktualisht në proces gjyqësor civil në Gjykatën e Lartë;*

25.5 Me nisjen e hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Në muajin mars 2010, kur kam qenë me detyrë oficer i policisë gjyqësore, detyrë të cilën e kam ushtruar deri në datën 02.11.2015, së bashku me shtetasin M. L. lindur në {***}-Kukës dhe banues në Angli, i cili ka pasur emrin L. Sh., kam blerë nga një shtetas i quajtur H. A. dhe bashkëshortja e tij Z. A., banor i lagjes sime në {***}, një sipërfaqe toke are prej 1.000 m² të ndodhur pranë fabrikës {***} në lagjen “{***}”, {***} (mbi të cilin ishte ndërtuar një objekt i paligjshëm), me qëllim për ta vënë në dispozicion të ndonjë shoqërie ndërtuese për ndërtim. Për shkak të kësaj marrëdhënie juridike civile, kam marrë hua pa dokument noterial nga shoqëria “{***}” ShPK, me të cilën kemi rënë në marrëveshje që të ndërtonte për llogarinë tonë në këtë sipërfaqe, një shumë prej 140.000 eurosh, për të paguar pjesën time të shpenzimeve të kryera nga shitësi H. A., për objektin e paligjshëm [...];*

²⁵ Procesverbal i datës 22.09.2016, bashkëngjitur shkresës nr. {***} prot., datë 12.02.2020, të ILDKPKI-së.

²⁶ Përcjellë pranë ILDKPKI-së nga noterja E. K..

²⁷ Kërkesë ankimore nr. {***} prot., datë 24.01.2018, nga ankuesit H. A., I. A., D. A., M. A. dhe L. A. dhe dy denoncime të përcjella e-mail në datat 3 dhe 04.07.2018, nga E. A..

25.6 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore të çështjes civile me nr. {***}, datë 24.02.2014, të përcjellë nga Gjykata e Lartë²⁸, që i përket palëve: paditës/të kundërpaditur H. A. dhe Z. A. dhe të paditur/kundërpaditës Emror Kasaj e M. L., nga aktet e së cilës rezulton se:

- Më datë 27.12.2010, shtetasit H. A. e Z. A. (shitësit e pasurisë) i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshëm të kontratës së shitjes së tokës bujqësore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2010 dhe të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2010, duke pretenduar se me deklaratën noteriale nuk është shitur godina trekatëshe që njihet si ish-shkolla “{***}”, ndërsa me kontratën e shitjes, shitësit kanë hequr dorë vetëm nga e drejta e pronësisë mbi tokën dhe jo nga e drejta e pronësisë mbi ndërtesën. Në kundërpadinë e tyre, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi M. L. kanë kërkuar detyrimin e shitësve H. e Z. A. që t’u dorëzojnë atyre objektin në procedurë legalizimi ndërtim trekatësh me sipërfaqe të gjurmës së ndërtimit 460 m² të vetëdeklaruar me nr. {***} prot., datë 08.08.2006, nga H. A. në Komunën Kashar, si dhe pasurinë e paluajtshme tokë nën ndërtim me sipërfaqe 1.000 m², në rrugën “{***}”, {***}.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 27.05.2013, vendosi: *“Pranimin e kërkesëpadisë dhe fshirjen e regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ZVRPP-së Tiranë për pronën pasuri e paluajtshme tokë arë me nr. {***} pasurie, me sipërfaqe 1.000 m², z.k. {***}, {***}, Tiranë, në emër të Emror Kasaj dhe M. L., për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë së veprimit juridik të shitjes së pasurisë së përbërë nga tokë arë [...] dhe godinë trekatëshe ndërtuar mbi të. -- Detyrimin e palës paditëse të kundërpaditur H. A. dhe Z. A. t’i kthejnë palës së paditur kundërpaditëse Emror Kasaj dhe M. L. vlerën e çmimit të paguar prej 104.000 eurosh, për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë së veprimit juridik të shitjes së pasurisë të përbërë nga tokë arë me nr. {***} pasurie, vol. {***}, faqe {***}, me sipërfaqe 1.000 m², z. k. {***}, {***}, Tiranë dhe godinë trekatëshe ndërtuar mbi të. -- Rrëzimin e kundërpadisë.*

- Ndaj vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, në të cilin, ndër të tjera, ka parashtruar se: *[...] Nga ana e palëve janë hartuar dhe nënshkruar dy kontrata të ndryshme, të veçanta nga njëra-tjetra dhe konsiderimi nga gjykata i faktit sikur me kontratën e shitjes së tokës bujqësore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2010, është realizuar në fakt brenda të njëjtit çmim edhe shitja e ndërtimit informal të ngritur mbi të, është i gabuar. [...] PAGESA për llogari të shitësit, jo vetëm të shumës 5.000.000 lekë të përshkruar në kontratën e shitjes së pasurisë tokë arë, por edhe e 104.000 euro të pranuar nga pala paditëse, edhe e 35.000 eurove për likuidimin paraprak të kredive nga pala e paditur, për të cilën do sqarohet më poshtë, tregon se nuk bëhet fjalë vetëm për një kontratë të vetme në të cilën brenda çmimit prej 5.000.000 lekësh është likuiduar edhe çmimi i objektit informal, por për dy objekte të ndryshme të shitura me kontrata të ndryshme. Sipas kontratës së shitjes së tokës bujqësore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2010, pagesa prej 5.000.000 lekësh është bërë në valutën shqiptare, ndërsa sipas pohimit gjyqësor të vetë palës paditëse veç të tjerash, këta të fundit, kanë marrë para në dorë edhe shumën prej 104.000 eurosh, pavarësisht se edhe kjo shumë është tepër e vogël nga shuma reale e paguar prej blerësve. Pra, fakti që çmimi i likuiduar totalisht nuk është përcaktuar shprehimisht nuk do të thotë aspak se ky çmim nuk ekziston, dhe as se është pjesë përbërëse e blerjes së një objekti tjetër, me kontratë të veçantë noteriale. [...].*

²⁸ Përcjellë nga Gjykata e Lartë me shkresat {***} prot., datë 01.11.2021 dhe nr. {***} prot., datë 10.12.2021.

▪ Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 26.11.2013, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 27.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]. Rrëzimin e padisë së paditësve H. A. dhe Z. A. si të pambështetur në prova dhe në ligj. Prishjen e vendimit të kësaj gjykate dhe pushimin e gjykimit të kundërpadisë së të paditurve Emror Kasaj dhe M. L.. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: Gjykata e çmon të gabuar vlerësimin e Gjykatës së Rrethit lidhur me çmimin e shitjes, duke pranuar një shifër të ndryshme nga ajo që provohet nga aktet në dosjen gjyqësore e sidomos kontratës së shitjes nr. {***}, datë 25.03.2010. Gjykata është kontradiktore në arsyetim duke konsideruar si ligjërish të pranueshëm herë çmimin e kontratës e herë çmimin e pohuar nga paditësit e, në përfundim, pa asnjë bazë ligjore e prove të ligjshme, ka vendosur të marrë të mirëqenë pohimin gjyqësor dhe jo atë çka provohet me akt të shkruar noterial. [...] Sipas paditësit rezultoi se ky send është shitur në vlerën 250.000 euro, vlerë e cila mbetet e paprovuar dhe vetëm në kuadrin e pohimit gjyqësor. [...] Lidhur me objektin e kundërpadisë, Gjykata e Apelit çmon se gjendemi përpara një padie që nuk mund të ngrihet [...]. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 23.05.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse, e kundërpaditur, H. dhe Z. A., kundër vendimit nr. {***}, datë 26.11.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Pas kërkesës së H. e Z. A., për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. {***}, datë 26.11.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 00-2022-1275, datë 23.05.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 153, datë 11.11.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare²⁹;

25.7 Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar³⁰ se: [...] Për sa i përket pretendimeve të palëve gjatë gjykimit civil ju bëj me dije se ato janë bërë nga avokati im, i cili është gjendur edhe nën presionin e faktit që pala kundërshtarë në kundërshtim me realitetin dhe në shpërdorim të mirëbesimit tonë nuk ka pranuar të deklarojë kushtet e vërteta të kontratës, duke pretenduar deri në fund se vlera e gjithë kontratës ishte vetëm 5.000.000 lekë të reja, sa ishte caktuar vetëm për sipërfaqen e tokës dhe duke mos përmendur edhe shumën e llogaritur për shpenzimet e kryera prej shitësit H. A. për objektin e paligjshëm, ndërtuar mbi të, që do prishej për nevoja ndërtimi. [...] ka qenë vetëm merita e avokatit tim që me pohim gjyqësor, në debat e sipër, ka mundur të sigurojë në prani të gjykatës deklarin e palës kundërshtarë H. A. se ai kishte marrë në dorë nga M. L., ortaku im, edhe shumën 104.000 euro. [...] Por sipas jurisprudencës dhe interpretimit të kodit të procedurës civile, pohimi gjyqësor është i vlefshëm vetëm kur pohohen fakte në disfavor të pohuesit dhe jo fakte në favor të tij dhe në disfavor të palës tjetër. Për këtë arsye, nëse në kohën kur vëllezërit A. pretendonin në gjykatë dhe para Ministrit si çmim të kontratës vetëm shifrën 5.000.000 lekë dhe jo 300.000 euro, pohimi ynë si palë: - se çmimi ishte 300.000 euro dhe jo 5.000.000 lekë; - se prej tij ishte likuiduar pjesa e bashkë ortakut tim në blerje; - se unë për pjesën time kisha paguar vetëm sipërfaqen e tokës me vlerën e shpërblimit 15.000 euro = 2.100.000 lekë që do merrja nga shitësi sipas “marrëveshjes së xhentëlmenëve”; - se pjesa e mbetur e papaguar prej meje që i takonte shpenzimeve të objektit të paligjshëm që do të prishej nga ndërtuesi i ardhshëm do të paguhej kur të dilte leja e ndërtimit; - se megjithëse më sipër unë i kisha ofruar pjesën e

²⁹ Vendimet e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet e datës 28.03.2025, janë aksesuar nga trupi gjykues nga burime të hapura në faqet: <https://app.gjykataelarte.gov.al/kerko-vendimet> dhe https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_moskalimi_te_ceshtjeve_ne_seance_gjyqesore_101_1.php

³⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe shtojcën bashkëlidhur.

papaguar të çmimit edhe pa u bërë detyrimi im i kërkueshëm për faj të tij; -se iu kishim dhënë gjithashtu një muaj afat për të na likuiduar paratë dhe për të anuluar kontratën, do të kishte vlerë vetëm për pjesën e pohimit në disfavorin tim, pra, vetëm për pjesën që unë nuk kisha shlyer të gjithë pjesën e detyrimit që i takonte shpenzimeve të bëra nga shitësi më parë për ndërtimin e paligjshëm. [...] Në lidhje me sqarimin e bërë ish-Ministrit B. N., ju bëj me dije se edhe ky sqarim është bërë nga avokati im dhe në këtë të fundit i kemi qëndruar kontratës, sipas së cilës ishte shkruar prej nesh “likuiduar totalisht”³¹[...];

25.8 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës: (i) *Duket se kemi të bëjmë me deklarin të rremë në lidhje me vlerën e tokës arë 1.000 m² dhe ndërtesës 3 kate mbi të, në proces legalizimi, pasi në DIPP-në 2015 dhe në deklaratën vetting ka deklaruar vlerën 5.000.000 lekë, ndërkohë që nga të dhënat e siguruara gjatë hetimit administrativ ka rezultuar që çmimi është 300.000 euro;* (ii) *Duket se ka deklarim të rremë në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë tokë arë 1.000 m² dhe ndërtesën 3 kate, sepse në deklaratën vetting deklaron si burim kursimet e tij dhe të bashkëshortes, ndërsa në pyetësin nr. 2 deklaron se do të konsiderohej e paguar me pjesën prej 5% të çmimit të shitjes që i ishte premtuar si ndërmjetës, si dhe 140.000 euro do të paguheshin (huaja e pretenduar e marrë shoqërisë “{***}” ShPK) në momentin e nxjerrjes së lejes së ndërtimit;* (iii) *Duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për blerjen e tokës arë 1.000 m² dhe ndërtesës 3-katëshe, për pjesën e tij takuese, si dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010.* Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti rivlerësimit njësoj si në ankim ka deklaruar se çmimi total i pasurisë ishte 300.000 euro, dhe se nga pjesa e tij prej 150.000 eurosh konsideron të paguar vetëm vlerën prej 15.000 eurosh, si tarifë suksesi prej 5% e çmimit të shitjes të premtuar nga shitësi, që kur subjekti ishte angazhuar si ndërmjetës për t’i gjetur atij një shoqëri ndërtimi.

- 26.** Në vlerësim të shkakut të ankimit, nga analiza e fakteve dhe rrethanave të parashtruara më lart, trupi gjykues evidenton ekzistencën e deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, si vijojnë: (i) në lidhje me vlerën e pasurisë objekt shqyrtimi rezulton se në deklaratën e pasurisë vetting dhe DIPPFD-në e vitit 2015, vlera e pasurisë tokë arë mbi të cilën ndodhet një objekt në proces legalizimi, deklarohet 2.500.000 lekë (1/2 e vlerës totale prej 5.000.000), ndërsa gjatë hetimit administrativ dhe në ankim deklarohet se çmimi total i kësaj pasurie është në vlerën 300.000 euro, ku pjesa takuese e subjektit është 150.000 euro; (ii) në lidhje me likuidimin e çmimit, në ndryshim nga deklarata e pasurisë vetting dhe DIPPFD-ja e vitit 2015, në të cilat nuk deklarohet vlerë tjetër përveç vlerës prej 5.000.000 lekësh, e cila rezulton e paguar në prani të noterit, sipas kontratës së shitblerjes së tokës bujqësore, në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2010, rezulton të jetë shpenzuar edhe një vlerë monetare për godinën trekatëshe (pa përcaktuar vlerë) në momentin e shitjes së tokës. Në dokumentin sqarues për Ministrin e Drejtësisë deklarohet se vlera e pasurisë (50 milion lekë të vjetra dhe 250.000 euro) është paguar totalisht, ndërsa gjatë procesit gjyqësor³² të zhvilluar në vitet 2010 – 2013, gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në ankim, subjekti ka deklaruar se çmimi total i pasurisë prej 300.000 eurosh nuk është paguar totalisht, pasi ai nuk e ka paguar pjesën e tij takuese prej 150.000 eurosh; (iii) në lidhje me burimin e krijimit, në

³¹ Subjekti ka shpjeguar se fisi “A.” para realizimit të kontratës dhe pas saj kanë qenë tepër aktivë në politikë dhe me njohje të afërta personale me Ministrin e Drejtësisë asokohe.

³² Subjekti ka pretenduar se nga blerësit e pasurisë përveç shumës prej 5.000.000 lekësh janë paguar edhe shumat prej 104.000 eurosh dhe 35.000 eurosh, pra, nuk është paguar e gjithë vlera.

ndryshim nga deklarata e pasurisë vetting dhe DIPPFJ-ja vitit 2015, ku si burim krijimi deklarohen kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes, gjatë hetimit administrativ dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka paguar asnjë vlerë monetare, pasi për shumën prej 15.000 eurosh, që duhet konsideruar e paguar prej tij si shpërblim i caktuar nga shitësi, detyrimet janë shuar reciprokisht, sipas përcaktimeve të Kodit Civil.

27. Veç sa më lart, në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, që kundërshton konkluzionin e Komisionit³³ për deklarime kontradiktore të tij, lidhur me faktin e likuidimit të pjesës së mbetur të çmimit të shitjes së pasurisë, pas marrjes së huasë në shumën 140.000 euro nga shoqëria “{***}” ShPK, trupi gjykues, pasi verifikoi deklarimet e subjektit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe shtojcën e tij, konstaton se subjekti ka deklaruar fillimisht³⁴ dorëzimin e pjesës tjetër të çmimit tek pala shitëse pas marrjes së parave nga shoqëria “{***}” ShPK e, më tej, në shtojcën bashkëlidhur përgjigjeve të këtij pyetësi dhe jo në fjalinë vazhduese, ka plotësuar deklarimin e mësipërm, duke shtuar³⁵ se nga e shitësit nuk është pranuar kjo shumë, nga e cila 50.000 euro i janë dhënë hua shtetasit M. L., ndërsa 90.000 euro i janë kthyer shoqërisë “{***}” ShPK. Këto deklarime janë përsëritur edhe në shtojcën 1, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit. Kjo dinamikë deklarimesh të përsëritura dhe në plotësim të vazhdueshëm të fakteve të reja, ndonëse nuk mund të ngrihen në nivelin e një deklarimi kontradiktor, në vlerësimin e trupit gjykues, sjell paqartësi në drejtim të rrethanës që kërkohet të provohet.
28. Me qëllim për të vlerësuar nëse mospërputhjet e evidentuara sa më lart mund të prodhojnë pasojat e një deklarimi të rremë, trupi gjykues çmoi të ndalet fillimisht në analizimin e akteve juridike përmes së cilave subjekti i rivlerësimit ka përfituar këto pasuri. Referuar fakteve të sipërcituara, rezulton se subjekti së bashku me shtetasin M. L. kanë përfituar pasurinë e llojit

³³ Në paragrafin 2.15.5 të vendimit, Komisioni ka konstatuar se: “Subjekti në pyetësin nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se së bashku me ortakun M. L. në cilësinë e blerësve ua dorëzuan edhe pjesën tjetër të çmimit shitësve, pasi ua dorëzoi paratë shoqëria “{***}” ShPK, deklarim ky kontradiktor me shpjegimet e dhëna, po nga subjekti në prapësimet e tij, ku thekson se nuk e ka paguar pjesën e tij të çmimit prej 150.000 eurosh dhe deklaroi ndërkohë se shumën prej 140.000 eurosh të dhënë hua nga shoqëria “{***}” ShPK e ka përdorur për huanë prej 50.000 eurosh dhënë M. L. dhe shumën 90.000 euro ia ktheu brenda vitit shoqërisë “{***}” ShPK”.

³⁴ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: Pra, pala tjetër, duke përfituar nga mirëbesimi na kishte vënë në vështirësi për të vërtetuar kushtet e kontratës, faktin që ne si blerës ua dorëzuan edhe pjesën tjetër të çmimit pasi na i dorëzoi paratë shoqëria “{***}” ShPK, megjithëse sipas marrëveshjes detyrimi ynë civil nuk ishte bërë ende i kërkuarshëm civilisht, për shkak të vonësës së debitorit (fajit të tyre për mosdorëzim të sendit) dhe faktin që gjithashtu ne iu ofruam një muaj kohë për të na kthyer paratë dhe për të kthyer në gjendjen e mëparshme.

³⁵ Në shtojcën bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: Por pasi lajmërova ortakun tim M. në telefon se i mora lekët nga shoqëria “{***}” ShPK, kam takuar H. duke i thënë se i kisha gjetur edhe pjesën e parave të llogaritur prej tij si shpenzimet që kishte bërë për objektin e paligjshëm. Por H., që për hir të së vërtetës ka qenë krejt pasiv në çdo lloj gjykimi dhe takimi jashtëgjyqësor në lidhje me çështjen, i detyruar edhe nga vëllezërit dhe kunatat për shkak të borxheve që iu kishte atyre, më kërkoi ndjesë duke më thënë se nuk kishte mundësi t’i merrte lekët e mbetura, pasi nuk kishte mundësi të më dorëzonte pronën të cilën e kishin pushtuar vëllezërit kreditorë të tij, të cilët e mbajnë të pushtuar dhe e përdorin ende që prej 11 vjetësh. [...] Më tej, në shpjegimet e dhëna në këtë shtojcë, subjekti ka deklaruar se: Ortaku im, i cili e dinte prej meje që unë kisha në banesë shumën prej 14.000 eurosh, pasi, sipas tij, kishte gjetur një shtëpi në këtë shumë [...]. Duke qenë se e kisha ortak, për shkak edhe të papjekurisë së moshës, nuk dyshova se ky do të ishte një mashtrim dhe ia dhashë këto para përpara Prokurorisë Tiranë [...], disa javë pas marrjes dhe moskthimit të borxhit, rastësisht në një bisedë në një lokal pranë zyrës së përmbartimit gjyqësor shtetëror, një mik yni i përbashkët na tregoi për paaftësinë paguese të personit të cilit M. më kishte thënë se i kishte dhënë paratë e tij. Unë u tremba sepse pashë frikën se ai nuk do t’ia kthente dot këto para M. dhe kështu as M. nuk mi kthente dot mua paratë që më mori. Kështu, unë mora pjesën tjetër të parave që më kishin mbetur në shtëpi prej 90.000 eurosh dhe ia ktheva dorazi administratorit Sh. F., duke i thënë se 50.000 mijë euro mi kishte marrë ortakun për pak kohë. [...].

tokë “arë” me sipërfaqe 1.000 m², përmes kontratës noteriale të shitblerjes të datës 25.03.2010, me çmim të përcaktuar qartë në këtë akt, në vlerën 5.000.000 lekë dhe pasuria është regjistruar në bashkëpronësi të tyre. Në të njëjtën datë me kontratën e shitblerjes, palët shitëse dhe blerëse kanë nënshkruar edhe një deklaratë noteriale në të cilën konfirmojnë faktet: (i) lidhjen e kontratës së shitblerjes për pasurinë tokë bujqësore me sipërfaqe 1.000 m²; (ii) ekzistencën mbi këtë pasuri të një godine 3-katëshe pa leje ndërtimi, në proces legalizimi; (iii) likuidimin e godinës 3-katëshe në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes së tokës bujqësore dhe faktin që të gjitha të drejtat mbi këtë godinë kalojnë në emër të Emror Kasaj dhe M. L.; (iv) këtyre të fundit u kalon e drejta për të ndjekur procedurën e legalizimit; (v) H. A. lejohet ta përdorë godinën deri në përfundim të vitit shkollor 2009-2010. Në këtë akt palët nuk kanë përcaktuar çmim konkret për godinën 3-katëshe dhe mënyrën e pagimit të saj, por vetëm faktin që për këtë ndërtesë palët janë likuiduar mes tyre *në momentin e shitjes së tokës*, por pa përcaktuar çmimin ekzakt të saj. Kjo deklaratë, si një veprim juridik apo marrëveshje mes palësh, që ka si objekt një send jashtë qarkullimit civil, për sa kohë që godina 3-katëshe nuk është e pajisur me leje ndërtimi, në vlerësimin e trupit gjykues nuk përbën një kontratë shitje për kalim të drejtash pronësie, sipas nenit 83 të Kodit Civil³⁶. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se çmimi i blerjes së pasurisë “*Truall me sipërfaqe 1.000 m² dhe objekt i ndërtuar mbi të*” është 300.000 euro nuk bazohet në asnjë dokument ligjor, në të cilin palët të kenë shprehur vullnetin e tyre të përbashkët mbi këtë çmim, si një ndër elementët e vlefshmërisë së kontratës së shitblerjes, sipas parashikimeve të Kodit Civil.

29. Në vijim të analizës së mësipërme në drejtim të saktësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, përpos faktit që pretendimi i tij se vlera e pasurisë objekt shqyrtimi është 300.000 euro nuk pasqyrohet në ndonjë akt shkresor ku palët të kenë shprehur bashkërisht vullnetin e lirë para noterit dhe të kenë rënë dakord për kushtet thelbësore të veprimit juridik, siç është çmimi, për të cilin ligji kërkon formë të shkruar të posaçme, në vlerësim të trupit gjykues ajo çka merr vlerë për efekt të procesit të rivlerësimit është fakti nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer shpenzime për krijimin e pasurisë, me qëllim kontrollin e burimeve të ligjshme të kësaj shume. Në këtë drejtim, referuar shtojcës nr. 2 “Deklarata e pasurisë”, pjesë përbërëse e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit kanë pasur detyrimin të deklarojnë në rubrikën “Deklarimi i pasurive” vlerën në lekë apo në valutë të pasurisë së regjistruar ose jo, që pasqyrohet në dokumentacionin e disponuar, trupi gjykues vëren se vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* përfaqëson vetëm ½ e vlerës së pasurisë tokë “arë” me sipërfaqe 1.000 m² përfituar sipas kontratës së shitblerjes të datës 25.03.2010, por nuk përfaqëson vlerën e plotë të shpenzuar edhe për objektin 3-katësh, sipas deklaratës noteriale të së njëjtës datë, fakt që e bën deklarinin e subjektit të rivlerësimit në *vetting* të pavërtetë.
30. Çështja tjetër e marrë në shqyrtim nga Kolegji lidhet me konkluzionin e Komisionit për të përfshirë në analizën financiare si vlerë të paguar nga subjekti i rivlerësimit shumën prej 2.500.000 lekësh për blerjen e sipërfaqes 1.000 m² (1/2 pjesë), në {***}, Tiranë, në datën 25.03.2010. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke pretenduar se *ai nuk e ka paguar pjesën e tij takuese të çmimit prej 150.000 eurosh, por konsideron të paguar nga kjo vlerë, shumën prej 15.000 ose 2.100.000 lekë (5% e çmimit të shitjes), si shpërblim i caktuar nga shitësi për gjetjen e një shoqërie ndërtimi për të zhvilluar pronën e këtij të fundit*,

³⁶ Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. [...].

dhe se edhe kjo shumë nuk është paguar cash, por është rezultat i shuarjes së detyrimeve reciproke në masën e detyrimit më të vogël, sipas parashikimeve të kapitullit 4 “Shuarja e detyrimeve”, neni 514 “Kompensimi”, të Kodit Civil. Ky deklaram, sipas tij, nuk bie ndesh me deklaratimet e tij pranë ILDKPKI-së se vlera e tokës është paguar nga kursimet familjare, pasi pavarësisht se të padorëzuara cash konsiderohen para të ligjshme të familjes së tij. Pjesa e parave që i përkasin shpenzimeve të shitësit për objektin që do të prishej do të paguheshin kur të plotësohej kushti i dorëzimit të pronës nga shitësi dhe marrja e lejes së ndërtimit. Në analizë të situatës së fakteve të parashtruara më lart, trupi gjykues i Kolegjit e konsideron të drejtë konkluzionin e Komisionit për të përfshirë në analizën financiare si shpenzim të kryer nga subjekti vlerën prej 2.500.000 lekësh, si ½ pjesë takuese e çmimit prej 5.000.000 lekësh, bazuar në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2010. Ndërkohë, pretendimi tjetër se për këtë pasuri duhet të konsiderohet e paguar vlera prej 15.000 eurosh si tarifë suksesi, jo e paguar cash prej tij, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk gjen mbështetje në nenin 514 të Kodit Civil të referuar nga subjekti i rivlerësimit³⁷, sa kohë që nuk ekziston ndonjë akt shkresor që të pasqyrojë saktësisht detyrimet e palëve apo në rastin konkret mënyrën e shpërblimit të subjektit të rivlerësimit.

31. Trupi gjykues kontrolloi edhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 2.500.000 lekësh, mbi bazën e pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *konkluzioni i Komisionit për të mos përfshirë në analizë financiare të ardhurat e bashkëshortes nga përkthimi në shumën 986.378 lekë, me arsyetimin se nuk provohet që pagesa e detyrimeve tatimore është një fakt i shtrembëruar me dashje, pasi për sa kohë këto para ekzistojnë dhe janë dhënë zyrtarisht nga prokuroria, ligji nuk mund të interpretohet kaq ngushtësisht*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se *këto para i janë xhiruar bashkëshortes si përkthyes e jashtme në vitet 2008-2009 nga Prokuroria Tiranë dhe në një rast nga Prokuroria Fier, duke mbajtur për çdo pagesë tatimin në burim. Sipas tij, në vitin 2008 kur bashkëshortja ka pasur NIPT si person fizik, tatimi në burim nuk mbahej nga prokuroria, por paguhej nga bashkëshortja me tatim fiks vjetor, pasi kjo e fundit nuk ishte biznes me TVSh në këtë vit. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti ka paraqitur bashkëlidhur ankimit shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 01.07.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.*

31.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në kuadër të kontrollit të burimit të krijimit të kësaj pasurie, deklaruar nga kursimet e subjektit dhe bashkëshortes ndër vite, ka marrë në analizë edhe të ardhurat nga pagat e bashkëshortes znj. E. K. nga përkthimi, për të cilat ka arritur në konkluzionin³⁸ se: *“Në lidhje me analizën financiare të burimit të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni konstaton se për të ardhurat nga pagat e bashkëshortes në shumën 986.378 lekë provohet përfitimi nëpërmjet llogarisë bankare në Raiffeisen Bank ShA, por këto të ardhura në shumën 746.378 lekë (986.378-240.000) nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme, sipas pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sepse nuk është provuar të jenë paguar detyrimet tatimore për to. Sipas përgjigjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se nuk është paguar tatim në burim për shumën 746.378 lekë, ku 54.000 lekë janë dieta”*.

³⁷ Neni 514 “Kompensimi” përcakton se: “Kur dy persona i detyrohen njëri tjetrit në para ose në sende të një lloji e të zëvendësueshme dhe detyrimet e tyre janë të kërkueshme, të sakta e të caktuara në shumë ose në sasi, detyrimet e të dy palëve shuhen, duke bërë kompensimin ndërmjet tyre. Detyrimet shuhen deri në shumën ose sasinë e detyrimit më të vogël”.

³⁸ Paragrafi 2.15.6 i vendimit të Komisionit.

31.2 Në drejtim të sa më lart, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në lidhje me të ardhurat e znj. K., trupi gjykues konstaton se: (i) znj. E. K. (P.) është regjistruar si person fizik për ushtrimin e aktivitetit me objekt edhe ushtrimin e profesionit përkthyes e gjuhës greke, ruse, italiane e angleze me adresë në rruga “{***}”, nr. {***}, Tiranë, sipas vendimit nr. {***}, datë 08.02.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) nga informacioni i përcjellë nga DRT-ja Tiranë³⁹, rezulton se znj. K. është e regjistruar me NIPT {***} dhe ka kaluar me status “çregjistruar” në datën 20.03.2009, por nuk disponohen të dhëna për të ardhurat e deklaruara nga personi fizik në periudhën 2008-2009; (iii) nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë⁴⁰, lidhur me shërbimet e përkthimit të realizuara nga znj. E. K., rezulton se për periudhën 2008 - 2009⁴¹ totali i pagesave të kryera nga kjo prokurori është në vlerën 914.369 lekë, ndërkohë që rezulton të jetë paguar tatim në burim vetëm për pagesën e honorareve në vlerën 95.000 lekë në tetor 2008 dhe për pagesën pjesore të shpërblimit në vlerën prej 9.850 lekësh në maj 2009; (iv) nga kontrolli i llogarisë bankare në lekë, me nr. {***} të znj. E. K. në Raiffeisen Bank ShA⁴² për vitet 2008 – 2009 rezulton se përveç pagesave të kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, bashkëshortja e subjektit ka përfutur pagesa për shërbimet e përkthimit edhe nga Prokuroria Fier në qershor 2008, por kjo pagesë nuk është konfirmuar nga ky institucion. Gjithashtu, në datën 14.05.2009, llogaria e saj është kredituar me vlerën 54.000 lekë me përshkrimin “dieta”, por nuk disponohet informacion mbi urdhëruesin e saj.

32. Nga analiza e fakteve të mësipërme, trupit gjykues i rezulton se znj. K. në vitet 2008-2009 ka ofruar shërbime përkthimi për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nga të cilat deri në datën 20.03.2009 ka qenë e regjistruar si person fizik me NIPT. Totali i pagesave të kryera nga kjo prokurori për vitet 2008 – 2009 është në vlerën prej 914.369 lekësh, shumë nga e cila në analizën financiare të kryer nga Komisioni është përfshirë vetëm shuma prej 240.000 lekësh në vitin 2008. Gjithashtu, trupit gjykues i rezulton të jetë paguar tatim në burim vetëm për pagesën e honorareve në vlerën 95.000 lekë në tetor 2008 dhe për pagesën pjesore të shpërblimit në vlerën prej 9.850 lekësh në maj 2009, ndërkohë që akti i ekspertimit të auditueses ligjore i paraqitur nga subjekti me prapësimet mbi rezultatet e hetimit i referohet vetëm të dhënave nga Raiffeisen Bank ShA, pa analizuar nëse për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore apo jo, si edhe ka përfshirë në llogaritje të ardhurat nga dietat dhe interesat e llogarisë bankare të akumuluar për periudhën (vlerë e papërfillshme). Për sa i përket shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 01.07.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, depozituar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues vëren se ajo përmban të njëjtin informacion të njohur dhe të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe, si e tillë, nuk përmbush kriteret e një prove të re. Edhe aktet e paraqitura me parashtrimet⁴³ pavarësisht mosplotësimit të kriterit formal, sipas

³⁹ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 17.08.2020.

⁴⁰ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 26.11.2021.

⁴¹ Tetor 2008; urdhër shpenzimi nr. {***}, datë 04.12.2008 (i cili përfshin pagesën për totalin e faturave): (i) fatura nr. {***}, datë 16.10.2008, me shumë 11.000 lekë; (ii) fatura nr. {***}, datë 27.10.2008, me shumë 32.000 lekë; (iii) fatura nr. {***}, datë 31.10.2008, me shumë 95.000 lekë; (iv) fatura nr. {***}, datë 31.10.2008, me shumë 15.000 lekë; (v) fatura nr. {***}, datë 21.11.2008, me shumë 2.000 lekë; 11.02.2009; 27.03.2009, 21.04.2009 dhe 11.05.2009.

⁴² Shkresë nr. {***} prot., datë 10.02.2020, e Raiffeisen Bank ShA.

⁴³ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 26.11.2021 dhe nr. {***} prot., datë 01.07.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; kërkesë e datës 05.03.2025 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë; nxjerrje llogarie në Raiffeisen Bank ShA; ekstrakt i QKR-së, për subjektin E. K., me numër NIPT {***}; njoftim i vlerësimit tatimor 2009; shlyerje e detyrimeve viti 2008, formulari i pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe

nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, nuk sjellin asnjë të re, jo vetëm në drejtim të faktit që kërkohet të provohet në ankim, por edhe në drejtim të pretendimit të ngritur në parashtrime se të ardhurat nga përkthimi të bashkëshortes për një periudhë 17-vjeçare, nga Komisioni janë llogaritur në masën 0 (zero) lekë, duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Ndërkaq, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues vëren se të ardhurat e bashkëshortes nga përkthimi për periudhën 01.02.2000 – 31.10.2015 janë llogaritur në vlerën 599.293 lekë dhe jo 0 (zero) lekë.

33. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se subjekti, i cili, sipas nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ka barrën e provës të provojë ligjshmërinë e të ardhurave, sipas kërkesave të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, ka dështuar të provojë pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga pagesat e kryera sipas urdhër shpenzimit nr. {***}, datë 04.12.2008, shkurt 2009, mars 2009 dhe prill 2009, në total 18.500 lekë të përfituara në vitin 2008, si dhe 665.004 lekë të përfituara në vitin 2009, detyrimin ligjor në rastin konkret, sikurse konfirmuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në ankim, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, e ka pasur znj. K. si person fizik. Ndonëse Komisioni e ka njohur si të ardhur të ligjshme shumën prej 155.000 lekësh të paguar me urdhër shpenzimitin e datës 04.12.2008, trupit gjykues nuk i rezulton e provuar se për këto të ardhura të përfituara nga shërbimi i përkthimit janë paguar detyrimet tatimore përkatëse nga ana e znj. K. ose nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Pavarësisht këtij fakti, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, trupi gjykues, me qëllim për të mos rënduar balancën negative të subjektit, për të ardhurat e përfituara nga shërbimi i përkthimit për vitin 2008, konsideron vlerat e përlllogaritura nga Komisioni. Në konkluzion të kësaj analize, në lidhje me të ardhurat e pretenduara të përfituara nga puna si përkthyes e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në vitet 2008 – 2009, në shumën 986.378 lekë, trupi gjykues vlerëson se plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme, sipas pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, përveç të ardhurave në shumën 240.000 lekë përfituar në vitin 2008, të njohura nga Komisioni, edhe 8.865 lekë përfituar në vitin 2009.
34. Trupi gjykues, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie në datën 25.03.2010, kontrollon analizën financiare të periudhës 01.02.2000 – 25.03.2010, duke reflektuar në të qëndrimin si më sipër për të ardhurat nga puna e bashkëshortes, duke i përfshirë ato në shumën totale prej 248.865 lekësh, nga ku subjekti rezultoi me pamundësi financiare për blerjen e pasurisë me burime financiare të ligjshme, për shkak të një balance negative në vlerën prej (-) 2.334.591 lekësh.
35. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², në vlerën e pjesës së tij takuese prej 2.500.000 lekësh, dhe ka kryer deklaram të rremë në lidhje me vlerën e objektit në proces legalizimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.*
36. Përveç konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se deklaramet kontradiktore dhe qëllimisht jokoherente të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me çmimin e blerjes së objektit të ndërtuar mbi tokën arë me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Tiranë

shëndetësore mars 2009; depozitim cash në BKT në datën 15.04.2009; listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi nëntor 2008, dhjetor 2008 dhe janar 2009; certifikatë e çregjistrimit datë 20.03.2009; DIPP-ja e vitit 2004; relacion financiar i ekspertit E. M..

dhe mënyrën e pagesës së tij, të cilat kanë penguar organet e rivlerësimit për të kontrolluar ligjshmërinë e burimit të vërtetë të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e vlerës së objektit në proces legalizimi e, për rrjedhojë, mospërmbushjen e qëllimit të procesit të rivlerësimit në rastin konkret, përbën një sjellje që duhet të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Pasuria “Banesë 2-katëshe, me sipërfaqe 185, 8 m² në çdo kat, me sipërfaqe trualli 500 m²”

37. Në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë të vlerës së kësaj pasurie në kundërshtim me pikën 5/a, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait nga emigracioni të deklaruar si burim për ndërtimin e banesës dykatëshe me sipërfaqe 185,8 m², në {***}, Tiranë, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në kundërshtim të këtyre konkluzioneve, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim disa pretendime që trajtohen në vijim.*
38. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *konkluzioni i Komisionit për deklaram të pasaktë të kësaj pasurie nuk qëndron, pasi ai nuk ka pasur ndonjë motiv apo interes për të fshehur një pasuri që nuk është bërë me kontributin e tij, përkundrazi mund t'i caktonte një vlerë edhe më të lartë, duke “justifikuar” edhe para të mundshme të paligjshme pas ndonjë shitje, qoftë edhe fiktive të kësaj pasurie. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues mori fillimisht në analizë deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting dhe në deklaratat e interesave private periodike të dorëzuar më herët pranë ILDKPKI-së, nga të cilat konstaton se:*
- (i) në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti ka deklaruar: “Banesë dykatëshe me sip. 185,8 m² në çdo kat, me sipërfaqe trualli 500 m², nr. pasurie {***}, z. k. {***}, {***}, Tiranë. Zotëroj 50% të objektit dhe truallit. Ndërtuar nga babai im në periudhën 1998-1999. Legalizuar me leje legalizimi nr. {***}, datë 22.11.2010. Sipërfaqja e tokës prej 500 m² është blerë nga babai im me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.03.1999, të noteres A. N.. Gjysma e kësaj sipërfaqe 250 m² më është dhuruar gjatë procedurave të legalizimit nga babai im me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.05.2010, të noteres D. K., Tiranë. I gjithë investimi është bërë nga babai im me të ardhurat e krijuara nga puna shumëvjeçare në emigracion (në Greqi - periudhë gjatë së cilës unë kam qenë duke ndjekur studimet universitare). Në rubrikën e vlerës deklarohet: “Nuk është vlerësuar”. Pjesa takuese: 50%;*
- (ii) në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklaram pasurie, depozituar më 16.03.2004, subjekti i rivlerësimit, asokohe OPGj në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, ka deklaruar: Një banesë private së bashku me truallin e palegalizuar ende (trualli është i regjistruar në ZVRPP-Tiranë në emër të babait tim H. K.. Mua më takon gjysma e tij, blerë që në vitin 1998). Vlera: 2.5 milion lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: “Truallin e ka blerë im atë në vitin 1998 dhe shtëpinë e kemi ndërtuar në vitin 1999 me të ardhurat e fituara nga im atë i cili ka punuar në ndërtim për rreth 7-8 vjet si emigrant me dokumente të rregullta në Greqi”;*
- (iii) në DIPPFD-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Banesë dykatëshe me sip. totale 185,8 m² në çdo kat, me sipërfaqe trualli 500 m², nr. pasurie {***}, z. k. {***}, {***}, Tiranë. Zotëroj 50% të objektit dhe truallit. Ndërtuar nga babai im në periudhën 1998-1999. Legalizuar me leje legalizimi nr. {***}, datë 22.11.2010. Pjesa takuese: 50%. Trualli është blerë nga babai,*

si dhe kosto e ndërtimit është me të ardhurat e tij nga emigracioni (periudhë kur unë kam qenë student)”.

39. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se: (i) me kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.01.1999, babai i subjektit, H. K., ka blerë nga shtetasit I., B. dhe Sh. S. pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 500 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, me çmim 700.000 lekë dhe pasuria është regjistruar në emër të tij⁴⁴; (ii) me vetëdeklarimin për legalizim të datës 20.03.2005, H. dhe Emror Kasaj, në cilësinë e zotëruesve të objektit, kanë vetëdeklaruar për legalizim objektin e ndërtuar në 05.2000 me sipërfaqe të zënë 500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 180 m²; (iii) me kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.05.2010, H. K. i dhuron të birit Emror Kasaj ½ e pasurisë tokë arë prej 500 m² dhe pasuria regjistrohet në bashkëpronësi me ½ pjesë takuese; (iv) godina e banimit me 2 kate, me sipërfaqe ndërtimi 185,5 m² dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m² është legalizuar me lejen e legalizimit nr. {***}, datë 22.11.2010, në emër të Emror dhe H. K. dhe më datë 12.04.2011 figuron e regjistruar në bashkëpronësi të tyre; (v) me vendim për lëshim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2017, përcaktohen trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit H. K. dhe Xh. K., të cilët janë Emror, A. dhe M. Kasaj që trashëgojnë nga 1/3 pjesë; (vi) me kontratë dhurimi nr. {***}, datë 26.05.2017, Emror dhe M. Kasaj i dhurojnë A. K. 1/6 pjesë të pasurisë 500 m² truall dhe 185,80 m² ndërtesë dhe Emror dhe A. K. bëhen bashkëpronarë me 1/2 pjesë secili i këtyre pasurive⁴⁵.
40. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni mbi vlerën e ndërtesës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁴⁶ se vlera e banesës kanë qenë vetëm materialet inerte të ndërtimit, pasi çdo lloj punimi fizik dhe mjeshtëror është bërë prej babait, vëllait, e atij vetë, dhe se pikat e shitjes së inerteve nuk lëshonin dokumentacion asokohe. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, barrën e provës: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën vetting dhe deklaratën para fillimit të detyrës në 2015 vlerën e investimit të ndërtimit të shtëpisë me sipërfaqe 185 m², ndërkohë që në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar vlerën 2.500.000 lekë.* Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2003 ka deklaruar vlerën 2.500.000 lekë, duke llogaritur vetëm vlerën financiare të materialeve të ndërtimit të kohës kur është ndërtuar banesa dhe ka paraqitur *aktin e ekspertimit vlerësues në fushën e ndërtimit të datës 28.02.2002*, sipas së cilit kosto e ndërtimit të banesës në periudhën 1999-2000 përllogaritet në vlerën 3.211.827 lekë.
41. Në vlerësim të shkakut të ankimit në drejtim të saktësisë së deklarimit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* vlerën e pasurisë, sipas përshkrimeve të kërkuara prej shtojcës nr. 2 “Deklarata e pasurisë”, pjesë e ligjit nr. 84/2016, në të cilën përcaktohet, ndër të tjera, detyrimi për të deklaruar vlerën në lekë apo në valutë të pasurisë të regjistruar ose jo, që pasqyrohet në dokumentacionin e disponuar. Në rastin konkret, në lidhje me çmimin e tokës me sipërfaqe 500 m², disponohej kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.01.1999, në vlerën 700.000 lekë, ndërkohë që nuk disponohet një dokument i kohës që provon vlerën e investimit të kryer për banesën me dy kate. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit së paku duhet të deklaronte vlerën e tokës me

⁴⁴ Sipas certifikatë për vërtetim pronësie e datës 15.12.2003.

⁴⁵ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 09.03.2020, nga AShK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2.

⁴⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të Komisionit.

sipërfaqe 700.000 lekë dhe vlerën e shpenzuar për ndërtimin e objektit, duke dhënë sqarime se çfarë përfaqësonte kjo vlerë.

42. Çështja tjetër e marrë në analizë nga trupi gjykues lidhet me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar duke e konsideruar atë si bashkëkontribuues të kësaj banese. Në këtë drejtim, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së vendimit, konstaton se konkluzioni i Komisionit për ta konsideruar⁴⁷ subjektin si bashkëpronar në këtë ndërtim që në origjinë të tij, mbështetet në argumentet si vijojnë: (i) ndërtimi i banesës ka filluar në vitin 1999 kur ka mbaruar kati i parë dhe kati i dytë ka përfunduar deri në maj të vitit 2000; (ii) subjekti ka filluar punë në janar të vitit 2000; (iii) në formularin e vetëdeklarimit të legalizimit të vitit 2005 rezulton bashkëdeklarues me babanë e tij, për ndërtimin e realizuar në periudhën 1999-2000. Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ, veç sa parashtruar në paragrafët më lart, trupi gjykues konstaton se në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Që nga viti i ndërtimit të banesës nga i ndjeri, babai im H. K., kam jetuar në këtë banesë me numër pasurie {***}, z. k. {***}, vol. {***}, fq. {***}, të ndodhur në lagjen {***}, {***}, rruga “{***}”, banesë private pa numër. [...]. Arsyeja se përse më është dhuruar nga babai im gjysma e sipërfaqes së truallit të banesës është për faktin që në përfundim të procesit të legalizimit banesa të figuronte në emër edhe të babait edhe timen, ashtu si ndodhi në fakt. [...] Në lidhje me burimin e të ardhurave me të cilat babai im ka ndërtuar banesën, e cila në formularin e deklarimit për legalizim është saktësuar se është ndërtuar në vitin 1999, ju bëj me dije se të gjitha të ardhurat janë siguruar nga im atë në Greqi si emigrant ku ka ushtruar për shumë vite zanatin e tij si ndërtues”. Ndërsa në prapësime⁴⁸ subjekti ka shpjeguar se: “[...] kjo paqartësi vjen për faktin se në vitin 1999 familja ime dhe e prindërve të mi jemi futur në banesën e re, pasi mbaroi kati i parë i saj. Ky vit duhet të jetë deklaruar prej meje për shkak të faktit se mbaja mend shumë mirë që në vitin 1999 kur unë kisha mbaruar shkollën dhe isha asistent avokat kam jetuar në banesën time. Ndërsa deklarimi në formularin e legalizimit, sipas së cilit unë deklaroj se banesa është ndërtuar në muajin maj 2000 duhet të jetë për faktin se pas ndërtimit të katit të parë të banesës, për shkak të ambienteve të pamjaftueshme për të jetuar prindërit, unë, vëllai dhe motra (në atë kohë kam qenë i fejuar dhe jetoja edhe me bashkëshorten) ne kemi vazhduar punën pa ndërprerje për ndërtimin e katit të dytë (banesa është tip Duplex), e cila duhet të ketë mbaruar në muajin maj 2000. Këtë fakt e provoj edhe me fotot përkatëse”.*
43. Për sa më lart, trupi gjykues evidenton fillimisht se arsyetimi i Komisionit lidhur me vlerësimin e marrëdhënies së pretenduar të subjektit me pasurinë objekt shqyrtimi, duke e konsideruar bashkëkontribuues që në origjinë të tij, paraqitet kontradiktor, pasi nga njëra anë duket sikur arsyetoni mbi rrethanat që e bëjnë subjektin bashkëkontribuues, nga ana tjetër, arrin në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait*. Në vlerësim të trupit gjykues, Komisioni duhet të ishte më i qartë në drejtim të analizës ligjore të fakteve dhe duhet të qartësonte subjektin e rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të kësaj marrëdhënieje, duke e kualifikuar fillimisht babanë si person tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të marrëdhënies së dhurimit mes tyre, nga e cila subjekti ka përfutur gjysmën e pasurisë e më pas të kryente

⁴⁷ Paragrafi 3.8, faqe 21 e vendimit.

⁴⁸ Pas kalimit të barrës së provës: *“Duket se ka mospërputhje deklarimi në lidhje me kohën e ndërtimit të banesës sepse në deklaratën para fillimit të detyrës 2015 deklaroi periudhën 1998 – 1999, ndërsa në formularin e vetëdeklarimit për legalizim deklaroi maj 2000”.*

kontrollin nën regjimin e kësaj dispozite ligjore, duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit të provojë burimin e ligjshëm të pjesës së tij takuese për ½ e pasurisë. Veç kësaj, trupi gjykues i gjen të pamjaftueshme edhe argumentet e Komisionit për ta konsideruar subjektin si bashkëkontribues. Konkretisht, përfshirja në procesin e legalizimit të subjektit të rivlerësimit përmes formularit të vetëdeklarimit të datës 20.03.2005 së bashku me babanë e tij, në kuptim edhe të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”⁴⁹, dëshmon mbi tagrat e përdorimit të deklaruësve mbi pasurinë objekt legalizimi, dhe logjikisht edhe një vullnet të babait të tij për ta përfshirë të birin në të, vullnet i materializuar më tej edhe përmes kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.05.2010, duke i dhuruar atij ½ e pasurisë tokë arë dhe regjistrimin përmes lejes së legalizimit të objektit, po në bashkëpronësi të tyre. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se subjekti ka qenë konsistent në deklarinimet e tij se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga puna e babait si emigrant në Greqi, e në asnjë rast nuk ka deklaruar si burim krijimi të ardhura të tij apo të tjera burime, deklarime që mbështeten edhe nga fakti se ai është emëruar në detyrë në datën 01.02.2000, pra, rreth një muaj përpara kërkesës së legalizimit të objektit, ndërkohë që gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka mohuar angazhimin me punë fizike në ndërtimin e tij.

44. Trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se *në lidhje me koston e ndërtimit të banesës nga babai, ai ka dorëzuar aktin e ekspertimit vlerësues në fushën e ndërtimit në datën 28.02.2022, me anë të të cilit llogaritet vlera e materialeve të ndërtimit në periudhën 1999 – 2000 dhe vlera e koston së banesës në vlerën 3.211.827 lekë, por Komisioni, jo vetëm që nuk merr në konsideratë se ky nuk është kontributi i tij, por e ngarkon me gjysmën e kësaj vlere dhe jo të vlerës 2.500.000 lekë. Fakti që ai është ftuar nga babai i tij si bashkëdeklarues në procedurën e legalizimit nuk e bën atë bashkëkontribues në ndërtimin e kësaj banese. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti sjell në vëmendje se në periudhën e ndërtimit të banesës, deri në përfundim të saj ai sapo kishte përfunduar studimet dhe nuk ishte punësuar kurrë, përveç punës si emigrant në Greqi në muajt e verës, të ardhura të cilat i përdorte për të përballuar shpenzimet e studimeve universitare. Ai ka nisur detyrën e OPGJ-së në shkurt të vitit 2000, ndërkohë që banesa përfundoi në muajin maj të vitit 2000.*

44.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga kontrolli i arsyetimit në vendim, trupi gjykues fillimisht konstaton se Komisioni ndryshe nga analiza financiare e rezultateve të hetimit në të cilën vlera e pasurisë ishte përllogaritur në shumën 1.250.000 lekë, 1/2 e shumës 2.500.000 lekë, në analizën financiare të vendimit e ka përllogaritur këtë vlerë në shumën 1.605.914 lekë, e cila përfaqëson gjysmën e vlerës së investimit referuar aktit të ekspertimit të paraqitur nga subjekti me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Me qëllim për të përcaktuar vlerën e ndërtimit të këtij objekti, në kushtet kur ai është ndërtuar në mënyrë informale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të paraqesë asnjë lloj dokumentacioni të kohës për të provuar koston reale apo të përafërt të këtij objekti, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁵⁰, përllogaritja e vlerës së koston së ndërtimit në Kolegj u krye duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër, që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi. Konkretisht, trupi gjykues, nisur nga fakti se në kërkesën për

⁴⁹ Në nenin 2, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj”.

⁵⁰ Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.03.2022, paragrafët 14.8 dhe 16.6.

legalizim të bërë në datën 20.03.2005 ndërtimi i banesës është deklaruar në maj të vitit 2000, në llogaritjen e kostos së ndërtimit u bazua në udhëzimin nr. 214, datë 28.04.1999, “*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit ‘k’*”, sipas së cilit kosto mesatare e ndërtimit për qytetin e Tiranës ka qenë 20.033 lekë/m² e, për rrjedhojë, kosto mesatare e ndërtimit të ndërtesës me sipërfaqe 185,8 m² (388,9 m², dy kate)⁵¹ rezulton të jetë 7.790.834 lekë. Në kushtet kur pasqyrimi i kësaj vlere në analizën financiare do të afektonte rezultatin financiar të periudhës para fillimit të detyrës duke rënduar balancën negative në (-) 12.972.334 lekë, trupi gjykues, në aplikim të parimit *no reformatio in peius*, konsideroi për efekt të analizës financiare, si kosto të ndërtimit të objektit, vlerën e përlllogaritur nga Komisioni në shumën 1.605.914 lekësh.

45. Trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai *ndodhet në kushtet nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi me gjithë përpjekjet për të gjetur të dhënat e sigurimeve shoqërore të babait të tij në Greqi, në kushtet kur ai ka ndërruar jetë, është informuar nga autoritetet greke se këto të dhëna regjistroheshin në mënyrë manuale dhe jo kompjuterike, dhe pa ditur numrin personal të sigurimeve shoqërore të të punësuarit, nuk mund të sigurohen të dhëna. Këtë konfirmim të autoriteteve greke subjekti shprehet se do ta paraqesë sapo t’i dërgohet nga avokati i autorizuar për këtë qëllim në Greqi, me qëllim për të provuar pamundësinë objektive. Nga analizimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting kopjen e lejes së qëndrimit të babait H. K., në Greqi, për periudhën 26.06.1999 – 24.06.2001. Në vijim të hetimit administrativ, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e banesës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁵² se: *Në lidhje me dokumentacionin ligjor të këtyre burimeve unë kam depozituar pranë jush vetëm dokumentacionin e lejes së qëndrimit të babait tim në Greqi (Kartën Jeshile) dhe nuk kam pasur mundësi të siguroj ndonjë dokumentacion pasi im atë paratë e fituara në Greqi (Larisa kryesisht) nuk i ka kaluar me bankë, por dorazi nga klientë tek të cilët ka kryer punime. Në përfundim të hetimit administrativ, pas kalimit të barrës së provës - duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për të ardhurat e krijuara në emigracion nga babai i tij - subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: Nga ana ime janë bërë përpjekje për të gjetur të dhënat e sigurimeve shoqërore në Greqi (IKA) për babanë tim, por jam informuar se për periudhën disa vjeçare kur babai im ka punuar si emigrant në këtë shtet, të dhënat regjistroheshin në mënyrë manuale dhe jo kompjuterike. Për këtë arsye, nuk mund t’i sigurojnë këto të dhëna pa ditur numrin personal të sigurimeve shoqërore çka unë nuk e di dhe im atë ka ndërruar jetë. Unë kam paraqitur lejen e qëndrimit të babait tim në Greqi në atë kohë kur ishte emigrant. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur ankimit në cilësinë e provës prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2022, përmes së cilës ka autorizuar avokatin grek A. S., që t’i drejtohet Degës së Tatimeve dhe Degës së Sigurimeve Shoqërore, Larisa, Greqi, si dhe çdo institucioni tjetër që ai vlerëson të nevojshëm dhe të marrë prej tyre të dhëna me shkrim që kanë të bëjnë me të ardhurat, përfitimet dhe pagesat e sigurimeve shoqërore të babait të tij. Me parashtrimet e datës**

⁵¹ Leje legalizimi nr. {***}, datë 22.11.2010, të përcjellë nga ASHK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.02.2020.

⁵² Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

28.03.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe një sërë aktesh të tjera në lidhje me të ardhurat nga emigracioni të babait H. K.⁵³.

46. Pas analizës së dokumentacionit të sipërcituar, lidhur me pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të siguruar të dhëna mbi të ardhurat nga puna e babait të tij në emigracion në Greqi, trupi gjykues vlerëson se përpjekjet e subjektit për të gjetur dokumentacionin respektiv duhet të kishin nisur së paku që në deklaratën e pasurisë *vetting*, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm të IKDKPKI-së të vitit 2016. Trupi gjykues vëren se edhe gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar përpjekjet e tij për të paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat e babait, ndërsa prokura e sipërcituar, edhe nëse do të provonte përpjekjet e subjektit të rivlerësimit, përveç se e paraqitur në një moment të avancuar të procesit të rivlerësimit pas shpalljes së vendimit të Komisionit dhe e pashoqëruar me përgjigje të autoriteteve greke që mungesën e të dhënave lidhur me të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të babait të tij në shtetin grek e lidhin me faktin e mos gjetjes së numrit personal të sigurimeve shoqërore të të punësuarit, nuk e vendos atë në kushtet e pamundësisë objektive, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Sa i takon akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendoi fillimisht pamundësinë objektive të gjetjes së tyre, si dhe pavarësisht mosplotësimit të kriterit formal, sipas kërkesave të nenit 47⁵⁴ dhe nenit 49, pika 2⁵⁵ e ligjit nr. 49/2012, edhe nëse do të konsideroheshin me vlerë të plotë provuese ato provojnë faktin se babai i subjektit të rivlerësimit ka qenë i punësuar në shtetin grek dhe ka paguar kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën 1997 – 2000, për 190 ditë pune, por nga kjo e dhënë nuk mund të llogaritet shuma ekzakte e të ardhurave të përfituara dhe ligjshmëria e krijimit të tyre në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës
47. Bazuar në sa arsyetuar më lart, trupi gjykues analizoi mundësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit, si person tjetër i lidhur, për të përballuar me burime financiare të ligjshme vlerën prej 1.605.914 lekësh, për ndërtimin e pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, rezultoi se personi tjetër i lidhur ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht sa më sipër, referuar fakteve e rrethanave të tilla si: (i) kjo banesë është ndërtuar nga babai i subjektit të rivlerësimit gjatë kohës kur subjekti nuk ka qenë në marrëdhënie pune dhe subjekt deklarues; (ii) përfundimi i ndërtimit të banesës e ka gjetur subjektin në muajt e parë të ushtrimit të detyrës

⁵³ Prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06. 2022; dekret nr. 358, datë 28.11.1997, i Presidentit të Republikës Greke, në lidhje me “Kushtet dhe procedurat për qëndrimin dhe punën e ligjshme të të huajve në Greqi, të cilët nuk janë shtetas të Bashkimit Evropian”; dekret nr. 359, datë 27.11.1997, i Presidentit të Republikës Greke, në lidhje me “Lëshimin e kartës së qëndrimit të përkohshëm për të huajt”; deklarate noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.11.2024, e shtetasit L. Xh.; prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2024, për emërimin si përfaqësues të posaçëm të shtetasit A. Xh.; kërkesë nr. {***}, datë 21.11.2024, e përfaqësuesit të posaçëm A. Xh., drejtuar Degës Vendore të Sigurimeve Shoqërore Larisa; kthim përgjigje e IKSSH Drejtoria Vendore Larisa, Departamenti i Sigurimeve dhe të Ardhurave, legalizuar me vulë Apostille nr. {***}, datë 22.11.2024; ekstrakte të llogarisë personale të të siguruarit për të punësuarin H. K. për periudhën 1997 – 2000 dhe pagesa të sigurimeve shoqërore në Larisa Greqi (mandate sigurimi), nga z. H. K.; relacion financiar i ekspertit E. M.

⁵⁴ Ky nen përcakton se: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

⁵⁵ Ky nen, ndër të tjera, përcakton se: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”.

si oficer i policisë gjyqësore; si dhe (iii) ekzistenca e gjurmëve të punësimit të babait në shtetin grek dhe të ardhurave të siguruara prej tij, për të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën 1997-2000, trupi gjykues vlerësoi që mungesa e burimeve financiare të ligjshme për këtë pasuri të konsiderohet pa peshë për t'u kualifikuar, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me “Huadhënie në shumën 4.300 euro, shtetasit A. Sh.”

48. Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për burimin e huasë në shumën 4.300 euro në kundërshtim me germen “a” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën 3.276.589 lekë, për të mbuluar shpenzimet dhe për të justifikuar pasuritë në kuptim të germen “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016”*. Ky konkluzion është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, duke parashtruar disa pretendime që trajtohen në vijim.
49. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *deklarimi i tij që si burim krijimi për dhënien e kësaj huaje kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit {***}, përbën një lapsus, pasi në të njëjtën faqe të formularit, në kutinë më poshtë, ky automjet është deklaruar si burim për blerjen e motoçikletës {***}, dhe se realisht si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit me targa të huaja tip “Opel Vectra”, e cila referuar një fotoje në albumin e tij të fotografive ka pasur targën {***}*.
50. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues referuar përmbajtjes së vendimit objekt kontrolli, vëren se konkluzioni i Komisionit për deklaram të pasaktë, sipas nenit 33, pika 5 shkronja “a” i atribuohet ndryshimit të deklarimit të bërë në deklaratën e pasurisë vetting, lidhur me burimin e krijimit të shumës 4.300 euro, duke saktësuar se burim i saj është shitja e mjetit “Opel Vectra”, për të cilin nuk u provua blerja dhe shitja. Në drejtim të këtij argumenti, trupi gjykues mori në analizë deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting, deklaratat e interesave private periodike dhe ato të kryera gjatë hetimit administrativ.
- 50.1 Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti ka deklaruar: *“Huadhënie në shumën 4.300 euro shtetasit A. Sh., sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.2.2014. Nuk është likuiduar ende. Burimi kursimet e mia dhe shitja e automjetit tim me targa {***}. Vlera: 4.300 euro. Pjesa takuese: 100%. Po në deklaratën e pasurisë vetting, deklarohet edhe pasuria: “Motoçikletë me targa {***} vit prodhimi 2004 i blerë nga shtetasi E. K. me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2014”, me burim krijimi: “Të ardhura nga shitja e makinës Mercedes-Benz, me targa {***}, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2013”. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (a) deklarate noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.02.2014, me palë shtetasit Emror Kasaj dhe A. Sh., ku deklarohet se shtetasi A. Sh. i detyrohet shtetasit Emror Kasaj shumën 4.300 euro, shumë e cila është marrë në muajin tetor të vitit 2010 dhe do t'i kthehet më datë 31.12.2014; (b) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2013, me palë shitëse shtetasin Emror Kasaj dhe palë blerëse shtetasin N. T., me objekt shitjen e automjetit me targë {***}, në shumën 250.000 lekë, të likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në DIPPFD-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Huadhënie në shumën 4.300 euro, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.02.2014, shtetasit A. Sh., pa interes, me afat deri më 31.12.2014 (por nuk është likuiduar). Vlera: 4.300 euro. Pjesa takuese: 100%”. Burimi i krijimit nuk deklarohet;*

50.2 I pyetur gjatë hetimit administrativ, lidhur me faktin se si mund të shërbente si burim për huadhënien në vitin 2010 shitja e automjetit me targa {***} në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁵⁶ se: [...] nëse kam deklaruar kështu, është një lapsus, pasi automjeti nuk ishte Benzi me targa {***}, i cili ishte marrë me kredi në Raiffeisen Bank, por një automjet tip “Opel Vektra”, me targa italiane, prej të cilave mbaj mend vetëm shkronjat e para që ishin {***}, të cilin e kam blerë dhe shitur pa kontratë, pasi nuk e regjistrova kurrë sepse mesa kujtoj, shitësi nuk i kishte bërë çregjistrimin në Itali. Paratë e shitjes {***} kanë shërbyer për blerjen e motoçikletës {***}. [...] Paratë për blerjen e këtij automjeti (rreth vitit 2003), për shkak të pamundësisë sime financiare, më janë dhënë nga vjehrrri im biznesmen, i cili na i ka bërë këtë favor për shkak se nuk kishim asnjë automjet në shtëpi, kishim fëmijë të vegjël dhe nga banesa jonë në rrugën “{***}” deri në stacionin e autobusit në {***} (rreth dy km) duhet të ecnim në këmbë nëpër një rrugë të paasfaltuar. [...] Po ju vë në dispozicion një foto të rrugës “{***}”, ku ndodhet banesa ime, të bërë dje në datën 27.11.2021). Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës: “Duket se subjekti ka bërë deklaram kontradiktor në lidhje me burimin e shumës 4.300 euro dhënë hua A. Sh.. sepse në vetting e ka deklaruar vetë si burim dhe, për më tepër, ka depozituar dokument për të, ndërsa në pyetësor deklaroi si burim një mjet tjetër (Opel Vectra), për të cilin nuk provon as shitjen dhe as blerjen e tij”. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar të njëjtat pretendime si në ankim.

51. Në analizë të fakteve si më lart, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting se kjo huadhënie ka si burim kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe shitjen e automjetit me targa {***} nuk përmbush kushtet e një deklarimi të saktë në përputhje me pikën 7 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, sipas së cilit subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin të deklarojnë burimin e përdorur në momentin e krijimit të pasurisë. Konkretisht, trupi gjykues vëren se në momentin e huadhënies në tetor të vitit 2010 të ardhurat nga shitja e automjetit {***} të krijuara/përfituara në vitin 2013 nuk ekzistonin e, si të tilla, nuk mund të kenë shërbyer për dhënien e huasë në vitin 2010. Të ardhurat e pretenduara nga shitja e automjetit tip “Opel Vektra”, me targa {***}, nuk u provuan të jenë realizuar, pasi ndonëse një automjet i këtij tipi rezulton i deklaruar nga subjekti në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklaram pasurie dorëzuar më datë 09.06.2004, ky automjet nuk është deklaruar si burim krijimi në deklaratën e pasurisë vetting, për më tepër që subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor shitjen dhe blerjen e këtij automjeti. Edhe interpretimi i bërë nga subjekti se ndryshimi i burimit të krijimit duhet të jetë bërë me dashje dhe jo nga pakujdesia, në vlerësimin e trupit gjykues, jo vetëm përbën një interpretim të pambështetur në frymën e ligjit, por në kuadrin ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim që vendos si parakusht që deklarimi i pasaktë duhet të konstatohet vetëm si pasojë e një konkluzioni që ato janë kryer me dashje apo nga pakujdesia.
52. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se në lidhje me kursimet familjare, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shumën prej 986.378 lekësh të xhiruara në vitet 2008 – 2009, nga Prokuroria Tiranë, në emër të bashkëshortes, si shpërblim për punën e saj si përkthyes e jashtme dhe subjekti brenda kësaj periudhe ka paguar shumën prej 2.500.000 lekësh në datën 23.03.2010 për blerjen e sipërfaqes prej 1.000 m² (1/2 pjesë) në {***}, Tiranë, është i gabuar, sepse nuk është marrë në konsideratë fakti që këto para nuk janë të paguara cash, por është

⁵⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

konsideruar e paguar vetëm shuma prej 15.000 eurosh (tarifa e suksesit prej 5%) = 2.100.000 lekë. Në vlerësim të këtyre pretendimeve, duke përdorur të njëjtin arsyetim si në paragrafët 30 dhe 33 të këtij vendimi, trupi gjykues verifikoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për dhënien e huas në shumën 4.300 euro, përmes kontrollit të analizës financiare për periudhën 01.02.2000 – 31.10.2010, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit në muajin tetor 2010 ka qenë në pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje në vlerën e plotë të saj, për shkak të balancës negative në shumën (-) 3.259.804 lekë.

53. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, në lidhje me huanë në shumën 4.300 euro, dhënë shtetasit A. Sh., trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e kësaj shume dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për dhënien e huas në vitin 2010, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pasurinë “Motoçikletë me targa {}, prodhim i vitit 2004”***

54. Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të burimit të krijimit në kundërshtim me germën “a” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. – Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën 50.000 lekë, për të mbuluar shpenzimet dhe për të justifikuar pasuritë në kuptim të germës “b” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni ka argumentuar se: Subjekti i rivlerësimit si burim për blerjen e motoçikletës në shumën 300.000 lekë, si në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën vetting ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit {***}, në shumën 250.000 lekë. Subjekti në prapësime ka ndryshuar burim, ku përveç të ardhurave nga shitja e automjetit {***} ka shtuar dhe shumën 50.000 lekë, si shumë e krijuar nga kursimet e tij, burim ky i padeklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën vetting.*
55. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se *ka qenë një harresë e parëndësishme mosdeklarimi si burim krijimi për këtë mjet edhe i vlerës 50.000 lekë nga kursimet e tij, dhe se konstatimi për mungesën e burimeve të ligjshme ka ardhur si pasojë e konkluzionit të gabuar të Komisionit që ai i ka paguar shtetasit H. A. shumën prej 150.000 eurosh. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, nga aktet në fashikullin e Komisionit, konstaton se në deklaratën e pasurisë vetting subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Motoçikletë me targa me targa {***} vit prodhimi 2004 i blerë nga shtetasi E. K. me kontratën nr. {***} rep., nr. {***}, datë 23.04.2014, të noteres D. K. në shumën 300.000 lekë. Burimi nga shitja e automjetit tim tip Benz me targa {***}, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2013, i noteres C. H.. Ky automjet ishte blerë me kredinë e marrë në Raiffeisen Bank në datën 02.08.2010, në shumën 300.000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar në të njëjtën mënyrë edhe në DIPP-në e vitit 2015. Për të mbështetur këto deklarime, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting: (i) kontratë shitje mjeti (motori) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2014, sipas së cilës subjekti ka blerë mjetin e markës motor Yamaha, në vlerën 300.000 lekë; (ii) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2013, përmes së cilës subjekti ka shitur automjetin me targë {***}, në shumën 250.000 lekë. Në shpjegimet e tij, pas kalimit të barrës së provës - duket se subjekti nuk ka burime të mjaftueshme për të blerë motoçikletën në vlerën 300.000 lekë duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në shumën 50.000 lekë - subjekti ka deklaruar se pjesën shtesë prej 50.000 lekësh për blerjen e motoçikletës e ka paguar nga kursimet e tij. Në vlerësim të kësaj situate, trupi gjykues përveç faktit që e gjen pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi përdorimin e kursimeve prej 50.000*

lekësh si burim krijimi, në nivel deklarativ, duke iu referuar përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, sipas së cilave kontrolli i burimit të krijimit të pasurive do të duhet t'u bëhet burimeve të ligjshme në momentin e krijimit të pasurisë dhe, përderisa subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit dhe jo kursimet, vlerëson se verifikimi i mundësisë financiare për të krijuar këtë pasuri do të mbështetet mbi këto të dhëna. Nga ky kontroll, konfirmohet konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën 50.000 lekë.

56. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit *se balanca negative në analizën financiare ka ardhur si pasojë e përfshirjes së vlerës 150.000 euro si pagesë ndaj shtetasit H. A.*, trupi gjykues vëren se Komisioni e ka konsideruar shumën prej 150.000 eurosh të paguar kundrejt shtetasit H. A. vetëm në analizën financiare të rezultateve të hetimit dhe është konsideruar i kryer në vitin 2010, jo në vitin 2014 kur ka ndodhur blerja e motorit, ndërsa në analizën financiare përfundimtare të vendimit ky transaksion nuk pasqyrohet më. Për rrjedhojë, në vlerësimin e trupit gjykues, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit konsiderohet jorelevant në raport me konkluzionin e Komisionit.
57. Në përfundim, lidhur me pasurinë “Motoçikletë, prodhim i vitit 2004”, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë në lidhje me burimin dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5 shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

Automjet “Mercedes-Benz”, me targa {}, prodhim i vitit 2002***

58. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se *nga subjekti i rivlerësimit janë kryer veprime që kanë pasur për qëllim fshehjen e pronësisë reale të këtij mjeti, veprime që bien ndesh me figurën e prokurorit duke cenuar besimin e publikut të drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.* -- Për rrjedhojë, vlera e automjetit e përcaktuar nga autoritetet doganore prej 250.000 lekësh është pasqyruar si pasuri e subjektit të rivlerësimit në analizën financiare. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke pretenduar se Komisioni në mënyrë të gabuar konkludon se ai si bashkëpronar i këtij automjeti nuk ka kontribut, pasi ai ka paguar doganën dhe detyrimet e mirëmbajtjes dhe se interesi ka qenë i dyanshëm, ku shtetasi J. Xh. kishte interesin ta përdorte automjetin për familjen kur të vinte në Shqipëri.
59. Nga kontrolli i arsyetimit në vendim, trupi gjykues konstaton se konkluzioni i mësipërm i Komisionit i atribuohet: (i) shpjegimeve jobindëse të subjektit të rivlerësimit në drejtim të fakteve të tilla si: blerja e mjetit në Angli me dy emra, pa u vërtetuar çmimi i blerjes dhe pa u paguar prej tij ndonjë pjesë e çmimit të blerjes; sjellja e subjektit si pronar deri edhe në përfitimin e çmimit të shitjes prej 4.000 eurosh kur bashkëpronar ishte edhe J. Xh.; humbja e çdo kontakti mes tyre pas shitjes së makinës; (ii) shpjegimeve kontradiktore në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit në vlerën 4.000 euro, pasi në pyetësonin nr. 2 subjekti ka shpjeguar se shtetasi J. Xh. i ka lënë të kuptohej që nëse e shiste automjetin mund të përfitonte të ardhurat e tij, ndërsa në prapësime ka deklaruar se nuk është e qartë nëse J. Xh. e kërkon pjesën e tij apo jo.
60. Në drejtim të sa më lart, me qëllim për të identifikuar në mënyrë të saktë marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, trupi gjykues mori fillimisht në analizë deklarinimet e

subjektit të rivlerësimit, nga ku konstaton se në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti ka deklaruar: “Autoveturë tip Mercedes-Benz, me targa {***}, vit prodhimi 2002. Blerë nga bashkëpronari, mik i familjes në Angli. Kam paguar vetëm shumën e zhdoganimit 90.000 lekë. Vlera: 90.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”. Bashkëlidhur kësaj deklarate është paraqitur leja e qarkullimit lëshuar më datë 26.09.2014, për mjetin “Mercedes-Benz”, me targë {***}, i regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Emror Kasaj dhe J. Xh.. Në DIPPFD-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Autoveturë Benz 2200, viti i prodhimit 2002, me targë {***}, zotëroj ½ pjesë. E ka blerë bashkëpronari mik i familjes në Angli ku figuron rezident. Blerë: 1.500 euro. Unë kam paguar vetëm tarifën e çdoganimit në shumën 90.000 lekë. Vlera: 90.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”.

61. Nga dokumentacioni i përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRr”)⁵⁷, trupi gjykues konstaton se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa “{***}” dhe nr. shasie {***}, ka ardhur nga Mbretëria e Bashkuar (me targa “{***}”) dhe sipas formularit V5C⁵⁸, dokument i lëshuar nga DVLA, plotësuar në datën 19.10.2011, përgjegjës për regjistrimin dhe pagesën e taksave të automjetit tip “Mercedes-Benz” janë shtetasit J. Xh. dhe Emror Kasaj. Në datën 17.09.2014 është paguar nga subjekti tarifa e zhdoganimit në vlerën 58.481,73 lekë dhe pagesa e penaltetit në vlerën 29.333 lekë pranë Raiffeisen Bank ShA, në favor të Agjencisë Doganore Tiranë, mbi bazën e deklaratës doganore të kësaj date në të cilën vlera e automjetit është pasqyruar në shumën 250.000 lekë. Po në datën 17.09.2014 është lëshuar certifikata e kontrollit fizik në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërsa më datë 26.09.2014 është lëshuar certifikata e pronësisë dhe leja e qarkullimit në dy emra, si më lartcitur. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se në datën 26.09.2014 është prerë polica e sigurimit njëvjeçar nga subjekti, me përdorues Emror dhe E. K., kurse më datë 29.10.2018 është prerë polica e sigurimit njëvjeçar po nga subjekti, me përdorues Emror Kasaj. Në datën 31.12.2018, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2018, Emror Kasaj dhe J. Xh. e kanë shitur automjetin në vlerën 4.000 euro.
62. Gjatë hetimit administrativ⁵⁹, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Me shtetasin J. Xh. jam njohur krejt rastësisht gjatë një sezoni veror në Vlorë [...] ndërsa ai kishte ardhur nga Anglia ku jetonte familjarisht, vetëm për sezon pushimesh verore. Ky shtetas ishte nga fisi i bashkëshortit të tezes sime Z. Xh., por nuk e di me saktësi lidhjen mes tyre. Gjatë dy javëve që kam qenë me pushime ai është njohur me faktin që unë kisha vajzën e vogël në moshë shumë të vogël dhe me vështirësitë e mia financiare dhe të lëvizjes në Tiranë, pasi bashkëshortja ime nuk kishte makinë. J. me tha se kur të vinte herë tjetër nga Anglia do të sillte një makinë dhe do ta linte në Shqipëri vetëm për të lëvizur kur të vinte me pushime [...]. [...] Kur e ka blerë makinën në Angli (makina është e vjetër, e vitit 2001-2002, me timon në krah të djathtë), si blerës, përveç emrit të tij ka vënë edhe emrin tim, pa qenë unë i pranishëm, pasi nuk kam qenë

⁵⁷ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 17.2.2020. nga DPSHTRr-ja.

⁵⁸ Formulari V5C ose libri i regjistrimit është dokument i lëshuar nga DVLA (Driver and Vehicle Licensing Agency), Angli, për mbajtësin e regjistruar të automjetit. Ky dokument përmban detaje rreth automjetit, duke përfshirë markën dhe modelin, kur është regjistruar për herë të parë, llojin e karburantit, numrin e identifikimit të automjetit (VIN), etj. Gjithashtu, përfshin informacione për mbajtësin e regjistruar, duke përfshirë emrin dhe adresën e tyre. Është e rëndësishme të qartësohet dallimi midis “mbajtësit të regjistruar” dhe “pronarit”. DVLA përcakton mbajtësin e regjistruar, të quajtur në V5C, si ai që është përgjegjës për regjistrimin dhe taksimin e automjetit. Ky nuk është domosdoshmërisht i njëjti person që zotëron automjetin, kështu që V5C nuk mund të përdoret si dëshmi e pronësisë.

⁵⁹ Me pyetësorin nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë sqarime mbi regjistrimin e këtij mjete në emrin e tij, kur ai nuk ishte rezident në shtetin anglez, lidhjen me shtetasin J. Xh., vlerën e blerjes së mjetit në shtetin anglez, qëllimin e blerjes së mjetit nga miku i tij J. Xh. dhe “dhurimin” e tij.

kurrë në Angli, dhe kjo me qëllim që unë ta përdorja lirisht makinën në Shqipëri, njësoj si ai vetë. [...] Duke qenë se nuk kisha asnjë kontakt me J. që figuronte bashkëpronar [...] e kam paguar vetë vlerën e zhdoganimit në vlerën 60.000 lekë dhe gjobën prej 30.000 lekësh, pasi makina kishte më shumë se gjashtë muaj që kishte hyrë në Republikën e Shqipërisë (kufiri maksimal i tolerancës nga shteti). Kështu kam zhdoganuar dhe targuar automjetin, i cili mori targat {***}. Duke qenë se sipas dokumentit të pronësisë në gjuhën angleze automjeti figuronte me dy bashkëpronarë edhe dokumenti i pronësisë në Shqipëri doli, po kështu, me dy bashkëpronarë, konform pronësisë në dokumentin anglez. Kur J. ka ardhur në Shqipëri [...] i thashë nëse mund ta shisnim, pasi ishte makinë e vjetër dhe me timon anglez [...]. Ai më tha se mund të bëja çfarë të doja me makinën dhe vetëm t'i them ku të shkonte për të firmosur, duke më lënë të kuptoja se ai e konsideronte këtë makine si makinë time dhe nuk i interesonte. [...] përgatita dokumentacionin tek noteri dhe ditën që edhe J. do të ikte, pasi më dorëzoi makinën, i thashë se ku duhet të paraqitej të firmoste. Që atë moment nuk kam pasur asnjë kontakt me të dhe nuk e di nëse ka ardhur më në Shqipëri [...]”.

63. Në përfundim të hetimit administrativ, në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit⁶⁰, përveç sa më lart, subjekti ka shpjeguar edhe se: [...] fakti që makina është bërë në dy emra në Angli tregon qartë që ky i fundit nuk është tregtar makinash, pasi nuk do të kishte arsye të hidhte edhe emrin e tij në makinën time. Pjesën e çmimit që do ti takonte nga shitja nuk ma ka kërkuar, pasi ka ikur dhe unë as sot nuk jam i qartë nëse nuk e do pjesën e tij të çmimit apo kur të më takojë do ta kërkojë. Nuk kam qenë as vetë i qartë nëse kjo pjesë është dhurim, pasi nëse do të ishte dhurim nuk gjej as më të voglën pengesë për të fshehur një dhuratë të tillë nga një person i afërm i fisit, i njohur qoftë edhe për dy muaj pushime verore, me të cilin përjashtohet në mënyrë kategorike çdo lloj marrëdhënie interesi. [...].
64. Në analizë të fakteve të mësipërme, trupi gjykues konstaton se akti fillestar që e lidh subjektin e rivlerësimit me automjetin objekt shqyrtimi është certifikata e regjistrimit të automjetit në gjuhën angleze, nga verifikimi i përmbajtjes të së cilës rezulton që ai nuk përbën një akt që vërteton pronësinë, por i jep tagra subjektit dhe shtetasit J. Xh., lidhur me regjistrimin e automjetit dhe pagimin e taksave lidhur me të. Ndonëse nuk rezulton i dokumentuar çmimi i blerjes së këtij automjeti në Angli, mënyra e përfitimit dhe përfshirja e emrit të subjektit të rivlerësimit në dokumentet angleze, referuar kronologjisë së fakteve në vijim, trupi gjykues vëren se mes subjektit të rivlerësimit dhe pasurisë objekt shqyrtimi ka vijuar një marrëdhënie e ngushtë, e ngjashme me atë të pronësisë me sendin, pasi përveç pagesës së zhdoganimit të automjetit, përdorimit pa ndërprerje të tij për një kohë relativisht të gjatë (të paktën që nga zhdoganimi më datë 17.09.2014 e deri në datën e shitjes më datë 31.12.2018), pagesës së siguracioneve të makinës dhe shërbimet e mirëmbajtjes, sikurse konfirmohet prej tij, subjekti ka përfituar edhe të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në vitin 2018. Këto fakte, në vlerësimin e trupit gjykues dëshmojnë për një sjellje tipike të një pronari të vetëm dhe të vërtetë mbi automjetin. Nga ana tjetër, përfitimi i pasurisë në fjalë në rrethanat e një marrëdhënieje miqësie jo të vazhdueshme, e cila më pas ndërpritet duke humbur çdo kontakt me bashkëpronarin tjetër

⁶⁰ Subjektit i kaloi barra e provës: (i) Duket e paqartë lidhja e subjektit me shtetasin J. Xh., ku pas njohjes rastësore ai i sjell një mjet nga Anglia, pa paguar subjekti asnjë vlerë për blerjen e tij veç doganës dhe përfitimin nga ana e subjektit të të gjithë shumës 4.000 euro nga shitja e mjetit; (ii) Duket se ka deklarime të dyshimta të subjektit lidhur me përfitimin e mjetit, për arsye se: dhurimi i mjetit nga shtetasi J. Xh. bëhet pas njohjes rastësore; përdorimi i vazhdueshëm i mjetit nga subjekti; përfitimi i të ardhurave nga shitja e këtij mjeti në shumën 4.000 euro nga subjekti ndërkohë që nuk ka ndonjë dokument që J. Xh. t'i dhurojë subjektit pjesën e tij takuese të përfituar nga shitja e mjetit; nuk ka kontaktuar më me këtë person që nga shitja e mjetit. [...].

që pretendohet të jetë kontribuuesi kryesor, në vlerësimin e trupit gjykues, krijon premisa për dyshime mbi marrëdhënien reale të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, përtej asaj të bashkëpronësisë.

65. Trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka keqinterpretuar me dashje faktet, duke i ngarkuar në bilanc jo vlerën e blerjes së automjetit në shumën 1.500 euro, por çmimin e referencës 250.000 lekë plus vlerën e doganës rreth 90.000 lekë, ndërkohë që ky detyrim është caktuar nga shteti vetëm për efekt të pagimit të detyrimeve doganore*. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues vëren se vlera e kësaj pasurie është pasqyruar në shumën 340.000 lekë, e cila përfaqëson totalin e çmimit të blerjes, sipas deklaratës doganore, pagesës së taksës së zhdoganimit dhe pagesës së penalitetit për regjistrimin e automjetit jashtë afateve ligjore. Pretendimi i subjektit se vlera e automjetit ka qenë 1.500 euro, përveçse e deklaruar në DIPP-në e vitit 2015, nuk mbështetet në ndonjë dokument shkresor, e madje nuk është vënë asnjëherë në dispozicion nga subjekti me gjithë kërkesën e Komisionit gjatë hetimit administrativ. Në sy bie edhe fakti se, ndërsa subjekti kundërshton vlerën e automjetit të referuar në deklaratën doganore në shumën 250.000 lekë, ai merr të mirëqenë faktin se ka kryer si shpenzim për zhdoganimin vlerën prej 90.000 lekësh. Referuar udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25, datë 30.11.2007, “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, trupi gjykues vëren se për autoveturat me kapacitet cilindrik mbi 1900 - 2500 CC, kategori në të cilën përfshihet edhe automjeti tip “Mercedes-Benz” E220 CDI Avangarde⁶¹, vlera doganore e tyre nuk mund të llogaritet më pak se 250.000 lekë. Në këto rrethana, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme të automjetit, trupi gjykues e gjen të arsyeshëm referimin e Komisionit tek vlera e transaksionit sipas deklaratës doganore.
66. Në përfundim, në lidhje me pasurinë automjet “Mercedes-Benz”, me targa {***}, prodhim i vitit 2002, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me huanë në shumën 50.000 euro dhënë shtetasit M. L.

67. Komisioni ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të burimit të huasë dhënë shtetasit M. L., në kundërshtim me germën “a” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. -- Subjekti i rivlerësimit nuk provon ekzistencën formale të marrëdhënies së huasë me shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe as burimin e krijimit të këtyre të ardhurave. -- Pavarësisht nëse marrëdhënia e huasë me shoqërinë “{***}” ShPK ka ekzistuar apo jo, Komisioni krijon bindjen se subjekti e ka përdorur këtë marrëdhënie për të justifikuar burimin e shumës prej 50.000 eurosh dhënë hua M. L. në vitin 2010, por nisur nga fakti se subjekti nuk e ka deklaruar as në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2015 dhe as në deklaratën vetting, huanë e dhënë nga shoqëria “{***}” ShPK., si burim për huanë e dhënë shtetasit M. L., në shumën 50.000 euro, e çon subjektin në kushtet e një deklarimi të rremë në lidhje me burimin e kësaj huaje parashikuar në pikën “ç”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, Komisioni e ka pasqyruar shumën prej 50.000 eurosh, si pasuri të subjektit të rivlerësimit në analizën financiare për vitin 2010.-- Për sa më sipër, Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare të subjektit shumën 140.000 euro të shoqërisë “{***}” ShPK. -- Deklarimet kontradiktore të subjektit përbëjnë sjellje jo të përshtatshme të një prokurori, që*

⁶¹ Ky automjet, sipas deklaratës doganore, e ka kapacitetin cilindrik 2151 CC.

vlerësuar në një këndvështrim etik tërësor të sjelljes së tij, kanë cenuar në nivel të mjaftueshëm besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

68. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se dyshimi i ngritur nga Komisioni është haptazi në mospërputhje me provat e paraqitura, dhe se mungon qëllimi i fshehjes si element i domosdoshëm, pasi ai ka deklaruar kreditorin e fundit (vjehtërrën) dhe debitorin e fundit (M. L.), duke qenë se në datën e deklarimit shoqëria “{***}” ShPK nuk ka qenë më debitor, ndërkohë që ka qenë në pamundësi objektive për të sqaruar gjithë historinë e tij me ndërtuesin në një kuti formulari. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues mori fillimisht në analizë deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë vetting, në deklaratat e interesave periodike private, si dhe ato të kryera gjatë procesit të rivlerësimit, e më pas aktet në fashikull, nga të cilat konstaton se:

68.1 Në deklaratën e pasurisë vetting, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” deklarohet: “I kam detyrim nënës së bashkëshortes L. P. shumën prej 50.000 euro, të cilën ma ka marrë hua shtetasi M. L.. Kjo shumë është kaluar nga llogaria e vjehtërrës në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në llogarinë e bashkëshortes sime E. K. në BKT. Kjo shumë është tërhequr nga BKT në datën 23.04.2014”. Shuma e detyrimit financiar e mbetur pashlyer: 50.000 euro. -- Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtetasi M. L. me emrin e mëparshëm L. Sh., lindur në {***}, Kukës dhe banues prej vitesh në Angli (me shtetësi angleze) më ka marrë hua për një afat njëjavor, pa asnjë dokument të nënshkruar, duke përfutur nga mirëbesimi im (pasi me të jam bashkëpronar në sipërfaqen e sipërdeklaruar 1.000 m² tokë arë në {***}, Tiranë) dhe nuk ma ka kthyer këtë hua, të cilat janë para të marra hua prej meje nga nëna e bashkëshortes sime shtetases L. P., si kam sqaruar më sipër. Ky shtetas ka vite që më shmanget për të lëshuar qoftë edhe deklaratën e borxhit dhe jam në konflikt me këtë person (këtë fakt, pavarësisht mungesës së dokumentacionit noterial, e parashtroj, pasi mund t’i drejtohem gjykatës në rrugë civile ose prokurorisë në rrugë penale nëse do të rezultojë se qëllimi i këtij shtetasi në kohën e marrjes së borxhit ka qenë mashtrimi)”;

68.2 Në DIPPFID-në e vitit 2015, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “Në vitin 2014 i kam dhënë shtetasit M. L. shumën 50.000 euro në formë huaje pa interes, pa dokumentacion. Kjo shumë është marrë nga vjehtërra ime (transferuar nga llogaria e saj personale në Bono Thesari të Banka e Shqipërisë, në llogarinë e bashkëshortes sime në BKT). Kjo shumë është tërhequr nga bashkëshortja ime dhe unë ja kam dhënë shtetasit të lartpërmendur cash. Kjo shumë i është dhënë për një javë afat dhe akoma nuk është kthyer dhe huamarrësi banues në Angli i shmanget nënshkrimit të kontratës së huamarrjes me shkrim para noterit (jam në konflikt)”;

68.3 Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit, referuar faktit që në mars të vitit 2010 kishte blerë së bashku me shtetasin M. L. një sipërfaqe toke prej 1.000 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, {***}, ka deklaruar se: [...] Për shkak të kësaj marrëdhënieje juridike civile kam marrë hua pa dokument noterial nga shoqëria “{***}” ShPK, me të cilën kemi rënë në marrëveshje që të ndërtonte për llogarinë tonë në këtë sipërfaqe, një shumë prej 140.000 eurosh, për të paguar pjesën time të shpenzimeve të kryera nga shitësi H. A. për objektin i cili do të prishej për efekt të ndërtimit të ri. [...] Pasi kishin kaluar disa muaj nga kontrata e shitjes, shtetasi H. A., të cilit i ishte bërë kjo pronë dhe i ishte lënë në huapërdorje pa shpërblim për disa muaj, i gjendur në presion të lartë nga kreditorët e tij të shumtë dhe në veçanti nga

vëllezërit e tij [...] nuk e pranoi këtë shumë që më kishte mbetur pa paguar dhe që e kisha marrë tek shoqëria “{***}” ShPK [...] shtetasi M. L. (L. Sh.), person i njohur në mashtrimin e qytetarëve, por që unë nuk kisha rast ta njihja, duke marrë informacion prej meje që H. nuk e linin vëllezërit të merrte edhe pjesën tjetër të shpenzimeve të objektit që do të prishej, me anë të mashtrimit, me kërkoi hua 50.000 euro, gjoja vetëm për një afat njëjavor, sepse, sipas tij, do të blinte një apartament me çmim okazion dhe do ta shiste diku tjetër, sepse kishte gjetur rast të mirë. [...] Ia kam dhënë dorazi L. këtë shumë pa asnjë dokument të shkruar. [...] Pasi prita më kot disa muaj të merrja mbrapsht shumën prej 50.000 eurosh, i kam kthyer shoqërisë “{***}” vetëm pjesën e mbetur prej 90.000 eurosh nga shuma që më kishte dhënë, ndërsa shumën tjetër prej 50.000 eurosh ia kam kthyer dorazi vetë pas katër vjetësh, pasi ia kam marrë borxh vjehrrës L. P., e cila i kishte depozituar disa vite më parë në bono thesari në Tiranë. Vjehrra ia kaloi këto para bashkëshortes në llogarinë e saj dhe pasi i tërhoqëm ia dorëzova pronarit të shoqërisë “{***}”;

68.4 Në pyetësonin vijues me nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë sqarime mbi mospërputhjet e deklarimeve të tij, për sa kohë në deklaratën e pasurisë vetting deklarohet se shuma 50.000 euro e dhënë hua M. L. është marrë nga vjehrra e tij, ndërsa në pyetësonin standard deklarohet se shuma në fjalë është marrë nga shuma prej 140.000 eurosh, që i ishte dhënë hua nga shoqëria “{***}” ShPK. Po kështu, subjektit iu kërkua të japë sqarime edhe lidhur me datën e saktë të dhënies së huasë shtetasit M. L., duke e provuar me dokumentacion këtë marrëdhënie. Në përgjigjet e tij, subjekti ka deklaruar⁶² se: “Pasi kam gjetur shënimet e mia më rezulton se ka qenë data 3 dhjetor 2010. Këto para janë pjesë e shumës 140.000 euro që më kishte dhënë shoqëria “{***}”. Pas katër vjetësh shoqërinë “{***}” e kam shlyer për 50.000 euro të mbetura nga paratë që i kam marrë vjehrrës. Në deklaratën e pasurisë kam përshkruar debitorin e fundit M. L. dhe kreditorin e Fundit, vjehrrën time, duke qenë se personi i ndërmjetëm, shoqëria “{***}”, nuk ishte më as debitor as kreditor. Pasi të keni lexuar shtojcën time në lidhje me këtë marrëdhënie të gjatë e të ndërlikuar, mendoni se në një kuti të faqes së deklaramit mund të sqaroja aq gjatë duke dhënë gjithë këto detaje? Për shkak të çështjes shumë të gjatë e të ndërlikuar, edhe në përgjigje të pyetjeve standard ju kam bërë me dije se për hollësi dhe detaje të kësaj marrëdhënie do të shprehem më vonë kur të më kërkohet nga ana juaj, çka jam duke e bërë tani [...]”. Edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit⁶³, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ se në deklaratën vetting ka deklaruar kreditorin e fundit (vjehrrën) dhe debitorin e fundit (M. L.), pasi në datën e deklaramit shoqëria “{***}” ShPK nuk ka qenë as debitori e as kreditori i tij.

- 69.** Në analizë të sa më lart, trupi gjykues konstaton ekzistencën e mospërputhjeve në deklarime lidhur me burimin e shumës që ka shërbyer për dhënien e huasë në vlerën 50.000 euro ndaj shtetasit M. L., pasi në deklaratën e pasurisë vetting dhe në DIPPFID-në e vitit 2015 deklarohet si burim krijimi huaja e marrë nga vjehrra L. P. në vlerën 50.000 euro, ndërsa gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka deklaruar se burimi i shumës së dhënë hua shtetasit M. L. ka qenë nga shuma prej 140.000 eurosh e marrë hua nga shoqëria “{***}” ShPK. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në deklaramin e tij nuk ka asnjë pasaktësi, pasi ai ka deklaruar

⁶² Në përgjigjet e pyetësonit nr. 2.

⁶³ Pas kalimit të barrës së provës: “Duket se ka deklarime kontradiktore/të rreme të subjektit në lidhje me burimin e shumës së dhënë hua shtetasit M. L., për arsye se në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës 2015 dhe në deklaratën vetting, deklarohet si burim huaja marrë në vitin 2014 vjehrrës së tij prej 50.000 eurosh, ndërsa përgjatë hetimit deklarohet si burim një pjesë e shumës prej 140.000 eurosh marrë shoqërisë “{***}” ShPK, në vitin 2010.

kreditorin dhe debitorin e fundit, duke qenë se në momentin e deklarimit detyrimi ndaj shoqërisë “{***}” ShPK ishte shuar, vlerësohet i pabazuar në ligj, pasi referuar parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016, objekti i kontrollit janë pasuritë e subjekteve të rivlerësimit, në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të tyre në momentin e krijimit. Në këtë kontekst, pretendimi i subjektit që detyrimi ndaj shoqërisë “{***}” ShPK ishte shuar në momentin e plotësimit të DIPP-së para fillimit të detyrës së vitit 2015, mund të justifikojë vetëm mosdeklarimin e saj si detyrim ekzistues, por jo mosdeklarimin e saj si burim krijimi për huanë e dhënë shtetasit M. L. në vitin 2010. Edhe pretendimi tjetër i subjektit se ndodhej në pamundësi objektive për të plotësuar brenda një kutie formulari gjithë historikun e tij, vlerësohet i pakuptimtë, në kushtet kur kërkesat e formularit lidhur me elementët e deklarueshëm janë të mirëpërcaktuar, një nga të cilët është burimi në momentin e krijimit të pasurisë. Megjithatë, trupi gjykues, me qëllim për të vlerësuar faktin nëse ekzistenca e këtyre mospërputhjeve në deklarimet e subjektit e vendos atë në kushtet e një pasaktësie apo deklarimi të rremë në raport me deklaratën pasurisë *vetting*, verifikoi ekzistencën e burimeve që kanë shërbyer për dhënien e huasë në vlerën 50.000 euro shtetasit M. L., bazuar në shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe që trajtohen në vijim.

70. Subjekti ka pretenduar në ankim se *Komisioni ka gabuar në konkluzionin e tij lidhur me mosekzistencën e marrëdhënies me shoqërinë “{***}” ShPK, pasi përveç kontratës së huasë të lidhur mes tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK dhe deklaratës noteriale të shtetasit Sh. F., ekzistojnë një sërë provash⁶⁴ që e provojnë këtë fakt.*
71. Komisioni, në vendim, lidhur me huanë objekt vlerësimi, ka arsyetuar se: [...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me huanë e marrë shoqërisë “{***}” ShPK. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se kjo hua nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti. Marrëdhënia e huasë nuk u provua asnjëherë gjatë hetimit administrativ dhe mbetet në kuadër deklarativ, si nga subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe nga ortakut/administratori i shoqërisë “{***}” ShPK. Po kështu, nuk u provua me dokument të kohës kthimi i një pjese të huasë në shumën 90.000 euro, sikurse nuk u provua edhe kthimi i pjesës tjetër prej 50.000 eurosh pas 4 vjetësh në vitin 2014. -- Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, bashkë me prapësimet depozitoi një kontratë huaje (jo noteriale) e datës 22.03.2010 e lidhur me z. Sh. F. (administrator i shoqërisë “{***}” ShPK), për dhënien e huasë në shumën 140.000 euro subjektit për periudhën 22.03.2010 – 22.03.2015. Në faqen 1 të kësaj kontrate ka shënimin “gabim muaji, nuk mund të përdoret”. Ekzistenca e këtij dokumenti nuk është përmendur më parë nga subjekti. -- Në lidhje me datën e lidhjes së kontratës (meqenëse ishte dhe shkaku që sipas subjektit kontrata e huasë nuk u paraqit asnjëherë, pasi data 23.03.2010 ishte gabim dhe se data e saktë do të ishte shtator-tetori 2010), subjekti bie në kontradiktë me deklarimet e tij dhe me deklarimin e z. Sh. F. në deklaratën noteriale, datë 26.11.2021, ku deklaroi se në fillim të vitit 2010 kishte krijuar marrëveshje paraprake verbale me z. Emrror Kasaj për bashkëpunim dhe i ka dhënë cash shumën 140.000 euro. [...]”. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të

⁶⁴ (i) Material audio dhe i transkriptuar i një bisede të bërë mes tij dhe shtetasit M. L., të datës 09.12.2010, i cili është kallëzuar për veprën penale “Mashtrimi”, në të cilën, sipas subjektit, pranohet fakti që ai ka marrë hua nga shoqëria “{***}” ShPK; (ii) pjesë nga faqja e internetit google ku pasqyrohet lajmi i gazetës “{***}” i datës 26.07.2012, që vërteton faktin se regjistrimi i cituar më sipër është më i hershëm se viti 2014; (iii) procesverbal i sekuestrimit të provës materiale (telefonit të tij Samsung S8), për nevojën të procedimit penal nr. {***}/2019, të regjistruar për veprën penale mashtrimi parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. L.; (iv) vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, datë 20.11.2010, mbi bazën e kallëzimit të subjektit të rivlerësimit dhe vëllezërve A..

rivlerësimit, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

71.1 Gjatë hetimit administrativ, për të vërtetuar marrëdhënien e huasë me shoqërinë “{***}” ShPK dhe faktin se ajo ka shërbyer si burim për huanë e dhënë M. L., subjekti ka paraqitur⁶⁵ deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2021, të shtetasit Sh. F., në të cilën ai deklaroi se: *“Në fillim të vitit 2010 kam krijuar një marrëveshje paraprake gojore me z. Emror Kasaj [...] për bashkëpunim mbi ndërtimin që do të zhvillohej në pronën e tij që po blinte paraprakisht në {***} Tiranë. Për të ndihmuar përsheptuar procedurat në lidhje me sa më sipër i kam dhënë me mirëbesim z. Emror Kasaj cash shumë 140.000 euro, shumë të cilën e kam krijuar nga puna dhe nga biznesi që kam pasur dhe vazhdoj të kem edhe sot. [...] Meqë situata e ndërtimit u vështirësua, sepse prona nuk po i dorëzohej z. Emror Kasaj, unë i kërkoja kthimin e shumës dhe Emror Kasaj pas një viti ma kthen shumë prej 90.000 eurosh, shumë të cilën e kam marrë përsëri po cash. Ndërsa pjesën e mbetur prej 50.000 eurosh, ma shtyn me pretendimin se ia kishte marrë përkohësisht bashkëpronari i pronës që do të zhvillohej prej Emror Kasaj dhe kishte konflikt me bashkëpronarët me të cilët unë nuk kam kontakte dhe njohje. Përfundimisht dhe shuma e mbetur prej 50.000 eurosh më është kthyer nga Emror Kasaj në vitin 2014 po cash në dorë [...]”*;

71.2 I pyetur në vijim, mbi arsyen e mbajtjes së shumës prej 90.000 eurosh, për një vit painteres, faktin nëse gjatë këtij viti u përdor ose jo, arsyet e mbajtjes së pjesës tjetër prej 50.000 eurosh për katër vjet painteres, si dhe datat e dhënies së shumës prej 140.000 eurosh dhe datat e kthimit të shumave 90.000 euro e 50.000 euro, subjekti ka sqaruar⁶⁶ se: *[...] datën e saktë kur i kam marrë nga shoqëria ndërtuese këto para nuk e mbaj mend, ndërsa data e kthimit të një pjese të tyre shoqërisë (90.000 euro) ka qenë në vitin 2011, pasi kisha rënë viktimë e mashtrimit të ortakut tim M. L., i cili me anë të mashtrimit më mori 50.000 euro nga kjo shumë. Siç kam sqaruar, në lidhje me marrjen dhe kthimin e tyre nga shoqëria “{***}” nuk kam dokumente, pasi kemi vepruar në kushte mirëbesimi për shkak të njohjes dhe respektit reciprok, por këtë marrëdhënie e vërtetoj, jo vetëm me deklaratën noteriale të lëshuar nga vete ortakut i vetëm i shoqërisë “{***}”, por edhe me faktin që një pjesë të tyre, prej 50.000 eurosh, ma ka marrë ortakut im, mashtruesi M. L.. Ky fakt është i provuar me anë të një procesi penal në ngarkim të tij, për veprën penale të mashtrimit me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. [...] Në lidhje me dhënin e shumës 90.000 euro për rreth një vit painteres dhe shumës 50.000 euro për katër vjet painteres nga shoqëria “{***}”, ju sqaroj se këto para më janë dhënë në të njëjtën ditë në shumë 140.000 euro dhe jo në dy marrëveshje të ndryshme. [...] Këto para, shoqëria “{***}” e gjeti të arsyeshme të mi jepte painteres, pasi ajo do të ishte shoqëria ndërtues dhe kishte interesin e saj që mosmarrëveshja ime me shitësin të zgjidhej sa më shpejt, shitësi të lironte pronën dhe shoqëria të mbaronte procedurat me lejen e ndërtimit. Këto para nuk do t'i ktheheshin cash nga ana ime shoqërisë, por do të llogariteshin në momentin e ndarje së përqindjes takuese. [...] Është e vërtetë që megjithëse nuk u realizua deri në këtë kohë marrëveshja me shoqërinë “{***}”, jo për faj të saj, pronari i saj nuk më ka kërkuar asnjë lloj pagese për kohën që i kam vonuar paratë e tij, por ai e di se në çfarë shtate*

⁶⁵ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

⁶⁶ Përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

jam ndodhur. Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjeve të tij, disa shkresore⁶⁷ në lidhje me shtetasin M. L.;

71.3 Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit⁶⁸, subjekti duke parashtruar të njëjtat argumente si gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, ka depozituar: (i) kontratë huaje (me shkresë të thjeshtë), që mban datën 22.03.2010, të lidhur mes huamarrësit Emror Kasaj dhe huadhënësit Sh. F., me objekt dhënien e një huaje në vlerën 140.000 euro, pa interes, me qëllim blerjen nga ana e huamarrësit të një sipërfaqe toke prej 1.000 m² të ndodhur në lagjen “{***}”. Kjo kontratë është lidhur për një afat 5-vjeçar (22.03.2010 - 22.03.2015) dhe mbi të rezultojnë shënimi me shkrim dore “*Gabim muaji nuk mund të përdoret*”; (ii) vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 20.11.2010, sipas së cilit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2010 të shtetasve Emror Kasaj e A. Sh. ndaj shtetasit H. A. dhe nga ana tjetër kallëzimin e shtetasve H. A. ndaj kallëzuesit Emror Kasaj, ku në pjesën e përshkrimit të rrethanave, sipas procesverbaleve të kallëzimit, pasqyrohet, ndër të tjera, edhe fakti që kallëzuesi Emror Kasaj ka marrë një shumë prej 140.000 eurosh nga një firmë ndërtimi, duke i premtuar ortakëve të saj se do t’u linte të drejtën për të ndërtuar mbi këtë pronë.

72. Nga analiza e fakteve të mësipërme, në përgjigje të pretendimit të subjektit mbi besueshmërinë e ekzistencës së marrëdhënies së huasë, trupi gjyqësor vlerëson se kontrata e huasë e paraqitur me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, ndonëse nga pikëpamja e formës ka fuqinë e një shkrese të thjeshtë (private), në kuptim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile, krahasuar me aktin noterial që merr datë të saktë dhe regjistrohet në regjistrat publikë, mbart me vete dyshimin që akti të jetë krijuar prej palëve në një datë të mëvonshme nga sa pretendohet sipas shkrësës. Në rastin konkret, data në kontratën e huasë kontestohet nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në të tilla kushte lind nevoja që ky akt të vlerësohet në harmoni me deklaratat e interesave private, deklaratën e pasurisë *vetting* dhe qëndrimet e subjektit gjatë hetimit administrativ. Sa i takon deklaratën noteriale të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK e datës 26.11.2021, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, megjithëse e vlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia provuese e saj, hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, është e kufizuar, pasi vërtetësia e të dhënave të deklaruara në të nuk mbështetet nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit apo dokumente të kohës në të cilën është krijuar marrëdhënia e huasë. Në mungesë të provueshmërisë së transaksionit të dhënies së shumës prej 140.000 eurosh hua, edhe

⁶⁷ (i) Procesverbal i sekuestrimit të provës materiale i datës 25.02.2019, aparat telefoni i markës “Samsung Galaxy S8”, që i përket Emror Kasaj; (ii) procesverbal për transkriptimin e regjistrimit të bisedës së regjistruar me telefon, të sekuestruar Emror Kasaj, i datës 28.02.2019, ky i fundit i shprehet bashkëbiseduesit të quajtur “L.”, ndër të tjera, se i ka borxh një shumë parash një personi pa përmendur emër apo shumën konkrete; (iii) regjistrim audio i titulluar “Regjistrimi i mashtruesit të kom pol 3”.

⁶⁸ Në lidhje me këtë hua, me rezultatet e hetimit, subjekti i kaloi barra e provës: (a) nuk ka deklaruar huanë e shoqërisë “{***}” ShPK, në DIPP-në para fillimit të detyrës 2015 dhe atë *vetting* si burim për shumën 50.000 euro dhënë hua M. L. në 2010, por e deklaroi atë vetëm në pyetësorë; (b) nuk ka provuar me dokumentacion ligjor marrjen e saj në vitin 2010 dhe as kthimin e saj në për shumën 90.000 euro në vitin 2011 dhe 50.000 euro në vitin 2014; (c) nuk ka paguar interesa për shumën e huasë edhe pse nuk u realizua ndërtimi dhe shoqëria “{***}” nuk ishte më palë e interesuar në këtë investim dhe subjekti nuk deklaroi të ketë njohje shoqërore me administratorin/ortakun e shoqërisë “{***}” ShPK; (d) ka deklarime kontradiktore në lidhje me shumën 140.000 euro, pasi në pyetësor fillimisht deklaroi se kjo shumë iu dorëzua shitësve për plotësimin e çmimit të objektit, ndërkohë më pas po në pyetësor deklaroi se kjo shumë nuk u përdor për blerjen e objektit dhe iu kthye shoqërisë në shumën 90.000 euro në vitin 2011 dhe 50.000 euro në vitin 2014. -- Edhe nëse do të merret e mirëqenë dhënia e shumës prej 140.000 eurosh, subjekti nga shoqëria “{***}” ShPK, duket se ai ka qenë në kushte papajtueshmërie me detyrën e OPGj, për shkak të kryerjes së disa veprimeve hetimore që kanë lidhje me procedimin penal {***}/2004.

dokumentet e tjera të referuara nga subjekti i rivlerësimit si prova të ekzistencës së kësaj marrëdhënieje vlerësohen se nuk provojnë marrëdhënien e huasë. Sa i takon akteve shkresore⁶⁹ të paraqitura nga subjekti me parashtrimet, lidhur me marrëdhënien e huasë me shtetasin M. L., trupi gjykues, me të njëjtin arsyetim si më lart, edhe nëse do t'i konsideronte ato me vlerë të plotë provuese, vlerëson se ato nuk sjellin ndonjë të re në drejtim të provueshmërisë së marrëdhënies së huasë me shoqërinë “{***}” ShPK, duke mos përmbushur kushtet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

73. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues duke mbajtur në konsideratë: (i) mungesën e deklaramit të huasë së marrë nga shoqëria “{***}” ShPK, si burim për huanë e dhënë shtetasit M. L., qoftë në deklaratën e pasurisë *vetting*, qoftë në DIPPFD-në e vitit 2015; (ii) deklaramin për herë të parë të marrëdhënies së huasë me shoqërinë “{***}” ShPK dhe përdorimit të saj si burim krijimi i huasë së dhënë shtetasit M. L. gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard; (iii) transaksionin në *cash* të një vlere të madhe monetare të marrë hua prej 140.000 eurosh painteres në vitin 2010 dhe kthimi po *cash* në vitet 2011 dhe 2014, i shumave 90.000 euro dhe 50.000 euro; -- vlerëson se subjekti ka dështuar të provojë ekzistencën e marrëdhënies së huasë me shoqërinë “{***}” ShPK dhe, për rrjedhojë, shuma prej 140.000 eurosh nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për dhënien e huasë në vlerën 50.000 euro shtetasit M. L.. Me qëllim për të konkluduar mbi faktin nëse subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua shtetasit M. L., trupi gjykues verifikoi ekzistencën e burimit të deklaruar në deklaratën *vetting* për dhënien e kësaj huaje, që është huaja e marrë nga znj. L. P., mbi bazën e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit që trajtohen në vijim.

Në lidhje me detyrimin ndaj nënës së bashkëshortes, znj. L. P., për huanë e marrë prej saj në vlerën 50.000 euro

74. Në lidhje me huan e marrë nga znj. L. P., Komisioni ka arritur në konkluzionin se: Shuma 73.000 euro, që ka shërbyer si burim për dhënien e huasë, është pasuri e fshehur e subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortes, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e germës “c” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm të parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. -- Subjekti me veprimet e tij, deklarimet kontradiktore, përfshirjen e personave të tretë për fshehjen e kësaj pasurie, shfaq elementë të një sjelljeje jo etike dhe jo të përshtatshme të një magjistrati, duke cenuar besimin e publikut të drejtësia, në kuptim të pikës 5, të nenit 61 e ligjit nr. 84/2016;
75. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm, duke pretenduar në ankim se: Fakti që ai i ka marrë paratë prej vjehrrës përmes bankës, provon në mënyrë të padyshimtë ekzistencën e marrëdhënies së huasë dhe se paratë e marra nëpërmjet bankës (shuma 7.000.000 lekë e tërhequr në datë 23.04.2014) kanë qenë të vjehrrës së tij, L. P. dhe bashkëshortja i ka investuar në Bono Thesari për llogari të nënës së saj. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka shpjeguar se e vjehrra kishte vendosur që kursimet t'i investonte në bono thesari, të cilat i emeton vetëm Banka e Shqipërisë në Tiranë, për këtë arsye ajo ka ardhur t'i depozitojë në Tiranë këto para. Duke qenë se nuk ishin në dijeni të faktit se banka në atë kohë nuk kishte emetuar bono thesari për shitje e, për pasojë, nuk mund të bëhej as blerja e

⁶⁹ Akt ekspertimi teknik telefoni nr. {***}, datë 20.02.2023, i ekspertit kriminalist V. H.; vërtetim i datës 05.07.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me gjykimin e çështjes civile me palë paditëse Emrro Kasaj dhe palë e paditur M. L..

tyre, vjehrra ishte detyruar t'i derdhte këto para në Raiffeisen Bank, për këtë arsye kishte autorizuar vajzën e saj që të kryente procedurat e blerjes së bonove të thesarit kur të bëhej emetimi nga banka. Nga shuma 73.000 euro, pasi është dhënë hua shuma prej 50.000 euro, pjesa tjetër e tërhequr nga llogaria i është dorëzuar përsëri nga bashkëshortja prindërve të saj.

76. Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni e ka mbështetur konkluzionin e tij në argumentet si vijojnë: (i) burimi i shumës prej 7.000.000 lekësh nuk janë para të marra hua nga vjehrra, pra, nuk kanë kaluar nga ajo tek subjekti, por janë para të tërhequra nga bashkëshortja e subjektit *cash* nga llogaria e nënës së saj për t'u depozituar më pas në emër të saj dhe për t'u tërhequr në vitin 2014; (ii) nuk u provua mundësia financiare e prindërve të bashkëshortes së subjektit për të krijuar shumën 73.000 euro; (iii) subjekti nuk u investua të bindë Komisionin për të provuar burimin e ligjshëm të shumës prej 7.000.000 lekësh të depozituar nga motra e tij M. E., për llogari të noteres D. K., më datë 24.04.2014, shumë e cila korrespondon me shumën e tërhequr një ditë më parë, më 23.04.2014, nga bashkëshortja e tij. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se Komisioni ka arritur në këto konkluzione, pasi ka kryer verifikime si në drejtim të ekzistencës së marrëdhënies së huasë me znj. P., ashtu dhe në drejtim të mundësisë financiare të saj për të dhënë hua nga burime të ligjshme shumën prej 50.000 eurosh.

77. Në vlerësim të shkakut të ankimit, në drejtim transaksionit bankar që pretendohet se provon marrëdhënien e huasë, trupi gjykues, referuar historikut të veprimeve bankare të kryera nga nga vjehrra e subjektit L. P. dhe bashkëshortja e tij E. K. konstaton se:

77.1 Në datën 05.04.2011, znj. L. P. depoziton *cash* në llogarinë e saj në euro, me nr. {***}, në Raiffeisen Bank ShA⁷⁰, shumën prej 73.000 eurosh me përshkrimin “*të ardhura kursime familjare*”, shumë e cila kalohet po atë ditë në depozitë me afat. Të gjitha veprimet e kryera, më pas, në këtë llogari deri në mbylljen përfundimtare të saj janë kryer nga bashkëshortja e subjektit, e cila është autorizuar nga nëna e saj, L. P. për të kryer veprime në këtë llogari që nga data e hapjes së saj⁷¹, më 05.04.2011; -- në datën 05.11.2011 znj. E. K., person i autorizuar tërheq 3.000 euro. Gjithashtu, ka tërhequr *cash* interesat e akumuluar gjatë periudhës dhe në datën 23.10.2012 ka mbyllur llogarinë, duke tërhequr *cash* shumën 70.000 euro; -- në datën 24.10.2012, znj. K. ka depozituar *cash* në llogarinë e saj me nr. {***}, pranë Raiffeisen Bank ShA., shumën 9.720.000 lekë, me përshkrimin “*derdhur nga konvertimi euro/lekë tërhequr nga depozita në euro*”, duke investuar në të njëjtën ditë shumën 9.700.000 lekë, në bono thesari, me afat 1-vjeçar, me datë emetimi 01.11.2012.

77.2 Referuar kartelës së klientit në Bankën e Shqipërisë për znj. E. K.⁷², konfirmohet se me maturimin e bonove të thesarit në datën 31.10.2013, pas pagesës së tatimit mbi fitimin për interesat, shuma prej 1.139.946 lekësh (500.000 lekë tërhequr *cash* dhe 700.000 lekë transferuar përsëri te BoA në datën 21.11.2013, për blerje bono thesari) është kaluar në llogarinë rrjedhëse të znj. E. K., në Raiffeisen Bank ShA, ndërsa pjesa tjetër prej 8.500.000 lekësh është bllokuar për pjesëmarrje në ankandin e radhës dhe në datën 14.11.2013, janë riinvestuar në bono thesari me afat 1-vjeçar. Gjithashtu, shuma prej 1.000.000 lekësh (interesa + shumën 700.000 lekë) është riinvestuar në bono thesari me afat 1-vjeçar në datën 02.12.2013.

⁷⁰ Referuar shkresës së përcjellë nga Raiffeisen Bank, me nr. {***} prot., datë 10.02.2020.

⁷¹ Referuar shkresës së përcjellë nga Raiffeisen Bank, me nr. {***} prot., datë 25.11.2021.

⁷² Referuar shkresës së përcjellë nga Banka e Shqipërisë, me nr. {***} prot., datë 19.11.2021.

77.3 Në datën 07.02.2014, në llogarinë e depozitës në lekë të znj. E. K., me nr. {***}⁷³, është kredituar me transfertë shuma prej 955.512,39 lekësh, me përshkrimin “*kalim në llogari të E. K. shit-blerje bono thesari*”, e cila rrjedh nga thyerja e kontratës 1-vjeçare të bonove të thesarit (shuma 1.000.000 lekë) të emetuara në datën 02.12.2013. Në datën 18.04.2014, në llogarinë rrjedhëse në lekë të znj. E. K., me nr. {***}, është kredituar me transfertë shuma prej 8.291.109,47 lekësh, me përshkrimin “*kalim në llogari të E. K. shitblerje bono thesari*”, e cila rrjedh nga thyerja e kontratës 1-vjeçare të bonove të thesarit (shuma 8.500.000 lekë) të emetuara në datën 14.11.2013. Nga kjo transfertë, shuma prej 7.000.000 lekësh është tërhequr në datën 23.04.2014 dhe pjesa e mbetur është tërhequr gradualisht deri në vitin 2015.

78. Veprimet bankare të mësipërme, që nga depozitimi i shumës prej 73.000 eurosh nga L. P. më datë 05.04.2011, autorizimi i znj. E. K. për të kryer veprime vetëm lidhur me këtë llogari (ndërkohë që L. P. dispononte edhe llogari të tjera bankare, veprimet e të cilave i kryente vetë), tërheqja e shumës 70.000 euro nga kjo e fundit dhe kryerja e veprimeve vijuese për llogari të vetë znj. K. përmes investimit të tyre, si dhe tërheqja plotësisht nga sistemi bankar më datë 23.04.2014, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk përbëjnë qoftë edhe në tërësinë e tyre një transaksion bankar që provon marrëdhënien e huasë së pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Përkundrazi, trupi gjykues vlerëson se sjellja e bashkëshortes së subjektit në raport me këtë shumë, nga momenti i tërheqjes së saj në Raiffeisen Bank ShA, në vitin 2011, duke u investuar në bono thesari, e deri në vitin 2014 kur u tërhoq përfundimisht prej saj, ngre dyshime mbi natyrën e kësaj marrëdhënieje. Në këto rrethana, me qëllim për të legjitimuar ekzistencën e dyshimeve për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, u vlerësua të verifikohen edhe konkluzionet e Komisionit mbi mungesën e burimeve financiare të ligjshme të prindërve të bashkëshortes për të krijuar shumën prej 50.000 eurosh, pjesë e shumës prej 73.000 eurosh⁷⁴ të depozituar në bankë nga znj. L. P., si dhe atë të ngjashmërisë së kësaj vlere (50.000 euro) me të njëjtën vlerë të depozituar nga e motra M. K., një ditë pas tërheqjes së shumës objekt shqyrtimi nga E. K., bazuar në shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim.
79. Subjekti i rivlerësimit ka përsëritur në ankim shpjegimet e dhëna në kundërshtim të rezultateve të hetimit, lidhur me aftësinë paguese të vjehrrit dhe vjehrrës. Konkretisht, në lidhje me vjehrrën, znj. L. P., subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: *Pas rrëzimit të sistemit në vitin 1990 privatizoi shoqërinë shtetërore të shportarisë në vendin e quajtur Uji i Ftohtë, Vlorë, duke krijuar shoqërinë tregtare “{***}” ShA, në të cilën ka pasur të punësuar rreth 50 punëtorë. [...] Këto të dhëna janë zhdukur pas trazirave të vitit 1997, në Vlorë, por ekzistenca e kësaj shoqërie anonime provohet me vendimet e gjykimit civil të dorëzuar pranë Komisionit mes vjehrrës L. P. dhe personit që kishte nisur procedurat e privatizimit, si dhe dokumentacionin e sigurimeve shoqërore të vjehrrit, sipas të cilave vërtetohet se një ndër subjektet që ka derdhur sigurimet shoqërore ka qenë edhe “{***}”. Sipas subjektit, edhe vërtetimi i marrë nga Dega e Tatimeve Vlorë, që këto të dhëna janë zhdukur, tregon pamundësinë e tij objektive për t’i siguruar këto të dhëna, pikërisht për shkak të humbjes së tyre në organet shtetërore. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur ankimit dhe kërkon të merret në cilësinë e provës edhe shkresa kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 25.11.2021, e*

⁷³ Referuar shkresës së përcjellë nga BKT, me nr. {***} prot., datë 14.02.2020.

⁷⁴ Subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard ka deklaruar si burim për krijimin e shumës 73.000 euro të depozituar nga vjehrra e tij, znj. L. P., në Raiffeisen Bank, në datën 05.04.2011, të ardhurat nga puna dhe aktivitetet financiare në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit, K. dhe L. P..

DRT-së Vlorë, sipas së cilës: “Nga verifikimet e kryera në zyrën e kontabilitetit, znj. L. P. figuron e regjistruar si administratore pranë subjektit “{***}” ShPK me kod fiskal {***}, regjistruar me vendim gjykate nr. {***}, datë 02.11.1993. Për këtë subjekt nuk rezultojnë pagesa në sistemin e kontabilitetit”. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, nga aktet në fashikullin e Komisionit në lidhje me punësimin e znj. L. P., trupi gjykues konstaton se:

79.1 Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se L. P. në vitin 1990 ka privatizuar ish-Ndërmarrjen {***} Vlorë, duke krijuar shoqërinë anonime “L. P.” ShA. Kjo shoqëri ka pasur rreth 50 punëtorë dhe ka funksionuar për periudhën 1993 – 1996. Në vitin 1996 është bllokuar ky aktivitet, sepse objekti ku zhvillohej aktiviteti iu kthye pronarit⁷⁵[...]. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar shkresën nr. {***} prot., datë 21.01.2020, të DRT-së Vlorë, sipas së cilës në listëpagesat që ndodhen nën administrimin e saj (dhjetor 2011 e në vazhdim) znj. L. P. nuk figuron e regjistruar si punëdhënëse apo punëmarrëse, informacion i konfirmuar gjatë hetimit administrativ edhe Komisionit nga ky institucion⁷⁶. Në vijim, me qëllim për të provuar ekzistencën e aktivitetit të ushtruar nga znj. P., subjekti ka paraqitur disa vërtetime dhe kopje të librezës së punës për vjehrrën dhe vjehrrin e tij, për të vërtetuar punësimin e tyre në këtë shoqëri, si dhe mendimin e pakicës së gjyqtarit V. S., pjesë e vendimit të Gjykatës së Rrethit Vlorë, të datës 26.12.2002, në çështjen civile me paditës L. P. dhe i paditur P. B. etj., me objekt shpalljen e pavlefshmërisë së kontratës së privatizimit të datës 04.02.1994, lidhur mes Ndërmarrjes {***} e AKKP Vlorë dhe P. B. [...];

79.2 Veç sa më lart, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe atij të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se: (i) referuar kopjes së librezës së punës (dosja e pensionit) të znj. L. P. rezulton se ajo ka qenë e punësuar si presidente të “{***}” në periudhën 01.11.1993 - 31.12.1993 (data e pezullimit të punës) dhe në periudhën 01.06.1994 - 28.02.1996 (data e mbylljes së firmës); (ii) referuar vërtetimit me nr. {***} prot., datë 20.04.2011, të lëshuar për efekt pensioni nga DRSSH-ja Vlorë, konfirmohet se znj. L. P. rezulton të jetë e siguruar pranë subjektit “{***}” për harkun kohor 01.11.1993 – 31.12.1993 (dy muaj); (iii) referuar dy vërtetimeve për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për efekt pensioni të lëshuara nga DRSSH-ja Vlorë, L. P. ka realizuar të ardhura për periudhat qershor 1994 – shkurt 1995 dhe shtator 1995 – shkurt 1997. Totali i pagave *bruto* për periudhat e mësipërme është 68.240 lekë, ndërsa totali i pagave *neto* është 65.382 lekë; (iv) referuar shkresës “Kthim përgjigje” me nr. {***} prot., datë 15.03.2022, të DRT-së Vlorë, konfirmohet se nga verifikimet e kryera në C@TS (sistemi informatik tatimor), pranë zyrës së kontabilitetit, si edhe në arshivë nuk disponohet asnjë informacion lidhur me shoqërinë anonime “{***}” ShA; (v) referuar shkresës me nr. {***} prot., datë 15.03.2022, të DRT-së Vlorë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 17.03.2022, në Komision, informohet se *pranë zyrës së kontabilitetit, si dhe në arshivën e DRT-së Vlorë nuk disponohet asnjë informacion lidhur me shoqërinë anonime “{***}” ShA me adresë lagjja “Uji i Ftohtë”*.

80. Në analizë të dokumentacionit të mësipërm, trupi gjykues vëren se znj. L. P. ka qenë e punësuar dhe ka përfituar të ardhura si presidente të “{***}” në periudhat 01.11.1993 - 31.12.1993 dhe 01.06.1994 - 28.02.1996. Ndonëse evidentohen gjurmë të aktivitetit të ushtruar prej saj si

⁷⁵ Sipas subjektit, shtetasi P. B. ka siguruar një vendim të Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronave Vlorë, sipas së cilit objekti ku shoqëria ushtronte aktivitetin i ishte njohur dhe kthyer atij.

⁷⁶ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 25.11.2021, nga DRT-ja Vlorë, sipas së cilës L. P. nuk figuron e regjistruar si tatimpaguese apo si punëmarrëse në regjistrat e administratës tatimore.

administratore e subjektit “{***}” ShPK, trupit gjykues nuk i rezulton e provuar me dokumentacion shuma e konkrete e të ardhurave të përfituara dhe pagesa e detyrimeve tatimore, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në mungesë të informacionit të plotë mbi vlerën e të ardhurave të përfituara nga puna për znj. L. P. për periudhën 1993 – mars 2011, në analizën financiare të mundësisë të krijimit të shumës 50.000 euro, pjesë e shumës prej 73.000 eurosh të depozituar në bankë në datën 05.04.2011 nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, të ardhurat nga puna për znj. L. P. do të pasqyrohen në vlerën prej 65.382 lekësh. Trupi gjykues e gjen të pabazuar edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur të dhëna mbi të ardhurat e vjehrrës nga aktiviteti i shoqërisë “{***}” ShA, sa kohë që dokumentacioni i paraqitur nga subjekti apo i siguruar nga Komisioni nuk ia atribuon në asnjë rast mungesën e informacionit në lidhje me të ardhurat e L. P., mosekzistencës së tyre e, aq më tepër, ngjarjeve të vitit 1997. Shkresa kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 25.11.2021, e DRT-së Vlorë, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, si lartcitur, përmban të njëjtin informacion të administruar edhe nga Komisioni gjatë hetimit administrativ⁷⁷, duke mos përmbushur kriteret e një prove të re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Lidhur me aktet e depozituara⁷⁸ me parashtrimet e datës 28.03.2025, pavarësisht se ato nuk plotësojnë kërkesat e neneve 47 dhe 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, trupit gjykues vëren se ato nuk kapërcejnë as kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” e ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e tyre duket e panevojshme apo pretendojnë të provojnë fakte, që edhe nëse pranohen të vërteta nuk ndikojnë në vendimmarrjen përfundimtare. Konkretisht, nga analizimi i tyre në unitet me njëra-tjetrën përftohet informacion për ekzistencën e një shoqërie që nga viti 1993, e quajtur “{***}”, në të cilën L. P. ka qenë bashkëpronare e më pas pronare, që ka ushtruar aktivitetin e prodhimit e tregimit të shportave, ku punonin një numër i caktuar punonjësish, por jo për fitimin e kësaj shoqërie, të ardhurat e përfituara dhe pagesën e detyrimeve tatimore në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Edhe nga shkresa e autoriteteve doganore, në vlerësimin e trupit gjykues, përftohet informacion mbi pamundësinë e të dhënave lidhur me aktivitetin e shoqërisë anonime në drejtim të eksporteve, por nuk mund të provojë pamundësinë për të siguruar të dhëna për fitimin e shoqërisë.

81. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se vjehri K. P. ka pasur biznes pa shkëputje që pas vitit 1995 në fushën e tregtimit të materialeve të ndërtimit dhe veglave të punës, por

⁷⁷ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 25.01.2022, nga DRT-ja Vlorë.

⁷⁸ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2025, e znj. L. P., pronare e shoqërisë anonime {***}-Vlorë; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2025, e ish-punonjësës së shoqërisë anonime {***} Vlorë, znj. F. N.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2025, e ish-punonjësës së shoqërisë anonime, {***}, znj. Sh. N. (Sh.); deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.02.2025, e ish-punonjësës së shoqërisë anonime, znj. M. K.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.02.2025, e ish-punonjësës, znj. N. T.; kërkesë e datës 07.11.2024 e znj. L. P. dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 11.11.2024, e ISSh Drejtoria Rajonale Vlorë, për përcjelljen e dosjes së shoqërisë “{***}”, dosjen e pensionit të shtetaseve L. P. dhe K. P.; kërkesë e datës 12.02.2025 dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 13.02.2025, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas së cilës: Dokumentacioni i doganës së degës Vlorë është djegur në vitin 1997. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë, si çdo institucion tjetër, ka pamundësi që të ruajë (arkivojë) dokumentacion doganor të përpunuar para tridhjetë vjetësh. Nga ana jonë, në mënyrë të vazhdueshme, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Arkivave, procedohet me seleksionimin/asgjësimin e dokumentacionit, sipas afateve të parashikuara në ligji. Gjithashtu, sistemi ynë teknologjik Asycuda World, ka filluar zbatimin e tij në fund të vitit 2004. Si rrjedhim e kemi të pamundur në dhënien e informacionit të kërkuar nga ana juaj; vendim nr. {***}, datë 12.07.1995, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përmes së cilit paditësja L. P. detyrohet t’i paguajë të paditurës A. M. shumën prej 216.000 lekësh; vendim nr. {***}, datë 22.12.1994, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përmes së cilit shtetaset A. M., N. B., H. Y., F. O. dhe H. T. duhet t’i kthejnë palës paditëse shumën prej 955.71 lekësh; relacion financiar i ekspertit E. M..

*llogaritë e tij bankare nuk pasqyrojnë të vërtetën e fitimeve nga ky aktivitet, pasi 95% e klientëve të biznesit të tij i kryenin pagesat dorazi, ndërkohë që të vetmit klientë që operojnë me bankë janë entet publike⁷⁹ dhe shoqëria “{***}” ShA. Vjehrrin e tij ka pasur edhe një biznes tjetër në fushën e blloqeve të ndërtimit për të cilin disponon vetëm një kontratë qiraje të tokës mbi të cilën ushtronte këtë aktivitet. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës bashkëlidhur ankimit kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.09.2006, me objekt marrjen me qira të objektit {***} dhe truall me sipërfaqe 400 m², për periudhën 01.09.2006-01.09.2009 për shfrytëzimin “Prodhim blloqesh”. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në lidhje me të ardhura të përfituara nga vjehrrin K. P., trupi gjykues konstaton se:*

81.1 Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me vjehrrin K. P., subjekti ka shpjeguar⁸⁰ se për periudhën 1991 – 1995 ka qenë emigrant në Greqi. Në vitet 1995 – 2002 ka ushtruar aktivitetin si shitës fruta-perime me automjet (kamion). Nga viti 2002 dhe në vazhdim ka ushtruar aktivitetin tregtar në fushën e shitjes së materialeve të ndërtimit. Në vitet 2004 – 2008 ka pasur një pikë inertesh ku merrej me prodhimin e blloqeve të betonit për ndërtime të ndryshme, në funksion të të cilit ka pasur edhe një kamion vetëshkarkues. Edhe ky aktivitet ka qenë i paregjistruar. Më tej, ka shpjeguar⁸¹ se biznesi i vjehrrit për nga natyra është biznes ku likuidimet bëhen me para në dorë, vetëm një pjesë e klientëve që punojnë me TVSH i derdhin me bankë, kështu që, shumat e pasqyruara në llogaritë rrjedhëse të vjehrrit janë vetëm një pjesë e vogël e shumave reale të fitimit. Subjekti ka depozituar disa lëvizje të llogarive bankare të vjehrrit, të cilat, sipas tij, konfirmojnë derdhje të shumave monetare nga shoqëria {***}, Vlorë, për blerje materiale ndërtimi apo klientë të ndryshëm;

81.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se z. K. P. figuron i regjistruar si person fizik “{***}”, me NIPT {***}, që nga data 25.03.2003. Gjithashtu, ai rezulton i regjistruar si person fizik për të ushtruar veprimtarinë private në fushën e transportit automobilistik të mallrave, me vendimin nr. {***}, datë 07.02.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, por nuk gjendet NIPT. Në mungesë të informacionit të plotë mbi fitimin e realizuar në vitet 2003 – 2008⁸², trupi gjykues përllogarit fitimin e mundshëm njësoj si Komisioni, bazuar në normën mesatare të fitimit për vitet 2009-2011. Nga kjo përllogaritje personi fizik “{***}” për periudhën prill – mars 2011, rezulton me një fitim total prej 3.102.000 lekësh. – Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga puna⁸³, rezulton se z. P. ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “{***}”, si punëtor në periudhën 01.12.1995 – 29.02.1996. Ai ka realizuar të ardhura⁸⁴ për periudhat dhjetor 1995 – shkurt 1996 dhe janar 2006 – mars 2011. Në periudhën janar 2006 – mars 2011, z. K. P. ka ushtruar aktivitet tregtar, i regjistruar si person fizik. Nga dokumentacioni i disponuar mbi lëvizjet e llogarive bankare, nuk përftohet informacion nëse të ardhurat e përmendura në vërtetimin e DRSSh-së Vlorë kanë kaluar nga llogaria bankare e personit fizik “{***}”, në llogarinë e tij personale e, për

⁷⁹ Bashkia Vlorë, Porti Vlorë, Ujësjellës Kanalizime Vlorë.

⁸⁰ Në përgjigjet e pyetësorit standard.

⁸¹ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

⁸² Për vitin 2005, qarkullimi i deklaruar është 2.600.000 lekë, për fitimin s’ka informacion; për vitin 2006 qarkullimi është 2.000.000 lekë, për fitimin nuk ka informacion; për vitin 2009 qarkullimi është 2.100.000 lekë, kurse fitimi 480.000 lekë; për vitin 2010 qarkullimi është 1.500.000 lekë, kurse fitimi 225.000 lekë; për vitin 2011 qarkullimi është 1.680.000 lekë, kurse fitimi 480.000 lekë.

⁸³ Referuar kopjes së librezës së punës (dosja e pensionit).

⁸⁴ Referuar dy vërtetimeve për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për efekt pensioni të lëshuara nga DRSSh-ja Vlorë.

rrjedhojë, nuk do të merren në konsideratë. Për periudhën dhjetor 1995 – shkurt 1996 totali i pagave *bruto* është 11.380 lekë, ndërsa totali i pagave *neto* është 10.176 lekë. –Me parashtrimet e depozituara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe disa akte të tjera shpresore⁸⁵ në mbështetje të pretendimit të tij se përveç aktivitetit privat të regjistruar në organet tatimore, vjehrrin i tij K. P. ka pasur edhe aktivitet privat të paregjistruar në fushën e prodhimit dhe shitjes së blloqeve të ndërtimit, si dhe transportit të materialeve të ndërtimit, me fitimet e të cilit ka mbuluar shpenzimet e jetesës.

82. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues, në mungesë të informacionit të plotë mbi vlerën e të ardhurave të përfituara nga puna dhe aktiviteti tregtar për z. K. P. për periudhën 1993 – mars 2011, vlerëson që në analizën financiare të mundësisë së krijimit të shumës 50.000 euro, pjesë e shumës prej 73.000 eurosh të depozituar në bankë në datën 05.04.2011, nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, të ardhurat totale për z. K. P., që përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të pasqyrohen në vlerën prej 3.112.176 lekësh⁸⁶. Kontrata e qirasë me objekt marrjen me qira të një objekti dhe truallit përkatës në periudhën 01.09.2006-01.09.2009 për shfrytëzimin “Prodhim blloqesh”, paraqitur në cilësinë e provës bashkëlidhur ankimit, pavarësisht mosplotësimit të kriterit formal, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, analizuar nën dritën e nenit 49, pika 6 e ligjit nr.84/2016, dëshmon për gjurmë të ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të blloqeve, por nuk sjell asnjë informacion të dobishëm në drejtim të të ardhurave të realizuara e, aq më pak, në drejtim të ligjshmërisë së tyre, për sa kohë bëhet fjalë për një aktivitet të paregjistruar. Aktet shpresore të paraqitura nga subjekti me parashtrimet, në vlerësimin e trupit gjykues, jo vetëm që nuk plotësojnë kërkesat e neneve 47 dhe 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, por nuk kapërcejnë as kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, pasi ndonëse evidentohen gjurmë të ushtrimit të një aktiviteti të tillë, ato nuk provojnë të ardhura të ligjshme të vjehrrit, sikurse konfirmohet edhe nga vetë subjekti në parashtrime se *nuk kërkojmë përfshirjen në bilanc të të ardhurave të konsiderueshme që këto biznese kanë gjeneruar, por një fakt i tillë duhet t’i shërbejë Kolegjit për të kuptuar se të ardhurat e llogaritura duke u mbështetur në dokumentacion ligjor për vjehrrin tim janë shumë më të vogla sesa të ardhurat reale*”. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje se vlera e të ardhurave të ligjshme të vjehrrit K. P. e përfshirë në analizën financiare në Kolegj është vetëm 10.503 lekë më pak, nga vlera e përlllogaritur për këto të ardhura në relacionin financiar të paraqitur nga subjekti në parashtrime, pra, një diferencë e pakonsiderueshme;
83. Pretendimi i ngritur në parashtrime se analiza financiare për mundësinë e prindërve të bashkëshortes për dhënien e huasë në vlerën 50.000 euro duhet të kryhet deri në vitin 2014, pasi huaja nga vjehrra është marrë prej tij në këtë vit, në vlerësimin e trupit gjykues, çmohet i pabazuar, pikërisht, për faktin se vetë subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se burimi i shumës prej 50.000 eurosh të dhënë hua nga vjehrra janë kursimet e saj në vlerën 73.000 euro të depozituara në Raiffeisen Bank ShA. Ndërkohë, nga hetimi administrativ, ka rezultuar e

⁸⁵ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2025, e shtetasi K. P.; kërkesë e datës 22.05.2024, e K. P. dhe kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 29.05.2024, nga DRT-ja Vlorë; kërkesë e datës 22.05.2024, e K. P. dhe kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 03.06.2024, nga Bashkia Vlorë; kërkesë e datës 22.05.2024, e K. P. dhe kthim përgjigje nga DPSHTRr-ja, në të cilën konfirmohet se shtetasi K. P. ka pasur në pronësi mjetin me targa {***}; relacion financiar i ekspertit E. M..

⁸⁶ Të ardhurat nga aktiviteti tregtar (3.102.000 lekë) + të ardhurat nga puna (10.176 lekë). Në lidhje me përlllogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti tregtar për K. P., trupi gjykues i është referuar të dhënave të shkresës me nr. {***} prot., datë 25.11.2021, informacioni i së cilës përputhet me informacionin e dërguar nga QKB-ja dhe me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorë.

provuar se kjo shumë (73.000 euro) është depozituar *cash* nga L. P. në datën 05.04.2011, në Raiffeisen Bank ShA

84. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues kontrolloi analizën financiare të Komisionit mbi mundësinë e krijimit me burime të ligjshme të shumës prej 50.000 eurosh të dhënë hua nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, pjesë e shumës prej 73.000 eurosh të depozituar prej tyre në Raiffeisen Bank ShA në datën 05.04.2011 dhe të pretenduar nga subjekti si burim për dhënien e huasë shtetasit M. L., deri në datën 05.04.2011. Gjatë këtij kontrolli, trupi gjykues i Kolegjit në ndryshim nga Komisioni mbajti në konsideratë jurisprudencën e tij në drejtim të verifikimit të ë ligjshmërisë në kufijtë e shumës së dhënë hua, të referuar edhe nga subjekti në parashtrime⁸⁷, sipas së cilës vlerësimi duhet të bazohet në raportin që krijohet mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve për jetesë të huadhënësit. Parë edhe në këtë qasje, trupit gjykues i rezulton se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë qenë në pamundësi financiare me të ardhura të ligjshme për dhënien hua të shumës prej 50.000 eurosh, në vlerën e plotë të saj.
85. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *e motra M. E. nuk është “person i lidhur” i tij, pasi mes tyre nuk ka ndonjë marrëdhënie borxhi apo shitblerje pasurie*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka parashtruar se *motra, ashtu si dhe burri i tezes, mbeti në tentativë të blerjes së pasurisë së ortakut të tij. [...] për të mos lënë shteg për dyshime se kam ndonjë gjë për të fshehur në lidhje me këtë fakt, i bëj me dije Kolegjit se motra ime, e cila banon në ShBA që prej rreth 20 vjetësh, martuar atje, shumë e sipërcituar prej 7.000.000 lekësh e ka të ardhur nga paga e vetëm 5-6 muajsh pune, e po kaq edhe bashkëshorti i saj. Arsyeja që këto para nuk i dërgoi nëpërmjet bankës është se rreth 3 vite më parë nga depozitimi i tyre në llogari të noteres, i kishte sjellë dorazi me qëllim që të ndërtonte katin e tretë të banesës dykatëshe që kisha unë me vëllain dhe prindërit. Kjo për faktin se ajo ka pasur dëshirë që të ketë një banesë pranë prindërve dhe vëllezërve të saj. Duke qenë se nuk kishte për të bërë blerje pasurie me këto para, nuk e pa të arsyeshme t’ia dërgonte babait tonë nëpërmjet bankës. Por pasi ka sjellë këto para, babai ynë është sëmurur [...] ka ndërruar jetë në datën 01.09.2015, kështu që ndërtimi i katit të tretë nga babai për motrën time ishte bërë i pamundur. [...] Në ngritjen e këtij pretendimi, subjekti i referohet paragrafit 2.15.4 të vendimit të Komisionit, sipas së cilit: “Subjekti nuk ka shpjeguar se ku është disponuar shuma e konsiderueshme prej 7.000.000 lekësh nga motra e tij, si është sjellë kjo shumë në Shqipëri, për çfarë do të investohet në Shqipëri në një kohë që e motra M. J. jeton dhe punon në ShBA, si dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj”. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar fashikullit të hetimit administrativ, konstaton se:*

85.1 Me prokurën e posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.9.2016, M. (K.) E., banuese në ShBA, emëron si përfaqësues të posaçëm vëllain e saj Emror Kasaj, të cilit i jep tagër dhe kompetencë të plotë që ta përfaqësojë edhe në mungesë, duke i dhënë, ndër të tjera, tagrat: *“Përfaqësuesi im ka të drejtë të paraqitet pranë zyrës noteriale të noteres D. K., me qëllim të tërheqë shumë prej 7.000.000 lekësh, që unë kam depozituar pranë Raiffeisen Bank në llogarinë bankare të noteres, për blerjen e një pasurie, pasuria e llojit tokë arë me nr. {***}, z. k. {***}, ZVRPP Tiranë, pasi kjo kontratë nuk u realizua dhe për shumë e mësipërme ai mund të disponojë sipas dëshirës pa pasur asnjë kufizim nga ana ime. Kjo prokurë ka afat të pacaktuar dhe mbaron me kryerjen e porosive ose me revokimin e saj nga ana ime me një akt*

⁸⁷ Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 15, datë 17.07.2019 dhe (JR) nr. 20, datë 31.07.2019.

të dytë të njërës formë, duke u njoftuar personi i interesuar”. Noterja D. K. ka shpjeguar⁸⁸ se: “Shtetasja M. E. (K.), më datë 24.04.2014, ka kaluar në llogarinë time si notere shumë prej 7.000.000 lekësh pranë Raiffeisen Bank, për blerje pasurie e paluajtshme. Unë hartova draftin e kontratës së shitjes, por pala shitëse refuzoi të firmoste kontratën me mendimin se mund të vij në një moment tjetër, e prita disa ditë dhe nuk erdhi dhe kështu që ajo kontratë nuk u realizua. Shtetasja M. E. (K.) ka kaluar në llogarinë time shumë prej 7.000.000 lekësh pas asnjë akt noterial, vetëm me deklarin në bankë “Se dua të blej pasuri të paluajtshme në vlerën 7.000.000 lekë”. Më 20 gusht 2021, unë kam kaluar shumë prej 7.000.000 lekësh në numrin e saj të llogarisë pranë BKT-së, pasi nuk mund të mbaja fondin prej 7.000.000 lekësh në llogari, kur nuk por kryeja asnjë veprim [...]”. Me shpjegimet e saj, noterja ka përcjellë dy draft kontrata (të panënshkruara), sipas së cilave shtetasi M. L. parashikohej t’iu shiste shtetasve M. E. (e motra) dhe Nj. Xh. (burri i tezes), të përfaqësuar me prokurë nga subjekti, përkatësisht, 1/2 e godinës trekatëshe në proces legalizimi në vlerën 115.000 euro, si dhe ½ e sipërfaqes prej 1.000 m², që ai kishte në bashkëpronësi me subjektin, në vlerën 35.000 euro;

85.2 Referuar të dhënave bankare⁸⁹, rezulton se më datë 24.4.2014 M. E. depoziton në llogarinë e noteres shumë prej 7.000.000 lekësh, për blerje pasurie nr. {***}, shumë e cila i kthehet përsëri më datë 20.08.2021, për mosrealizim kontrate, në llogarinë dyemërore të hapur në BKT⁹⁰ më datë 16.08.2021, nga M. dhe A. K., në monedhën lekë;

85.3 I pyetur mbi natyrën e investimit të së motrës në vlerën 7.000.000 lekë, si dhe prokurën e lëshuar në vitin 2016, subjekti ka sqaruar se⁹¹: [...] motra ime, duke qenë se banon në ShBA dhe vjen në Shqipëri shumë rrallë, duke qenë se nuk kishte mundësi të ishte e pranishme vetë tek noteri ditën e kontratës, pasi mashtruesi M. L. nuk ishte i besueshëm dhe më kishte gënjyer shumë herë se do të paraqitej tek noteri, i ka derdhur në bankë këto para dhe më ka autorizuar mua për blerjen e pjesës së saj prej 1/3 që do shiste M.. [...] Kur motra ka ardhur në vitin 2016 në kohën që prindërit kanë qenë të dy në momentet e fundit të jetës, [...] mesa kujtoj më ka bërë prokurë që t’i përdorja unë këto para. Autorizimi nuk ka pasur qëllim që unë të përdor për interesa të mijat paratë e saj, [...], por që unë të investoja për interes të saj kur të dilte ndonjë rast i favorshëm. Meqë ajo nuk mund të ishte në Shqipëri për të përcaktuar objektin e prokurës në momentin e duhur, pasi nuk dihej se çfarë rasti i favorshëm mund të dilte, zgjodhëm si ide që në prokurë unë të kisha të drejtë t’i përdorja këto para si të miat [...];

85.4 Në përfundim të hetimit administrativ, pas u njoh me konstatimet e Komisionit, lidhur me mungesën e të dhënave mbi transferimin e shumës prej 7.000.000 lekësh nga M. E., në Shqipëri dhe depozitimin e saj më datë 24.4.2014 në llogarinë e noteres, ngjashmërinë e kësaj shume me shumën e tërhequr nga bashkëshortja një ditë më parë, më datë 23.04.2014, tagrat e dhëna subjektit të rivlerësimit nga e motra për të disponuar pa kufizim me shumën prej 7.000.000 lekësh dhe barrën e provës⁹², subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka shpjeguar: [...] meqenëse kontrata nuk u realizua dhe nuk kishim gjetur asnjë variant konkret për blerjen nga ana e saj të një banese pranë banesës sime dhe të vëllait, meqenëse ajo (e motra) nuk banon në Shqipëri, ku do të mund të nënshkruante vetë në rastin

⁸⁸ Shkresë kthim përgjigje e noteres D. K., regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 01.12.2021.

⁸⁹ Sipas aktit bankar “Nxjerrje llogarie” të datës 26.11.2021. të Raiffeisen Bank ShA.

⁹⁰ Shkresë nr. {***} prot., datë 21.12.2021, e BKT-së.

⁹¹ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

⁹² “Duket se llogaria bankare e L. P. në shumë 73.000 euro, deklaruar si burim për huanë 50.000 euro, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij”.

më të parë [...], më la mua të drejta të pakufizuara të merrem me këtë procedurë, sigurisht duke u konsultuar paraprakisht me të. [...] në këtë ngjashmëri nuk ka asgjë që shkon në kundërshtim me logjikën dhe rrjedhën e ngjarjeve, pasi këto dy shuma nuk ngjasojnë në kohë dhe në sasi vetëm me njëra-tjetrën, por edhe me një shumë tjetër të njëjtë në kohë dhe vlerë, por paund britanik të lëna së bashku me prokurën përkatëse nga burri i tezes sime Nj. Xh., të cilat unë i kam mbajtur rreth një muaj në kasafortën e kolegut tim në zyrën time në vitin 2014, në pritje të nënshkrimit të kontratës nga ortakut im M. L.. Pra, të dyja shumat nga 7.000.000 lekë dhe shuma e parave në pound britanike, të konvertuara në euro janë në fakt tri shuma me nga 50.000 euro, të cilat të tria bashkë bëjnë 150.000 euro (shuma totale e pjesës së pronës që pretendonte se do të shiste ortakut im M. L..[...]). Së bashku me këto shpjegime, subjekti ka paraqitur, ndër të tjera, edhe prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.02.2014, përmes së cilës i përfaqësuar Nj. Xh. ka emëruar si përfaqësues të posaçëm subjektin Emror Kasaj, për ta përfaqësuar në zyrën e noterisë për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së 1/6 të pasurisë tokë “arë”, me sipërfaqe 1.000 m², si dhe 1/6 pjesë të objektit informal trekatësh në proces legalizimi, në lidhje me regjistrimin e legalizimin e pasurive respektive apo në gjykatë për procese të ndryshme lidhur me pronën.

86. Për t’iu përgjigjur pretendimit të subjektit mbi mungesën e marrëdhënies së interesit mes tij dhe të motrës M. E., trupi gjykues konstaton se verifikimet e Komisionit, në lidhje me shumën prej 7.000.000 lekësh të derdhur prej saj në bankë në datën 24.04.2014, nuk janë kryer nën regjimin e parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr.84/2016, por bazuar në dyshimet se kjo shumë përbën një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Nga analizimi i fakteve të sipërcituara, konkretisht, referuar prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2016, trupi gjykues vëren se tagrat e dhëna subjektit për tërheqjen e shumës prej 7.000.000 lekësh nga banka dhe disponimin sipas dëshirës së subjektit, e të pacaktuar në kohë, i ngjajnë më shumë tagrave të një pronari mbi sendin. Krahas këtij fakti, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit pavarësisht se është njohur me konstatimin mbi mungesën e të dhënave, lidhur me mënyrën e transportimit të saj, si dhe dyshimin e Komisionit se shuma në fjalë mund të ishte një pasuri e fshehur, nuk ka bërë përpjekje për të provuar mënyrën e mbërritjes së tyre në Shqipëri e akoma më pak për burimin e ligjshëm të kësaj shume, për më tepër që një vlerë e tillë monetare e transportuar dorazi dhe jo nëpërmjet sistemit bankar do të duhej të ishte deklaruar me hyrjen e së motrës në territorin shqiptar, sipas kuadrit ligjor të parandalimit dhe pastrimit të parave. Sa i takon argumentit se shuma e depozituar nga e motra M. E., në bankë, më datë 24.04.2014, është e njëjtë edhe me shumën e lënë nga bashkëshorti i tezes, z. Nj. Xh., shumë e cila, sipas subjektit, mbahej prej tij në kasafortën e kolegut të zyrës e për të cilën i është dhënë prokura përkatëse, trupi gjykues vëren se në përmbajtje të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.02.2014, të sjellë në vëmendje nga subjekti në ankim, nuk parashikohet të jenë kaluar të drejta disponimi mbi ndonjë shumë monetare si në rastin e të motrës e, për këtë arsye, e gjen pa relevancë për referim.
87. Në vijim të sa më lart, duke mbajtur në konsideratë: (i) mungesën e provueshmërisë së transaksionit bankar mes L. P. dhe subjektit të rivlerësimit; (ii) mungesën e burimeve të ligjshme të L. e K. P. për të dhënë hua vlerën 50.000 euro; (iii) depozitimin në bankë të një shume prej 7.000.000 lekësh, nga e motra e subjektit, znj. M. E., në datën 24.04.2014, një ditë pasi një shumë monetare në të njëjtën vlerë ishte tërhequr nga bashkëshortja e subjektit, në kushtet kur nuk është provuar mënyra e hyrjes së kësaj shume në territorin shqiptar -- trupi gjykues arrin në konkluzionin se në lidhje me “Detyrim ndaj nënës së bashkëshortes, znj L. P.,

në shumën 50.000 euro”, subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

88. Në përfundim, në lidhje me huanë në shumën 50.000 euro të dhënë shtetasit M. L., trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë të burimit të krijimit të shumës së dhënë hua M. L., duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.
89. Përveç konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e kryera lidhur me huanë e marrë nga shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 140.000 euro, me qëllim për të mbuluar burimin real të huasë së dhënë shtetasit M. L., në vlerën 50.000 euro, si dhe deklaratimet e kryera, lidhur me huanë e marrë nga vjehrra, znj. L. P., për të mbuluar burimin e vërtetë të shumës së dhënë hua subjektit në vlerën 50.000 euro, përbëjnë sjellje të cilat u mbajtën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4 , pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me analizën financiare

90. Komisioni ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të janë në pamundësi financiare në vlerën prej 12.405.424 lekësh, që me burime të ligjshme të përballojnë shpenzimet dhe krijojnë pasuritë, nga të cilat 12.347.866 lekë para fillimit të detyrës dhe 57.558 lekë gjatë ushtrimit të detyrës.* Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke parashtruar në ankim disa pretendime që trajtohen në vijim.
91. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *pamundësia financiare gjatë detyrës në shumën 57.558 lekë (vetëm në vitin 2016) vjen për shkak të një gabimi të Komisionit, i cili llogarit si shpenzime në vitin 2016 shumën 180.000 lekë qira, ndërkohë që ai është larguar nga banesa me qira në Rrugën {***}, për në banesën e tij në {***}, që në shtator të vitit 2015.* Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur me ankimin në cilësinë e provës *faturat e paguara për OShEE-në për vitin 2016, që i përkasin banesës në {***}, Tiranë.* Në parashtrimet e depozituara në Kolegj, subjekti është tërhequr nga ky pretendim, duke konfirmuar se nuk bëhet fjalë për pagesa qiraje banimi në Tiranë, por për pagesa qiraje në qytetin e Gjirokastrës, ku ushtronte detyrën në këtë periudhë, ndërkohë që ka shtuar se veçimi në analizën financiare i periudhës 01.01.2016 -31.12.2016, nga periudha e vitit paraardhës 2015, është bërë qëllimisht nga Komisioni për ta nxjerrë atë me një diferencë sado të papërfillshme, edhe gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës. Për rrjedhojë të kësaj situate, trupi gjykues vlerëson, *së pari*, se vlera prej 180.000 lekësh, e zërit “shpenzime qiraje” në analizën e vitit 2016 të Komisionit, është e pasqyruar saktë. Sa i takon veçimit në analizën financiare të periudhave të cituara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se kjo metodologji e aplikuar drejt nga Komisioni, për shkak të regjimeve të ndryshme të kontrollit⁹³, nuk e impakton rezultatin final të analizës financiare e as konkluzionin përfundimtar të Komisionit për dhënien e masës disiplinore, parë edhe në këndvështrim të parimit të proporcionalitetit, sa kohë që në rastin konkret, për subjektin e rivlerësimit, si funksionar publik dhe i sistemit të drejtësisë në mënyrë të vazhdueshme, fakt që e bën njësoj të qenësishëm standardin e kërkuar nga një magjistrat për integritet⁹⁴, nuk konstatohet një, por disa problematika domethënëse.

⁹³ Në periudhën para fillimit të detyrës, kur subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues, analiza financiare është akumulative, ndërsa për periudhën pas fillimit të detyrës analiza financiare kryhet për çdo vit.

⁹⁴ Vendimi i GjEDNj-së në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë dhe A. Zeneli kundër Shqipërisë.

92. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *shuma prej 2.000 USD e marrë hua nga tezja, nuk i përket subjektit, por nënës së tij, e cila i ka përdorur për mobilimin e shtëpisë*. Për këtë arsye, shpenzimet e mobilimit prej 217.480 lekësh (2.000 USD) nuk duhet të përfshihen si shpenzime të subjektit, sepse nëna ka mobiluar banesën e saj dhe jo të subjektit. Në qoftë se do të përfshihen si shpenzime mobilimi, atëherë *shuma prej 2.000 eurosh e dhënë nga tezja duhet të njihet si e ardhur për subjektin*. Në ngritjen e këtij pretendimi, subjekti i referohet konkluzionit në paragrafin 2.15.8 të vendimit, sipas së cilit: *“Në lidhje me shumën 2.000 USD, marrë hua nga tezja, në interpretim të rrethanave dhe deklarimeve, Komisioni vlerëson se edhe për këtë hua subjekti nuk ka provuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje dhe as burimin e ligjshëm të kësaj shume. Në këto kushte, Komisioni nuk e ka pasqyruar atë në analizë financiare, por e ka paraqitur si shpenzim për punime në banesë në shumën 2.000 USD. Në analizë të këtij pretendimi, nga aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton se:*

92.1 Në deklaratë e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, të dorëzuar më datë 16.03.2004⁹⁵, në rubrikën *“Formulari A-5 Likuiditete”*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“2.000 dollarë në Bankën Amerikane, të marra borxh nga tezja me banim në Angli për nevoja personale”*. Të njëjtin deklarim ka bërë edhe në rubrikën *“Formulari A-8 Detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizikë”*, duke shtuar emrin e tezes, Z. Xh. dhe, si arsye të krijimit të detyrimit ka deklaruar: *“Për nevoja personale, kryesisht riparime të banesës”*. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së⁹⁶ më datë 22.09.2016, i pyetur mbi arsyen e marrjes së huasë nga tezja Z. Xh. dhe afatin e shlyerjes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *e kam marrë për rregullime shtëpie nga tezja në Angli dhe e kam shlyer pas vitit 2004, me këste minimale*. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua, si dhe për të specifikuar datën e kthimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁹⁷ se: *Huaja e marrë nga tezja ime Z. Xh. është në fakt një hua që kjo e fundit ia ka dhënë nënës sime Xh. K. për ta ndihmuar për kryerje të ndonjë punimi në banesën tonë. Unë thjesht kam qenë ndërmjetës i veprimeve të tyre huamarrëse dhe huadhënëse. [...] Tezja ime, banuese në Angli prej vitesh dhe në gjendje të kënaqshme financiare, e ka ndihmuar nënën time edhe me ndonjë shumë tjetër të ngjashme për nevoja të mobilimit të banesës, por këto kanë qenë marrëdhënie të tyre dhe unë pothuajse nuk përfshihesha në to. Unë kujtoj që tim ati iu desh disa kohë të kursente nga puna e tij si usta që t'i shlyente këto detyrime.*

93. Në vlerësim të pretendimit të subjektit, trupi gjykues, referuar analizës financiare, konstaton fillimisht se Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të vitit 2003 shumën 217.380 lekë/ 2.000 USD, në zërin *“Shpenzime Mobilimi”*. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues ligjor të kohës për të vërtetuar marrëdhënien e huasë me tezen e apo mundësinë financiare të saj për dhënien hua të shumës 2.000 USD, si rrjedhojë nuk ka provuar krijimin e saj me burime të ligjshme financiare. Në kushtet kur nuk provohet ekzistenca e marrëdhënies së huasë, si edhe mundësia financiare e tezes së subjektit, për krijimin e shumës 2.000 USD, me burime financiare të ligjshme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se *shuma 2.000 USD nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme e subjektit të rivlerësimit dhe nuk do të pasqyrohet në analizën financiare të vitit 2003*. Ndërkaq, trupi gjykues, referuar deklarimeve të interesave private të paraqitura më parë pranë

⁹⁵ Në këtë deklaratë, përbërja familjare deklarohet nga tre persona (subjekti, bashkëshortja dhe e bija).

⁹⁶ Sipas procesverbalit të datës 22.09.2016 mbajtur pranë ILDKPKI-së.

⁹⁷ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

ILDKPKI-së, të cilat, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr.84/2016, përbëjnë provë në këtë proces, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ pretendoi se kjo shumë ishte shpenzuar nga nëna e tij, e gjen të drejtë përfshirjen e kësaj shume nga Komisioni si shpenzim të kryer nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2003 në zërin “shpenzime mobilimi”.

94. Subjekti ka pretenduar se *shuma prej 1.402.100 lekësh e shpenzimeve gjyqësore të llogaritura nga Komisioni është e pavërtetë dhe përlllogaritja e tyre nuk ka asnjë bazë provuese, por është vetëm hamendësim. Gjithashtu, subjekti shpjegon se ka qenë edhe vetë shumë aktiv nga ana juridike në mbrojtjen e çështjes*⁹⁸ *dhe nuk ka paguar një shumë të tillë. Subjekti pretendon se i ka paguar vetëm 100.000 lekë avokatit, i cili është edhe shoku i tij i klasës.*

95. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton fillimisht se një pretendim i tillë ngrihet për herë të parë në ankim megjithëse zëri “shpenzime gjyqësore” në vlerën prej 1.402.100 lekësh ishte përfshirë në shpenzimet e vitit 2013 që në analizën financiare të rezultateve të hetimit.

Në aneksin 1 “Metodologjia e kryerjes së analizës financiare”, që i bashkëlidhet rezultateve të hetimit, shpjegohet se shpenzimet e pasqyruara në analizën financiare janë vendosur sipas deklarimeve të subjektit, ku për shpenzimet gjyqësore shpjegohet se *është marrë në analizë vlera 10.000 euro, sipas deklarimit të subjektit*, por pa saktësuar deklarimin që i referohet. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodike, në procesverbalin e ILDKPKI-së të vitit 2016, në deklaratën e pasurisë *vetting*, në pyetësorët gjatë hetimit administrativ në drejtim të faktit nëse janë kryer deklarime për shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet e gjykatave ku subjekti i rivlerësimit ka qenë palë në drejtim të faktit nëse është disponuar lidhur me shpenzimet gjyqësore, nuk rezultuan të deklaruara shpenzime gjyqësore. Ndërkaq, në vendimin⁹⁹ nr. {***}, datë 27.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket palëve, paditësa të kundërpaditur H. e Z. A. dhe të paditur kundërpaditësa Emror Kasaj dhe M. L., është disponuar, ndër të tjera, edhe në lidhje me shpenzimet gjyqësore, të cilat i ngarkohen palës së paditur kundërpaditëse, në vlerën¹⁰⁰ totale 304.000 lekë, vlerë që nuk rezulton e përfshirë në analizën financiare të Komisionit, qoftë në rezultatet e hetimit, qoftë në vendim. Në vijim të kësaj analize, nga një kontroll i imtësishëm i akteve në fashikuj, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ në mbështetje të deklarimit të tij se i ka dhënë hua në shumën 50.000 euro shtetasit M. L., subjekti, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ka paraqitur, ndër të tjera, edhe procesverbal “Për transkriptimin e regjistrimit të bisedës”, të datës 28.02.2019, të mbajtur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku nga bisedat mes dy shtetasve [Emror dhe L.], të regjistruara me telefonin e sekuestruar subjektit, ndër të tjera, shtetasi i quajtur Emror thotë: “[...] dhe përveç 50.000 eurove, 10.000 euro janë shpenzimet e gjyqit. Ta kam thënë. I ke me *future*”. Trupi gjykues konstaton se ky është i vetmi akt në të cilin përmendet vlera prej 10.000 eurosh si shpenzime gjyqësore, shumë e cila pas konvertimit të monedhës nga euro në lekë rezulton se përkon me shumën¹⁰¹ e vendosur në analizë nga Komisioni në vlerën 1.402.100 lekë. Në kushtet që një shpenzim i tillë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, në

⁹⁸ Duke iu referuar çështjeve gjyqësore për pasurinë “tokë 1.000 m² dhe objektit mbi të”.

⁹⁹ Kopja e vendimit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰⁰ Shpenzime gjyqësore: Taksë padie 12.000 lekë + taksë kundërpadie 12.000 lekë + shpenzime eksperti në vlerën 280.000 lekë, të parapaguara nga pala paditëse e kundërpaditur.

¹⁰¹ Kursi mesatar i euro-s për vitin 2013, sipas BoA, është: 140.21 lek; 10.000 euro * 140.21 lekë = 1.402.052 lekë.

kuadër të detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9049 i vitit 2003, i ndryshuar, apo sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet kur një deklarim i tillë nuk mbështetet në ndonjë vendim gjyqësor apo dokument financiar, trupi gjykues e gjen pa vlerë provuese këtë akt në drejtim të provueshmërisë së shpenzimeve gjyqësore. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi të përlllogarisë këto shpenzime, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 100.000 lekë. Sa i takon urdhrin nr. {***}, datë 19.06.2012, të Prokurorisë së Përgjithshme, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj, me qëllim reduktimin e shpenzimeve për periudhën që ai ka ushtruar detyrën e OPGj-së, konkretisht lidhur me një seminar dyjavor në periudhën 24.06.2012 - 07.07.2012, në vlerësimin e trupit gjykues, edhe nëse do të konsiderohej me vlerë të plotë provuese në drejtim të faktit që kërkon të provojë, do të sillte një përmirësim të lehtë në rezultatin financiar, por viti 2012 do të mbetej përsëri me balancë negative.

96. Në përfundim, trupit gjykues, pasi kontrollon analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke reflektuar në të qëndrimin e tij për disa nga pretendimet e subjektit, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes nga përkthimi dhe shpenzimet gjyqësore, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën 01.02.2000 - 31.12.2016, në vlerën (-) 11,084,355 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

97. Komisioni, në vendim, lidhur me kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se: *[...] mangësitë profesionale të evidentuara në veprimet apo mosveprimet e subjekti gjatë ushtrimit të detyrës, në të gjitha çështjet e analizuara në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pavarësisht se në bazë të parimit të proporcionalitetit çmohen si jo të mjaftueshme për aplikimin e pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për largimin nga detyra, kjo edhe për shkak të parashikimit të pikës 1/c të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim tërësor të tyre, ato e zbehin dukshëm përmbushjen e detyrës si prokuror, duke sjellë si pasojë cenimin e besimit të publikut të drejtësia, në këndvështrim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.* Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke parashtruar pretendimet që trajtohen në vijim;
98. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni ka tejkaluar kompetencën e tij në trajtimin e disa çështjeve penale jashtë periudhës së rivlerësimit apo për të cilat ka nisur shqyrtimin kryesisht, organi kompetent ILD (me vendimmarrjet e të cilës subjekti shprehet se do të njoftojë Kolegjin sapo të marrë njoftimin zyrtar nga ky institucion) e, për këtë arsye, gjetjet e rezultuara nuk duhet të merren në konsideratë.* Subjekti i rivlerësimit ka depozituar me parashtrimet e datës 28.05.2025 në Kolegj aktet si vijojnë: (i) shkresën nr. {***} prot., datë 10.09.2021, të ILD-së për përcjelljen e vendimit “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasja znj. E. S. ndaj disa magjistratëve mes të cilëve edhe për subjektin Emror Kasaj”; (ii) shkresën nr. {***} prot., datë 15.04.2024, të ILD-së për përcjelljen e vendimit “Për arkivimin pas verifikimit kryesisht të informacionit të bërë publik në media”.

98.1 Në shqyrtim të pretendimit të subjektit, në lidhje me trajtimin e çështjeve jashtë periudhës së rivlerësimit, trupi gjykues, në vijim të analizës në paragrafin 17.1 të këtij vendimi, vëren se Komisioni ka analizuar dhe i ka nënshtruar vlerësimit të tij, ndër të tjera, edhe procedimet penale me nr. {***}/2018 dhe nr. {***}/2019, adresuar respektivisht nga denoncuesit S. N.

dhe V. Ç., si dhe procedimet penale me nr. {***}/2020 dhe nr. {***}/2021, të trajtuara nga Komisioni mbi bazën e indicieve të marra nga mjetet e informimit publik, pra edhe përtej kufirit të sipërm të periudhës së vlerësimit, e cila është tre vitet e fundit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016 dhe shtrihet në periudhën 08.10.2013 – 08.10.2016. Këto procedime penale janë marrë në shqyrtim nga Komisioni pas denoncimeve të publikut apo referuar informacionit nga burime të hapura, në të cilat adresoheshin pretendime në drejtim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke plotësuar kushtet e dispozitës së sipërcituar për shtrirjen e periudhës së vlerësimit për aftësitë profesionale, për një periudhë më të gjatë kohore se sa tre vitet e fundit nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit, lidhur me faktin se për disa çështje ka nisur shqyrtimin kryesisht organi kompetent ILD, trupi gjykues vëren se ky pretendim adresohet nga subjekti në drejtim të procedimeve penale me nr. {***}/2018 adresuar nga denoncuesi S. N., si dhe procedimet penale me nr. {***}/2020 dhe nr. {***}/2021 të marra në shqyrtim mbi bazën e indicieve nga mjetet e informimit publik. Trupi gjykues, referuar jurisprudencës së Kolegjit, sipas së cilës pavarësisht se Komisioni ka përcjellë pranë këtij institucioni çështje të caktuara për inspektim, nga Kolegji është vlerësuar që ato të analizohen e të bëhen pjesë e vendimmarrjes së tij, çmon se një fakt i tillë nuk i përjashton çështjet e referuara nga subjekti, nga kontrolli në Kolegj në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, aktet e paraqitura me parashtrimet në Kolegj, cituar më lart, që lidhen me procedimet penale me nr. {***}/2020 dhe nr. {***}/2021, përveç mosplotësimit të kriterit formal, sipas nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, nuk kapërcejnë as kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” e ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e tyre duket e panevojshme apo pretendojnë të provojnë fakte që edhe nëse pranohen të vërteta nuk ndikojnë në vendimmarrjen përfundimtare.

99. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka anashkaluar raportin e organit ndihmës mbi profesionalizmin*, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së vendimit nr. 529, datë 09.05.2022 dhe rezultateve shtesë të hetimit¹⁰², vëren se Komisioni, në zbatim të neneve 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të tij të kryer nga Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, në analizimin e fakteve të denoncuar nga publiku gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, si dhe indicieve të marra nga mjete të informimit publik, në përputhje edhe me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me rolin e raporteve të organeve ndihmëse të procesin e rivlerësimit.
100. Trupi gjykues, në vijim të analizës së tij në paragrafin 16.1 të këtij vendimi, u ndal edhe në shqyrtimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, me të cilat ai kundërshton konkluzionin e Komisionit, mbi cenimin e besimit të publikut në drejtim të mangësive të konstatuara në kriterin e aftësive profesionale, duke marrë në analizë gjetjet dhe konstatimet e Komisionit në secilën prej çështjeve penale të trajtuara, sipas shkaqeve të ankimit si më poshtë.

Pesë dosjet penale të përzgjedhura me short

101. ***Në lidhje me dosjen nr. 1, vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 29.10.2016, për kallëzimin penal nr. {***}/2016***, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, me

¹⁰² Komisioni, me vendimin e datës 23.3.2022, ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, si dhe përfshirjen e dy komponentëve të tjerë të rivlerësimit duke riçelur hetimin për to.

arsyetimin se: (i) njoftimi i palëve mbi vendimin për mosfillimin e procedimit penal është detyrë e subjektit dhe jo e sekretarisë; (ii) subjekti i rivlerësimit në një kohë që nuk kishte kryer asnjë veprim tjetër hetimor, nga momenti i referimit të çështjes penale nga Komisariati i Policisë Gjirokastër, duhet të kishte marrë menjëherë vendim për mosfillimin e procedimit penal e jo pas 29 ditësh.

102. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *arsyetimi i Komisioni që vendimi për mosfillimin e procedimit penal duhet të merrej menjëherë, nuk përputhet me detyrimin sipas Kodit të Procedurës Penale, që asokohe nuk kishte të përcaktuar afat 15-ditor, e as me situatën e ngarkesës së jashtëzakonshme të punës së prokurorit, ku vendimmarrja e menjëhershme, referuar edhe rëndësisë së këtij vendimi për mosfillimin e çështjes penale, është e pamundur.*

102.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit dhe në dosjen e kallëzimit penal nr. {***}/2016, trupi gjykues konstaton se Komisariati i Policisë Gjirokastër i ka përcjellë në datën 30.09.2016, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër (në vijim “Prokuroria Gjirokastër”) materialet procedurale për veprën penale të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, në lidhje me kallëzimin penal të datës 28.09.2016 të shtetases M. S. ndaj të shtetases M. M.. Me vendimin e datës 29.10.2016, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Me shkresën nr. {***} prot., E.K, datë 30.11.2016, ky vendim i është njoftuar të kallëzuarës M. M.. Ndaj vendimit të mosfillimit, nuk rezulton të ketë ankim¹⁰³. Në shpjegimet e dhëna në kundërshtim të barrës së provës¹⁰⁴, subjekti ka shpjeguar se njoftimi i vendimit të pushimit, pasi prokurori ka marrë vendimmarrjen përkatëse, është detyrë administrative e sekretarisë, e cila njofton palët dhe institucionet përkatëse sipas rastit. Sipas tij, në rastin konkret, sekretaria ka ngatërruar palën të cilën duhet të njoftonte dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 30.11.2016, ka njoftuar të kallëzuarën, për të cilën nuk ka pasur detyrim për njoftim. Në lidhje me marrjen e vendimit, pas një periudhe prej 29 ditësh, subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si në ankim, cituar më lart.

103. Në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, vëren se në formën e tyre në vitin 2016, ato nuk parashikonin afat kohor për verifikimin e kallëzimit që duhet të kryhet nga prokurori përpara se ai të vendoste për zgjidhjen ligjore të çështjes. Këto afate janë trajtuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar¹⁰⁵. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti ka disponuar me vendim për mosfillimin e procedimit penal brenda afatit maksimal 30-ditor, nga data e mbërritjes së referimit të veprës penale në prokurori. Lidhur me njoftimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, neni 291 i Kodit të Procedurës Penale parashikon detyrimin e njoftimit menjëherë të vendimit për mosfillimin e procedimit penal palëve¹⁰⁶, duke

¹⁰³ Referuar raportit me nr. {***} prot., datë 18.01.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁰⁴ Subjektit i ka kaluar barra e provës: (i) vendimi i mosfillimit të procedimit penal nuk i është njoftuar kallëzueses në kundërshtim me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) vendimi i mosfillimit të procedimit është marrë nga subjekti pas 29 ditësh, në një kohë që meqenëse ai nuk ka kryer asnjë veprim tjetër hetimor; ky vendim duhet të ishte marrë menjëherë në përputhje me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

¹⁰⁵ I ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 27.10.2006 dhe udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm.

¹⁰⁶ Neni 291 “Vendimi për mosfillimin e procedimit”, në formën e tij në kohën e dhënies së vendimit nga subjekti, parashikonte: “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit”.

përcaktuar qartë përgjegjësitë e prokurorit edhe në drejtim të respektimit të afateve ligjore të njoftimit të vendimit. Ndonëse referuar dispozitave procedurale penale¹⁰⁷ njoftimi i akteve të prokurorit kryhet nga policia gjyqësore dhe sekretaria, në vlerësimin e trupit gjykues, është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë zbatimin e urdhërimit për njoftimin e palëve, si dhe të orientojë për kryerjen e veprimeve të nevojshme¹⁰⁸. Në konkluzion të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka respektuar parashikimet e nenit 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me njoftimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal kallëzuesit, situatë e cila afekton indikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së prokurorit për të mbikëqyrur pa vonesë aktet e nevojshme të njoftimit.

104. ***Në lidhje me dosjen nr. 2, vendim për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2015, datë 04.05.2016***, Komisioni ka konkluduar se: (i) subjekti i rivlerësimit kishte të gjithë informacionin e duhur nga dokumentacioni i referuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për regjistrimin e saktë të veprës penale në urdhrin e regjistrimit të veprave penale. Po kështu dhe vetë fleta e regjistrimit të veprave penale e depozituar nga subjekti në prapësime pasqyron saktë veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”; (ii) në vendimin e pushimit subjekti duhet të kishte disponuar në lidhje me provën materiale “automjet” meqenëse ai ishte një send, që u gjet afër vendngjarjes, për të cilin u kryen hetime, dhe që merr vlerën e provës materiale. [...] Nga subjekti i rivlerësimit nuk janë respektuar kërkesat e nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) në lidhje me shpjegimin se vendimi i pushimit nuk iu njoftua palëve nuk qëndron, pasi subjekti duhej t’ia kishte njoftuar këtë vendim Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë, e cila kishte referuar materialet procedurale të çështjes në prokurori, sipas përcaktimit në pikën 2 të vendimit të pushimit të çështjes; (iv) në lidhje me praktikën e gjetur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila nuk është e rregullt nga ana ligjore, autorizimi i lëshuar nga titullari nuk është i rregullt nga pikëpamja formale, pasi nuk ka numër protokolli dhe vulë. Në bazë të këtij autorizimi, shkresat e drejtuara subjekteve të tretë nën emrin e drejtuesit duhet të ishte emri i personit të autorizuar dhe jo emri i drejtuesit dhe firma e prokurorit. Subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me pikën 5.1 të urdhrin nr. 148, datë 09.05.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për caktimin e shkallës së hierarkisë në Prokurori”¹⁰⁹ (procedurë e ndjekur edhe për raste të tjera). ”.
105. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e mësipërme, duke parashtruar në ankim disa argumente, paraqitur në mënyrë të përmbledhur si vijon: (i) përshkrimi në urdhrin e regjistrimit, sipas së cilit çështja është regjistruar për veprat penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve” dhe veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes së narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278 dhe 283 të Kodit Penal dhe jo për veprën penale të “Trafikimit të mjeteve motorike”, të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, duket qartë se është një gabim material vetëm në dispozitivin e urdhrin përkatës, por jo në pjesën

¹⁰⁷ Në nenin 134 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se: “1. Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar; në format e parashikuara nga neni 133. 2. Dorëzimi i kopjes së aktit të interesuarit nga ana e sekretarisë ka vlerën e njoftimit. Dorëzuesi shënon në origjinalin e aktit faktin e dorëzimit dhe datën”.

¹⁰⁸ Në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod.

¹⁰⁹ “5.1 Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë dhe të prokurorive të apelit janë personat përgjegjës që komunikojnë zyrtarisht dhe përgjigjen për marrëdhëniet e prokurorisë që drejtojnë me prokuroritë e tjera ose me institucionet vendore në juridiksionin e tyre”.

arsyetuese të tij, madje edhe hetimet janë kryer në drejtim të veprës penale të parashikuar nga neni 141/a dhe jo për dispozitën që është shënuar gabimisht në urdhër; (ii) çështja është regjistruar pa autor dhe nuk është identifikuar ndonjë person si viktimë apo autor i dyshuar i ndonjë veprë penale, të cilëve duhet t'i ishte njoftuar kjo vendimmarrje; (iii) Policia e Shtetit nuk është subjekt i procedimit penal, por organ ligjzbatues, si edhe vetë organi i prokurorisë. Kur nuk ka elementë të ekzistencës së asnjë lloj figure të veprës penale sendi nuk mund të asgjësohet e as të konfiskohet apo t'i kthehet ndonjë personi përpara se dikush të paraqitet dhe të sjellë dokumentacionin përkatës; (iv) nënshkrimi në shkresën përcjellëse në emër të prokurorit të rrethit, ka qenë një praktikë e gjetur në atë prokurori, e autorizuar nga vetë prokurori i rrethit, sipas së cilës prokurorët i kanë nënshkruar vetë shkresat përcjellëse që i përkasin drejtpërdrejt çështjeve penale, e jo atyre administrative. Në analizë të këtyre pretendimeve, nga aktet e administruara nga Komisioni dhe ato në dosjen e procedimi penal me nr. {***}/2015, trupi gjykues konstaton se:

105.1 Subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar më datë 18.11.2015 regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve” dhe “Prodhim dhe mbajtje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 278 dhe 283 të Kodit Penal, pa autorë. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore¹¹⁰, subjekti i rivlerësimit ka vendosur më datë 30.01.2016, pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, në pjesën hyrëse të të cilit ka parashtruar se: *Pasi studiova aktet hetimore të administruara në çështjen penale nr. {***} të vitit 2015, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, pa autor, konstatova se në datën 18.11.2015 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, mbi bazën e materialeve të ardhura për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka regjistruar procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, e parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, pa autor. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: Nga aktet të cilat ndodhen në dosje, rezultat i veprimeve hetimore të kryera deri në këtë fazë, çmojmë se ndodhemi përpara veprës penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a të Kodit Penal. Por, me gjithë veprimet e kryera deri më tani, pavarësisht indicieve, nuk janë mbledhur prova të plota për autorësinë e tyre;*

105.2 Me vendimin e datës 27.04.2016, subjekti ka vendosur të rifillojë hetimet për procedimin penal nr. {***}/2015, i cili ishte pezulluar për mungesë të autorit të veprës penale në pritje të përgjigjes nga INTERPOLI, ndërsa, me vendimin e datës 04.05.2016, ka vendosur pushimin e tij, për mungesë të elementëve të veprës penale, duke arsyetuar se: *Nga analiza e akteve të mësipërme të këtij procedimi, konkludojmë se nuk jemi përpara elementëve të figurës së veprës penale të “Trafikimit të mjeteve motorike”, të parashikuara nga neni 141/a, pasi automjeti nuk rezulton të jetë i trafikuar. Për këtë automjet nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë kallëzim për vjedhje. Me shkresën nr. {***} prot. E.K, datë 30.09.2016, me lëndë “Në lidhje me disponimin e provës materiale”, drejtuesi i prokurorisë A. P. i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë, duke e informuar se në përfundim të hetimeve automjeti në fjalë nuk konsiderohet më provë materiale e këtij procedimi penal, shkresë që rezulton të jetë e nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit;*

¹¹⁰ Më datë 06.01.2016 është bërë këqyrja e automjetit, si dhe është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, nëse automjeti figuron i treguar në Shqipëri. Në përgjigjen e këtij institucioni, të administruar në organin e prokurorisë më datë 18.01.2016, informohet se automjeti nuk është regjistruar deri në datën 12.01.2016.

105.3 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, duke parashtruar të njëjtat argumente si në ankim, subjekti ka paraqitur: (a) fletën e regjistrimit të veprave penale, në të cilën evidentohet regjistrimi i procedimit penal nr. {***}, datë 18.11.2015, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, e parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal; (b) autorizim që mban datën 02.02.2015, lëshuar nga drejtuesi i prokurorisë A. P., sipas së cilit *autorizohen prokurorët, që përveç shkresave drejtuar të tretëve që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procedimet penale ose kallëzimet penale, të firmosin vetë shkresat përcjellëse të çështjeve që kanë në hetim, në emër të Prokurorit të Rrethit*, autorizim i cili nuk përmban vulën e Prokurorisë Gjirokastër.

- 106.** Bazuar në situatën e fakteve si më lart, në lidhje me konstatimin e Komisionit për mosregjistrimin e saktë të veprës penale në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, trupi gjykues vëren se në ndryshim nga urdhri për regjistrimin e procedimit penal për dy veprat penale të parashikuara nga nenet 278 dhe 283 të Kodit Penal, në të gjitha aktet procedurale të hartuara në vijim nga subjekti i rivlerësimit, qoftë vendimi për pezullimin e procedimit penal, qoftë vendimi për rifillimin e hetimeve, si dhe vendimi për pushimin e procedimit penal, referohet e arsyetohet mbi regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Një fakt të tillë e dëshmon edhe fleta e regjistrimit të veprave penale e depozituar nga subjekti me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, e cila pasqyron qartazi regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, datë 18.11.2015, për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, e parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Edhe nga verifikimi i veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të këtij procedimi penal, trupi gjykues vëren se veprimet hetimore të kryera prej tij nuk i përkasin dy veprave penale për të cilat është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal, por i përkasin veprës penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Në këto kushte, trupi gjykues, duke mos e përjashtuar mundësinë e një gabimi material në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal, çmon të mos e analizojë më tej këtë aspekt, duke e konsideruar si jo përcaktues në kontekstin e thelbit të shkaqeve të ankimit në drejtim të aftësive profesionale.

Në lidhje me konstatimin mbi disponimin e provës materiale, trupi gjykues, referuar nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që në vendimin e pushimit të çështjes¹¹¹, si i vetmi mjet procedural i parashikuar nga ligji për disponimin e provës materiale, të dispononte mbi provën materiale, duke përcaktuar se çfarë duhej bërë me automjetin pavarësisht ekzistencës ose jo të elementëve të ndonjë vepre penale. Referuar kësaj dispozite, edhe shkresa e drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, me lëndë “*Në lidhje me disponimin e provës materiale*”, në vlerësimin e trupit gjykues, konsiderohet si një mjet joprocedural i parashikuar nga ligji mbi disponimin e provës materiale. Kjo problematikë, në vlerësimin e trupit gjykues, afekton indikatorët e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së prokurorit për të interpretuar ligjin.

Sa i takon mungesës së njoftimit të vendimit të pushimit të procedimit penal, Drejtorisë së Policisë Gjirokastër, e cila kishte referuar materialet procedurale të kësaj çështjeje në prokurori, trupi gjykues vëren se referuar nenit 329¹¹² të Kodit të Procedurës Penale, kundër

¹¹¹ Në nenin 190 “Disponimi për provat materiale”, përcaktohet: “1. Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar: [...]”

¹¹² Neni 329, “Ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes përcaktohet se”: “1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. 2. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit, vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa kur pranon ankimin e të

vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatë i dëmtuari dhe i pandehuri. Në zbatim të kësaj dispozite, fakti që në rastin konkret subjekti i rivlerësimit nuk ia ka përcjellë vendimin e pushimit Drejtorisë së Policisë Gjirokastrë, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk sjell ndonjë pasojë në drejtim të ushtrimit të së drejtës së ankimit, pasi ky organ nuk legjitimohet të bëjë ankim.

Lidhur me nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit në shkresën përcjellëse në emër të prokurorit të rrethit, trupi gjykues, referuar Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”, të miratuar me urdhrin nr. 176, datë 09.10.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm¹¹³, vëren se dokumentet që dalin nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor nënshkruhen vetëm nga drejtuesi i prokurorisë ose funksionarë të përcaktuar prej tij me delegim. Këto shkresa vulojnë nga nëpunësit e protokollit vetëm nëse ato janë nënshkruar sipas rregullave të përcaktuara në rregullore. Në rastin konkret, megjithëse autorizimi i drejtuesit të prokurorisë, që autorizon prokurorët të nënshkruajnë vetë shkresat përcjellëse të çështjeve që kanë në hetim në emër të prokurorit të rrethit, i paraqitur nga subjekti me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, nuk përmban vulën e institucionit, vlerësohet se në kushtet kur kjo shkresë ka kaluar filtrin e punonjësve të protokollit, të cilëve u atribuohet kontrolli i kësaj procedure, mbeten të paqarta rrethanat lidhur me përgjegjësinë e nënshkrimit të shkresës nga ana e subjektit të rivlerësimit.

107. ***Në lidhje me dosjen nr. 3, vendim për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2016, datë 17.05.2016***, Komisioni ka arritur në konkluzionin se pretendimi i subjektit se është detyrë e sekretarisë që të njoftojë palët për vendimin e mosfillimit nuk qëndron, pasi neni 291 i Kodit të Procedurës Penale në paragrafin e parë pasqyron marrjen e vendimit nga prokurori dhe në paragrafin e dytë njoftimin e palëve, ndërkohë që nuk përcaktohet roli i sekretarisë për njoftimin.
108. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm, duke pretenduar se njoftimi i vendimmarrjes përfundimtare për çështjet penale është detyrim i sekretarisë, e cila mund ta ketë vonuar njoftimin për shkak të ngarkesës së punës. Sipas tij, pasi prokurori dorëzon materialin me shkresën përcjellëse të nënshkruar, nuk kontrollon dërgimin e saj me postë, pasi e merr të mirëqenë këtë detyrë ekskluzive të sekretarisë.

108.1 Nga analizimi i akteve në dosjen e Komisionit dhe në dosjen e procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, trupi gjykues konstaton se më datë 16.03.2016, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Gjirokastrë, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal. Me vendimin për pushimin e hetimeve të datës 17.05.2016, subjekti ka vendosur

pandehurit, ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin. 3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri”.

¹¹³Në nenin 45 të kësaj rregulloreje përcaktohet: “1. Dokumentet që dalin nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor [...], në varësi të llojit të tyre sipas përshkrimit të bërë përkatësisht në shkronjat “a” dhe “b” të nenit të mësipërm, firmosen vetëm nga : a) drejtuesi i prokurorisë së rrethit gjyqësor; b) funksionarë të caktuar (në mungesë dhe me porosi në rastet e mungesës apo me porosi për probleme që i janë deleguar nga drejtuesi i prokurorisë). 2. Nëpunësit e protokollit, vulojnë të gjitha shkresat që dalin nga prokuroria e rrethit gjyqësor, vetëm kur shkresat janë firmosur nga funksionarët e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. [...] Nëpunësit e protokollit, në rastet kur konstatojnë se shkresat që do të dalin jashtë prokurorisë së rrethit gjyqësor, nuk janë firmosur sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore, bllokojnë materialin duke vënë menjëherë në dijeni strukturën përgjegjëse. Nëpunësit e protokollit, në rastet kur konstatojnë se shkresat që do të dalin jashtë prokurorisë së rrethit gjyqësor, nuk janë firmosur sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore, bllokojnë materialin duke vënë menjëherë në dijeni strukturën përgjegjëse”.

pushimin e tij, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ky vendim iu është njoftuar palëve të interesuara OShEE dhe shtetasit A. Gj., përkatësisht me shkresat nr. {***} prot., datë 06.09.2016 dhe nr. {***} prot., datë 06.09.2016.

109. Bazuar në sa më lart, në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se neni 328 i Kodit të Procedurës Penale, në formën e tij në fuqi në datën e dhënies së vendimit të pushimit më datë 17.05.2016, nuk parashikonte afat për njoftimin e vendimit të pushimit¹¹⁴. Pavarësisht mungesës së një afati ligjor, trupi gjykues vlerëson se në rrethanat e faktit njoftimi i vendimit të pushimit të procedimit penal të interesuarve pas 3 muaj e 19 ditësh përbën një vonesë të pajustificueshme në veprimin e prokurorit. Sa i takon rolit të tij në njoftimin e akteve procedurale, sikurse arsyetuar më lart, referuar dispozitave procedurale penale është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë zbatimin e urdhërimit për njoftimin e palëve. Këto mangësi, në vlerësimin e trupit gjykues, afektojnë indikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, që lidhen me aftësinë e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.
110. **Në lidhje me dosjen nr. 4, kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. {***}/2016**, Komisioni ka konkluduar se: (i) zgjatja e afateve të hetimit nga subjekti nuk ka qenë e nevojshme, për sa kohë që në dosjen e referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë ka pasur veprime hetimore të kryera nga OPGj-ja, ku kishte prova të mjaftueshme për dërgimin në gjyq të të pandehurit. Po kështu, veprimet hetimore të urdhëruara nga subjekti duhet të ishin kryer nga OPGj-ja që me urdhrin e datës 25.03.2016; (ii) vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve është nënshkruar nga i pandehuri A. K., çka nënkupton se ai ka marrë dijeni, por ky akt nuk i është njoftuar të dëmtuarit OShEE, ashtu siç përcakton dhe paragrafi i tretë i nenit 324, ku citohet se “vendimi për zgjatjen e afatit të njoftimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”; (iii) vendimi i vleftësimit të sekuestros duhej t’i ishte njoftuar personit nën hetim në përputhje me përcaktimet e nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale¹¹⁵.
111. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këto konkluzione, duke parashtruar në ankim argumentet paraqitur në mënyrë të përmbledhur si vijojnë: (i) njoftimi i akuzës nuk presupozon përfundimin e hetimeve, pasi mund të jetë e nevojshme si në rastin konkret për të kryer detyra shtesë, në përfundim të të cilave situata juridike mund të ndryshojë; (ii) konstatimi se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk i është njoftuar palëve nuk qëndron, pasi ky akt rezulton i nënshkruar nga i pandehuri A. K.; (iii) njoftimi i vendimit për vleftësim sekuestro nuk është bërë pasi personi i dyshuar ishte shpallur në kërkim policor dhe ishte e pamundur gjetja dhe njoftimi i tij. Ky shtetas është njohur me gjithë dosjen në ngarkim të tij, përfshirë edhe vendimin për vleftësim të sekuestros në momentin kur është ndaluar dhe është caktuar masa e sigurimit.
112. Nga aktet në dosjen e procedimit penal me nr. {***}/2016, trupi gjykues konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar më datë 11.03.2015, regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”, e parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal, në

¹¹⁴ Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35, datë 30.03.2017, në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale, u shtua pika 2: “Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim duke u bërë të ditur të drejtën për t’u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”.

¹¹⁵ Neni 140 “Njoftimi i të pandehurit të lirë”, përcaktohet: “1. Njoftimi i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij kopjen e aktit. Kur nuk mund t’i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të”.

ngarkim të shtetasit A. K., mbi bazën e materialeve procedurale të referuara nga Drejtoria e Policisë Gjirokastrë¹¹⁶; (ii) me urdhrin e datës 25.03.2016, subjekti ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, brenda datës 30.04.2016, si: njoftimi i akuzës, marrja e shpjegimeve nga i pandehuri në prani të avokatit, si dhe njohja e tij me përfundimin e hetimeve; marrja e dëshmisë së penalitetit për këtë shtetas; administrimi i tabelës fotografike; dhe kryerja e veprimeve të tjera që do të dalin gjatë hetimit; (iii) me aktin për njoftimin e akuzës së datës 25.03.2016, subjekti ka marrë të pandehur shtetasin A. K., për veprën penale, “Vjedhje e energjisë elektrike”, e parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal; (iv) me vendim të datës 11.06.2016, subjekti ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve deri në datën 11.09.2016, argumentuar me qëllimin e kryerjes së veprimeve hetimore, si: marrja e dokumentacionit të kontrollit të ushtruar nga OShEE dhe librezës së pagesës së abonentit njehsuar me origjinalin, si dhe njoftimin e këtij vendimi personave të interesuar. Ky vendim rezulton i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes dhe nga shtetasi A. K., ndaj të cilit është ngritur akuza si lartcitur; (v) më datë 06.07.2016, subjekti ka vendosur dërgimin në gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. K., për kryerjen e veprës penale “Vjedhja e energjisë elektrike”, e parashikuar neni 137/2 i Kodit Penal.

113. Bazuar në sa më lart, *lidhur me konkluzionin e Komisionit se zgjatja e afateve të hetimit nga subjekti nuk ka qenë e nevojshme*, trupi gjykues vëren se neni 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, parashikon: “2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur [...]”. Në analizë të kësaj dispozite ligjore në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar në vendimin e tij të datës 11.06.2016 në drejtim të kompleksitetit të çështjes apo pamundësisë objektive për të përfunduar hetimin brenda afatit të parë tremujor. Ndonëse referuar nenit 34¹¹⁷ të Kodit të Procedurës Penale, akti i njoftimit të akuzës nuk nënkupton përfundimin e hetimit, në kushtet kur ky veprim procedural ndërmerret nga prokurori në fazën e hetimit paraprak, pasi janë kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe janë mbledhur të dhëna të mjaftueshme që çojnë në ngritjen e akuzës, pra zgjatja e afatit të hetimeve përtej këtij momenti procedural do të duhet të ishte e mirëargumentuar, në drejtim të moskryerjes së këtyre veprimeve përpara njoftimit të akuzës. Kjo mangësi afekton indikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, që lidhen me aftësinë e prokurorit për të kryer veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar tëmbledhjes së provave të nevojshme.

Lidhur me mosnjoftimin e vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve të dëmtuarit OShEE-së, trupi gjykues vëren se neni 324, pika 3 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se: “Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”. Në zbatim të kësaj dispozite në rastin konkret, por edhe të vendimit të datës 11.06.2016 për zgjatjen e afatit të hetimeve, sipas së cilit urdhërohet njoftimi i këtij vendimi të interesuarve, rezulton të jetë

¹¹⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2016, Drejtoria e Policisë Gjirokastrë i ka përcjellë Prokurorisë Gjirokastrë materialet procedurale: referimi i veprës penale nga OPGj; procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes; procesverbalet e deklarimit të personave që kanë dijeni për veprën penale të shtetasve I. V., A. K., J. S., A. B. dhe E. K.; procesverbal këqyrje marrje dokumentesh; procesverbal i sekuestrimit të provës materiale; procesverbal kërkimi i personit që nuk gjendet i shtetasit A. K.; kërkesë për shpalljen në kërkim policor të shtetasit A. K..

¹¹⁷ Neni 34, paragrafi 1 përcakton: “Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit”.

njoftuar për këtë vendimmarrje vetëm i pandehuri A. K., por jo pala e dëmtuar OShEE. Ndonëse njoftimi i akteve të prokurorit, sikurse arsyetuar më lart, nuk është detyrë që kryhet drejtpërdrejt prej tij, ai ka detyrimin të mbikëqyrë dërgimin e tyre tek palët.

Lidhur me mosnjoftimin e vendimit të vleftësimit të sekuestros personit nën hetim, trupi gjykues vëren se referuar nenit 301, pika 2¹¹⁸ e Kodit të Procedurës Penale, vendimi për vleftësimin e sekuestros i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet, dhe se ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë. Ky parashikim ligjor ka gjetur pasqyrim edhe në vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.03.2016, për vleftësimin e sekuestros, në të cilin është vendosur, gjithashtu, për njoftimin e këtij vendimi të interesuarve, si dhe faktin se ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë. Në zbatim të këtyre detyrimeve në rastin konkret, trupit gjykues nuk i rezultoi i dokumentuar komunikimi i këtij vendimi shtetasit A. K., i cili pavarësisht faktit se ishte shpallur në kërkim policor nga Drejtoria e Policisë Gjyrokastër më 09.03.2016, rezultoi të jetë marrë në pyetje në datën 15.03.2016, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

114. Mangësitë e mësipërme, në vlerësimin e trupit gjykues, afektojnë indikatorët e parashikuar nga neni 73, pika 2 dhe neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së prokurorit për të kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.
115. ***Në lidhje me dosjen nr. 5, procedimi penal nr. {***/2016, për veprat penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit” dhe “Plagosje e lehtë me dashje”, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “Në lidhje me mosnjoftimin e vendimit të vleftësimit të sekuestros dhe njoftimit të aktakuzës të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, subjekti nuk ka dhënë shpjegime të sakta. Nga dokumentacioni në fashikullin penal nuk rezultoi që këto dy akte, si dhe deklarimi i subjektit se nga ana e mbrojtësit janë marrë gabimisht kopjet e akteve me firmë duke lënë kopjet e tij pa firmë, mbeten në kuadër deklarativ dhe nuk rezultojnë t’u jenë njoftuar palëve në kuptim të neneve 301 (për vleftësimin e sekuestros) dhe 34 (njoftimi i aktakuzës) të Kodit të Procedurës Penale”.***
116. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se :*“Vleftësimi i sekuestros dhe njoftimi i akuzës i është njoftuar avokatit të caktuar kryesisht (i pandehuri vetë ishte deportuar në Greqi menjëherë) z. J. K., i cili është shpërblyer me urdhrin për shpërbllimin e mbrojtësit, datë 25.07.2017. Ky i fundit gabimisht duhet të ketë marrë kopjet e firmosura të këtyre akteve dhe ka lënë kopjet e tij. Ky fakt nuk është vënë re nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, që ka bërë njohjen me aktet dhe, po kështu, nga ana ime. Pra, përderisa organet policore të Drejtorisë Vendore të Kufirit Gjyrokastër, pas intervistimit të këtij shtetasi e kanë riatdhesuar në Greqi, vërtetuar kjo edhe me procesverbalin që gjendet në dosje, ka qenë e pamundur që aktet e mëpasshme t’i njoftoheshin drejtpërdrejt këtij të fundit. Për këtë arsye, për këtë shtetas, është caktuar avokat kryesisht, i cili përfaqëson këtë të fundit në të gjitha aktet që parashikon ligji procedural penal”.*
117. Nga verifikimi i akteve në dosjen e procedimit penal nr. {***/2016 dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar më

¹¹⁸ Neni 301, pika 2 përcakton: “2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t’i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros”.

datë 19.04.2016 regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit O. F. S.. Me vendim të datës 20.04.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur vlerësimin si të kryer në përputhje me ligjin të sekuestros së vendosur nga oficeri i policisë gjyqësore me procesverbalin e datës 17.04.2016 (për sendet e sekuestruara shtetasit S. F.), njoftimin e këtij vendimi të interesuarve, si dhe faktin se ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë. Më datë 21.04.2016, nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Gjirokastrë është urdhëruar largimi nga territori shqiptar i shtetasit O. F. S., duke caktuar një afat prej 7 ditësh për largimin e tij. Përmes aktit të njoftimit të akuzës të datës 10.05.2016, subjekti ka vendosur të marrë të pandehur shtetasin O. F. S., si dhe njoftimin e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Referuar procesverbalit “Për kërkimin e personit që nuk gjendet” të datës 17.06.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, rezulton se më datë 21.04.2016 shtetasi i sipërcituar është larguar nga territori i shtetit shqiptar dhe nuk gjendet. Me vendim për caktimin e mbrojtësit të datës 20.06.2016, subjekti ka vendosur caktimin si mbrojtës kryesisht të të pandehurit O. F. S., avokatin J. K., i cili rezulton të jetë shpërblyer sipas urdhrit të shpërblimit të mbrojtësit të datës 25.07.2016, lidhur me rastin objekt shqyrtimi.

118. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se referuar nenit 301, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, kopja e vendimit të vleftësimit të sekuestros i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet, dhe se ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Ky detyrim ligjor është pasqyruar edhe në vendimin për vleftësimin e sekuestros së datës 20.04.2016 të subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të këtyre detyrimeve në rastin konkret, nga verifikimi i akteve në fashikullin penal, trupit gjykues nuk i rezulton i dokumentuar komunikimi i kopjes së këtij vendimi shtetasit O. F. S., ndaj të cilit ishte regjistruar procedimi penal dhe i ishin sekuestruar sendet, i cili është larguar nga territori shqiptar më datë 21.04.2016, apo më së paku përpjekjet për njoftimin e tij. Gjithashtu, në zbatim të nenit 34, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilit akti i njoftimit të akuzës i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, si dhe aktit të njoftimit të akuzës të datës 10.05.2016, në të cilin urdhërohet njoftimi i palëve të interesuara, trupit gjykues nuk i rezulton i dokumentuar njoftimi i këtij akti të pandehurit apo mbrojtësit të caktuar kryesisht. Ky mosveprim, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk justifikohet me argumentin e subjektit se nga ana e mbrojtësit janë marrë gabimisht kopjet e akteve me firmë duke lënë kopjet e tij pa firmë. Këto mangësi, në vlerësimin e trupit gjykues, afektojnë indikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat, duke përfshirë mbikëqyrjen pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

Çështje penale të adresuara nga denoncimet e publikut

119. ***Në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2018***, të adresuar nga denoncuesi S. N., Komisioni ka arritur në konkluzionin se *në veprimet e subjektit janë vërejtur mangësi në drejtim të ndërmarrjes së hapave të duhur, plotësues proceduralë hetimorë, duke sjellë si pasojë favorizimin e shtetasit E. Gj. në drejtim të pafajësisë së tij. Pavarësisht këtyre mangësive, Komisioni i vlerëson ato si të pamjaftueshme për aplikimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për largimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, por në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje, Komisioni konkludon se veprimet e mosveprimeve të subjektit në këtë çështje konsiderohen në një masë të konsiderueshme, duke sjellë si pasojë cenimin e besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion,*

Komisioni ka arritur, pasi ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk e ka njoftuar shtetasin S. N. me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve në cilësinë e viktimës nga vepra penale, si dhe me përfundimin e hetimeve dhe aktakuzën, sipas përcaktimeve respektivisht të neneve 324 dhe 140 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit për shtetasin E. Gj., nga “Arrest me burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndërkohë që qëndrimi i tij në seancë kishte qenë për vazhdimin e masës së sigurimit; (iii) kryerja e një akti të tretë ekspertimi autoteknik në një kohë që të dy aktet e para kanë përcaktuar si shkak determinant të aksidentit veprimet e kryera nga shtetasi E. Gj., dhe nuk ka pasur kontradikta mes tyre.

120. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionet e mësipërme, duke parashtruar disa argumente, që në mënyrë të përmbledhur parashtrohen si vijon: (i) aktet e prokurorit i janë njoftuar të pandehurit, por duke qenë se ai refuzonte të merrte dijeni i janë dërguar në banesë nga OPGj-ja, e pas këtij momenti i janë njoftuar me shkresë zyrtare; (ii) vendimi i gjykatës për ndryshimin e masës së sigurimit nuk është ankimuar prej tij, pasi nga momenti i ekzekutimit të masës së sigurimit deri në përfundim të afatit të ankimit janë verifikuar shumë fakte, të cilat e zbehnin fajësinë e shtetasit E. Gj.; (iii) kryerja e një akti të tretë ekspertimi ka qenë, jo vetëm i justifikuar, por i domosdoshëm, pasi nuk është eksperti që përcakton fajësinë. Ka qenë pikërisht ekspertimi me pesë ekspertë që ka qenë bindës si për prokurorët edhe për gjykatën në të dyja shkallët; (iv) fajësia e të pandehurit është konfirmuar në të dyja shkallët e gjykimit, dhe se edhe prokurori tjetër që e zëvendësoi subjektin, pas hetimeve shtesë të kryera, arriti në të njëjtin konkluzion me të.

121.1 Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit nga aktet e fashikullit të procedimit penal me nr. {***}/2018 të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se: (i) me vendimin e datës 08.08.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2018, të regjistruar¹¹⁹ për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal, ndaj shtetasit E. Gj., si dhe të njoftojë me këtë vendim personat e interesuar; (ii) më datë 08.10.2018, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të shtetasit S. N., për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal; (iii) më datë 01.11.2018, është përpiluar njoftimi për përfundimin e hetimeve dhe akti i njoftimit të akuzës, sipas së cilës shtetasi S. N. është marrë i pandehur, ndërsa për shtetasin nën hetim E. Gj. hetimet duhet të pushohen; (iv) oficeri i policisë gjyqësore A. T. ka informuar prokurorin e çështjes Emror Kasaj se më datë 12.12.2018, ora 14:30, ka shkuar në banesën e shtetasit S. N. i shoqëruar nga avokati i tij z. Sh. M. për njoftimin e akuzës, pyetjen e të pandehurit, si dhe njoftimin e përfundimit të hetimeve. Ai ka informuar, gjithashtu, se më herët kishte komunikuar në telefon me avokatin e zgjedhur nga shtetasi S. N., z. A. B., i cili e kishte orientuar të shkonte në banesën e shtetasit S. N. dhe ta vinte në dijeni pa praninë e avokatit. Shtetasi S. N. në banesë nuk pranoi të firmoste procesverbalet e akteve respektive, duke e shoqëruar me fjalë fyese, për këtë arsye, oficeri është larguar nga banesa; (v) me shkresën nr. {***} prot., datë 17.12.2018, Prokuroria Gjyrokastër i ka përcjellë shtetasve S. N. e H. N., në {***}, Gjyrokastër, aktin për njoftimin e akuzës dhe aktin për përfundimin e hetimeve. Njoftimi është dërguar sërish me shkresën me

¹¹⁹ Nga parashtrimi i rrethanave të faktit rezulton se ky procedim penal lidhet me aksidentin rrugor, në të cilin janë përfshirë një automjet tip “Volkswagen” i drejtuar nga shtetasi E. Gj. dhe një mjet tip traktor që drejtohej nga shtetasi S. N.. Në aksident ka humbur jetën shtetasi K. N., i biri i shtetasit S. N..

nr. {***} prot., datë 18.02.2019; (vi) në prapësimet e tij, në kundërshtim të barrës së provës¹²⁰, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Nuk është e vërtetë që vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk iu është njoftuar palëve, pasi nga fashikulli i procedimit penal rezulton se për shtetasin e dyshuar E. Gj. ka nënshkruar nga të dyja faqet mbrojtësi me prokurë prej tij, avokat B. A., i dhomës së avokatisë Gjirokastër. [...] Për shtetasin e dyshuar S. N., njoftimi i këtij akti nuk është bërë, pasi në këtë datë emri i tij nuk ishte regjistruar si i dyshuar për veprën penale. Emri i tij si i dyshuar është bërë me urdhrin datë 08.10.2018, pas aktit të ekspertimit autoteknik, i cili e nxirrte atë si autor të dyshuar të veprës penale. Pra, ky shtetas nuk ishte në cilësinë e personit nën hetim dhe për këtë shkak nuk i është njoftuar ky akt në kohën e përpilimit të tij”*.

121. Bazuar në sa më lart, në lidhje me konstatimin mbi mosnjoftimin e akteve të prokurorit shtetasit S. N., trupi gjykues nuk evidenton ndonjë akt për njoftimin e shtetasit S. N. me vendimin e datës 08.08.2018, për zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, pavarësisht se në përmbajtje të tij subjekti ka urdhëruar njoftimin e personave të interesuar me këtë vendim. Ndonëse deri në momentin e marrjes së këtij vendimi, pra, më 08.08.2018, shtetasi S. N. nuk kishte marrë statusin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, të cilin e mori më datë 08.10.2018, apo atë të të pandehurit, të cilin e mori me ngritjen e akuzës ndaj tij më datë 01.11.2018, trupi gjykues vlerëson se vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve duhet t'i ishte njoftuar shtetasit S. N., si subjekt procedural në cilësinë e trashëgimtarit të viktimës (djali i tij, kishte humbur jetën nga aksidenti), në zbatim të parashikimit të neneve 58, pika 4¹²¹ dhe 324, pika 3¹²² të Kodit të Procedurës Penale. Ndërkaq, nga aktet e fashikullit, trupit gjykues i rezultojnë të dokumentuara përpjekjet e organit të prokurorisë në drejtim të njoftimit të akuzës shtetasit S. N., në cilësinë e të pandehurit. Në vlerësimin e trupit gjykues, mangësia e evidentuar afekton indikatorët e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së prokurorit për të interpretuar ligjin, si dhe neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së prokurorit për mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të hetimit.
122. Në lidhje me kryerjen e një akti të tretë ekspertimi, nga aktet e fashikullit të procedimit penal nr. {***}/2018, trupi gjykues konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit ka regjistruar më datë 27.03.2018, procedimin penal për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, pa autor; (ii) pas administrimit të aktit të ekspertimit autoteknik të datës 22.04.2018 të ekspertit S. K.¹²³, subjekti ka urdhëruar më datë 08.05.2018 regjistrimin e emrit të shtetasit E. Gj. për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal; (iii) me vendimin e datës

¹²⁰ Subjektit, ndër të tjera, i ka kaluar edhe barra e provës: Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal të datës 8.8.2018 nuk rezulton t'u jetë njoftuar palëve (S. N. dhe E. Gj.), në përputhje me nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale (në vendim, përveç nënshkrimit të subjektit Emror Kasaj, ka një firmë që nuk identifikohet). [...] Subjekti i rivlerësimit nuk u ka njoftuar përfundimin e hetimeve të pandehurit S. N., të dëmtuarës dhe trashëgimtares së viktimës H. N. dhe E. Gj., me cilësinë e personit të regjistruar në procedim penal, në kundërshtim me nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale. [...] Subjekti i rivlerësimit nuk i ka njoftuar akt-akuzën e datës 01.11.2018 të pandehurit S. N. apo mbrojtësit të tij në kundërshtim me pikën 1 të nenit 34¹²⁰ të Kodit të Procedurës Penale.

¹²¹ Në nenin 58, pika 4, përcaktohet: “Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të këtij neni. [...]”.

¹²² Neni 324, pika 3, përcakton: “3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe viktimës”.

¹²³ Sipas aktit të ekspertimit autoteknik të ekspertit S. K., shkaktar i aksidentit kanë qenë veprimet e gabuara në kundërshtim me dispozitat e Kodit Rrugor të drejtuesit të automjetit tip “Volkswagen”, E. Gj..

20.06.2018, bazuar në kërkesën e avokatit të shtetasit E. Gj., i cili kundërshtonte aktin e mëparshëm, subjekti ka vendosur kryerjen e riekspertimit autoteknik nga një grup prej tre ekspertësh¹²⁴; (iv) me vendimin e datës 25.09.2018, bazuar në kërkesën e mbrojtësit të shtetasit E. Gj., i cili pasi është njohur me aktin e riekspertimit të mëparshëm ka shprehur kundërshtime në lidhje me vlefshmërinë e përfundimeve të arritura, duke kërkuar riekspertim¹²⁵ për të sqaruar rrethana të pasqaruara, subjekti ka vendosur kryerjen e një riekspertimi autoteknik me 5 ekspertë¹²⁶; (v) më datë 08.10.2018, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të shtetasit S. N. për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290//3 i Kodit Penal, argumentuar me faktin se *nga analiza e të tre akteve të ekspertimit dhe sidomos nga analiza e aktit të riekspertimit autoteknik të datës 08.10.2018, me grup prej 5 ekspertësh, ka rezultuar se shkaktar për aksidentin është drejtuesi i automjetit tip Zetor me goma, shtetasi S. N.*; (vi) me kërkesën e datës 10.11.2018, subjekti ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të të pandehurit S. N. dhe pushimin e pjesshëm të hetimeve për shtetasin E. Gj.; (vii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (në vijim “Gjykata Gjirokastrë”), me vendimin nr. {***}, datë 22.06.2020, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit S. N., për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. {***} datë 13.01.2021.

123. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues konstaton se në funksion të veprimtarisë hetimore të këtij procedimi penal janë kryer tre akte ekspertimi autoteknik nga ekspertë të ndryshëm. Në dy aktet e para, ekspertë të ndryshëm kanë arritur në të njëjtin rezultat, duke nxjerrë si shkak të aksidentit veprimet në kundërshtim me Kodin Rrugor të drejtuesit të automjetit tip “Volkswagen”, E. Gj.. Ndërsa akti i tretë, i kryer nga një grup prej 5 ekspertësh, pas kërkesës së mbrojtësit të shtetasit E. Gj., i cili kishte shprehur kundërshtime mbi vlefshmërinë e përfundimeve të arritura nga akti i ekspertimit të mëparshëm, ka ndryshuar edhe kahun e përgjegjësisë penale, duke përcaktuar si shkaktar të aksidentit drejtuesin e mjetit tip “Zetor”, S. N.. Në vlerësim të rrethanave të faktit, si dhe në kushtet që veprimtaria hetimore e subjektit i është nënshtruar kontrollit gjyqësor nga gjykatat e të dyja shkallëve, nga ku është konfirmuar fajësia e shtetasit S. N. dhe nuk është konstatuar ndonjë vlerësim i gabuar i provave në drejtim të përgjegjësisë së tij, trupi gjykues, në këtë rast, e gjen të pambështetur konkluzionin e Komisionit.
124. Në lidhje me mosankimin e vendimit të gjykatës për ndryshimin e masës së sigurimit të shtetasit E. Gj., nga verifikimi i akteve në fashikull, trupi gjykues konstaton se Gjykata Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 17.05.2018, ka vendosur: *Zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të caktuar me vendim nr. {***}, datë 10.05.2018, të Gjykatës Gjirokastrë, ndaj shtetasit nën hetim E. Gj., duke i caktuar masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.* Megjithëse përkundër qëndrimit të mbajtur në gjykim, duke kërkuar vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, subjekti i

¹²⁴ Sipas aktit të riekspertimit autoteknik të datës 10.08.2018 të ekspertëve E. V., M. Gj. dhe M. B., shkaku kryesor i ardhjes së pasojës është shkelja e drejtuesit të mjetit veturë “Volkswagen Polo”, shtetasit E. Gj..

¹²⁵ Në vendim, pasqyrohet fakti se lidhur me shkaqet e kryerjes së ri-ekspertimit është paraqitur edhe një memo e datës 24.09.2018 me 12 pika dhe nga ri-ekspertimi kërkohet t’u jepet përgjigje 19 pyetjeve.

¹²⁶ Në aktin e riekspertimit autoteknik të datës 08.10.2018 të ekspertëve L. Gj., A. H., N. H., K. A. dhe K. Z., në përgjigje të pyetjes së fundit me nr.19, arrihet në përfundimin se: “[...] nëse drejtuesi i mjetit “Zetor” do të kishte respektuar normat e sjelljes së përcaktuara në Kodin Rrugor; nenin 152 (ndryshimi i drejtimit ai i korsisë ose manovra të tjera), ky aksident nuk do të kishte ndodhur”.

rivlerësimit nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës, trupi gjykues vlerëson se ankimi është një mjet procedural i parashikuar nga ligji¹²⁷ që ushtrohet rast pas rasti, sipas vlerësimit që bën prokurori dhe që mbështetet në interpretimin dhe logjikën e tij. Mosushtimi i ankimit, në rastin konkret ndaj një vendimi gjykate që ka vendosur në kundërshtim me qëndrimin e prokurorit në gjykim, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk përjashton mundësinë që vetë subjekti të ketë gjetur të drejtë vendimin e gjykatës në vlerësimin e bërë prej tij gjatë afatit të ankimit. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin që nga shqyrtimi gjyqësor përgjegjësia penale iu ngarkua shtetasit S. N., kurse për shtetasin E. Gj. u pushua hetimi.

125. ***Në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2019***, të adresuar nga denoncuesi V. Ç., Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti *pa marrë dijeni nëse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar apo ka marrë formë të prerë, ka vijuar me kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, duke konkluduar me një vendim pushimi, veprim që vjen në kundërshtim me nenet 414 dhe 415 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti duhet t'i kishte njoftuar vendimin e pushimit të çështjes kallëzuesit, në përputhje me pikën 2 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në bazë të kërkesave të parashikuara në nenin 140 të Kodit të Procedurës Penale.*
126. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar në ankim se ai nuk ka qenë në dijeni të faktit se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, e cila kishte rrëzuar kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes dhe kishte urdhëruar kryerjen e hetimeve shtesë ishte ankimuar në Gjykatën e Apelit, pasi nuk ishte njoftuar nga sekretaria e gjykatës. Ai ka shpjeguar se duke mos e menduar që kallëzuesi për shkak të çrregullimeve të tij mendore do të ankonte vendimin e dhënë në favor të tij, dhe në kushtet kur nuk ishte njoftuar për ankimin, ka kryer të gjitha veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata dhe në përfundim të tyre ka kërkuar sërish pushimin e çështjes. Nga ana tjetër, sipas tij, nuk ka asnjë dispozitë ligjore sipas së cilës ankimi në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake pezullon hetimet. Vendimi i pushimit nuk i është njoftuar kallëzuesit (i cili paraqitej pothuajse çdo ditë në ambientet e prokurorisë e gjykatës), pasi ai nuk pranonte të nënshkruante marrjen dijeni për kërkesën për pushim. Çështja është ende në fazën e hetimit dhe ende nuk ka përfunduar. Në mbështetje të pretendimeve të tij, që vlerësimi i aftësisë profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, subjekti i rivlerësimit përveç nenit E, paragrafi i 2-të i Kushtetutës ka referuar edhe vendimin nr. 33, datë 03.11.2021, të Kolegjit;

126.1 Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga aktet në dosjen e procedimit penal nr. {***}/2019, të administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se: (i) më datë 08.07.2019, subjekti i rivlerësimit më datë 15.03.2019 i ka kërkuar Gjykatës Gjirokastër pushimin e procedimit penal të regjistruar mbi bazën e materialit kallëzues të shtetasit V. Ç., për veprën penale “Vrasje me paramendim, e mbetur në tentativë”, e parashikuar nga neni 78/1 e 22 të Kodit Penal; (ii) Gjykata Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 15.01.2020, ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë për vazhdimin e hetimeve, duke caktuar afat për kryerjen e tyre brenda datës 31.03.2020; (iii) pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore (në datat 23.09.2020, 10.06.2020, 20.09.2020), subjekti i ka kërkuar sërish gjykatës në datën 15.12.2020 pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019; (iv) Gjykata Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 19.07.2021, ka vendosur mosshqyrtimin e kërkesës së prokurorit dhe

¹²⁷ Neni 249, pika 1 përcakton: “1. Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 244 të këtij Kodi, lejohet ankim brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës”.

kthimin e akteve, me arsyetimin se: [...] *kjo çështje nuk duhej dorëzuar nga ana e prokurorisë në gjykatë, për sa kohë nuk ka një vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, pasi bëhet fjalë për të njëjtën kërkesë dhe procedim penal që është duke u gjykuar. Gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim një kërkesë të gjykuar nga kjo gjykatë dhe për të cilën akoma nuk është dhënë një vendim i formës së prerë; (v) me shkresën nr. {***} prot., datë 05.04.2022, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka informuar subjektin e rivlerësimit se çështja penale me kërkesë V. Ç. me objekt “Pushimin e procedimit penal” (vendimi nr. {***}, datë 15.01.2020, i Gjykatës Gjirokastër) është ende në proces gjykimi, për shkak të ndryshimit të relatorëve dhe mosformimit të trupit gjykues.*

127. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues mori si fillim në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *çështja është në hetim dhe ende nuk ka përfunduar*. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues, me konsideratë qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit, sjell në vëmendje se zbatimi i nenit E, paragrafi 2 i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Këtë qëndrim, Kolegji e ka mbajtur pikërisht në vendimin (JR) nr. 33, datë 03.11.2021, të referuar nga subjekti në ankim, në vlerësim të faktit se kërkesa e subjektit të rivlerësimit/prokurorit për pushimin e çështjes penale ishte në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni. Në rastin konkret, objekt analizimi nga ana e Kolegjit mbi ankimin të subjektit nuk është vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal të datës 08.07.2019 në drejtim të mjaftueshmërisë së veprimtarisë hetimore, e cila ka qenë në shqyrtim gjyqësor në Gjykatën e Apelit Gjirokastër në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, por është veprimi procedural i subjektit të rivlerësimit për ndërmarrjen e hetimeve mbi bazën e një vendimi gjykate që ende nuk kishte marrë fuqi ligjore për zbatim, vlerësim i cili nuk afekton vendimmarrjen për këtë çështje. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se kjo çështje duhet të shtrihet nën efektin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është i pambështetur në ligj, si pasojë e një leximi të ngushtë të dispozitës dhe një thirrje jorelevante për zbatim të jurisprudencës së Kolegjit.

*Lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore nga subjekti, në zbatim të vendimit të Gjykatës Gjirokastër, i cili nuk kishte marrë formë të prerë, trupi gjykues vëren se referuar neni 462, pikat 1 dhe 3/a¹²⁸ të Kodit të Procedurës Penale, vendimet penale të gjykatës bëhen të ekzekutueshme vetëm pasi ato kanë marrë formë të prerë dhe, në kuptim të kësaj dispozite, vendime të formës së prerë janë ato ndaj të cilave palët nuk kanë ushtruar ankim brenda afatit ligjor. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e kësaj dispozite, duke kryer veprime hetimore në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 15.01.2020, të Gjykatës Gjirokastër, ndaj të cilit ishte ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Kjo sjellje e gabuar procedurale e subjektit të rivlerësimit, sipas trupit gjykues, nuk mund të justifikohet as me mungesën e dijenisë së tij mbi faktin që ndaj vendimit të gjykatës që kishte caktuar detyra për të ishte ushtruar ankim, sa kohë që është detyrë e tij të jetë i informuar mbi ecurinë e procedimit penal. Në vijim të këtij vlerësimi të*

¹²⁸ Neni 462 përcakton: “1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë.[...] 3. Janë vendime të formës së prerë: a) vendimi i gjykatës së shkallës së parë kur nuk ankimohet nga 263 palët brenda afatit ligjor, kur është i paankimueshëm ose kur nuk pranohet ankimi për shkaqet e parashikuara nga neni 420 i këtij Kodi”.

trupit gjykues, edhe konstatimi tjetër i Komisionit se kallëzuesit V. Ç. nuk i është njoftuar vendimi i pushimit të çështjes të datës 15.12.2020, i cili është marrë pas kryerjes së veprimeve hetimore gjatë kohës që vendimi i gjykatës nuk kishte marrë formë të prerë, konsiderohet parelevancë, përderisa trupi gjykues e vlerëson veprimin e subjektit të rivlerësimit në këtë rast si një sjellje të gabuar procedurale. Kjo mangësi, në vlerësimin e trupit gjykues, afekton indikatorët e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së prokurorit për të interpretuar ligjin dhe neni 74, pika 1 në drejtim të aftësisë së magjistratit për të kryer procedurat hetimore dhe gjyqësore në mënyrë efektive.

Çështje penale të trajtuara bazuar në indiciet e marra nga mjete të informimit publik

128. ***Në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2020***, Komisioni ka konkluduar se *rezultojnë mangësi në ndërmarrjen e hapave të duhur proceduralë dhe mbajtje qëndrimesh kontradiktore, problematika këto që nuk vlerësohen deri në atë masë sa që ndaj subjektit të aplikohet pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për largimin nga detyra, por në një vlerësim tërësor të kësaj praktike, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016*. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion, pasi ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 249 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës lidhur me zëvendësimin e masës së sigurisë ndaj të pandehurit R. J., në një kohë që në seancë gjyqësore kishte kërkuar rrëzimin e kërkesës, pasi sëmundja e bashkëshortes të këtij të fundit nuk ishte një rrethanë e re që ndryshonte situatën e tij; (ii) subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrim favorizues ndaj të pandehurit L. K., krahasuar me të pandehurin R. J., për faktin se megjithëse të dy ishin në të njëjtat rrethana me masë sigurie “Arrest me burg”, për të pandehurin L. K. ishte dakord me kërkesën për zëvendësimin e masës, ndërsa për të pandehurin R. J. i kërkoi gjykatës rrëzimin e kërkesës; (iii) subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 228, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Penale, pasi në zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me “arrest shtëpie” për të pandehurin L. K. duhet të kishte mbajtur parasysh precedentët e mëparshëm penalë (i dënuar për tri vepra penale ku për veprën penale më të fundit të vitit 2011 është dënuar me 7 vjet burgim), si dhe personalitetin e tij në drejtim të faktit që sapo kishte dalë nga burgu ishte përfshirë në veprimtari kriminale; (iv) subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 332, shkronja “gj” të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të pushimit ndaj dy të pandehurve, ndërkohë që gjatë shqyrtimit gjyqësor ka mbajtur qëndrimin për dërgimin e çështjes për gjykim.
129. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke parashtruar në ankim disa argumente që në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në sa vijon: (i) çështja është shqyrtuar nga gjykata në të dyja shkallët dhe është konkluduar me vendim të formës së prerë, duke i dënuar të pandehurit me burgim, sipas kërkesës së tij; (ii) mosankimi i vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest me burg” në masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” për shtetasin R. J. lidhet, jo vetëm me gjendjen e rëndë shëndetësore të bashkëshortes së tij, e cila nuk mund të kujdesej e vetme për fëmijët e mitur, por edhe me faktin se vetë gjykata e ka rrëzuar kërkesën e të arrestuarit për të caktuar si masë siguri “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) situata ka qenë e ndryshme për të arrestuarin tjetër L. K., për të cilin gjykata ka pranuar masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, i cili, për shkak të problemeve të rënda kardiale dhe me diabetin, i kishte kërkuar gjykatës caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” dhe jo masë të lehtë si ajo e

“Detyrimet për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”; (iv) dënimet e mëparshme të të arrestuarit nuk janë aspak vendimtare në caktimin e masave të sigurimit dhe se neni 229/2 i Kodit të Procedurës Penale i referohet vazhdimësisë dhe përsëritjes së veprës penale në procesin për të cilin caktohet masa e sigurimit dhe jo dënimeve për raste të mëparshme; (v) mosankimi i vendimit të gjykatës, për pushimin e çështjes për të arrestuarit R. J. dhe S. D., ka ardhur pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor ai është bindur ashtu sikurse gjykata se për këta dy shtetas vepra penale kishte mbetur në tentativë.

130. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të procedimit penal nr. {***}/2020, trupi gjykues konstaton se: (i) Gjykata Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 23.01.2020, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masave shtrënguese “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për personat nën hetim M. B., M. Z., S. D., R. J., L. K. dhe E. S., të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2020; (ii) me kërkesën e datës 10.07.2020, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës Gjirokastër, gjykimin çështjes në ngarkim të të pandehurve të cituar më sipër, akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe për njërin prej tyre¹²⁹ edhe për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, në banesë, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278/4 të Kodit Penal; (iii) Gjykata Gjirokastër, me vendimin e datës 5.10.2020, ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të 4 pandehurve L. K., M. Z., E. S. dhe M. B., për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, si dhe pushimin e çështjes penale për S. D. dhe R. J.; (iv) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2021, ka deklaruar fajtorë 4 të pandehurit për veprat penale cituar më lart; (v) pas ankimit ndaj këtij vendimi nga ana e të pandehurve, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 13.12.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Veç sa më lart, nga aktet në fashikull, trupi gjykues konstaton se: (i) me vendimin nr. {***}, datë 13.04.2020, Gjykata Gjirokastër ka rrëzuar kërkesën e shtetasit R. J. për zëvendësimin e masës së sigurimit, nga “Arrest në burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastër; (ii) më datë 01.06.2020, subjekti ka përpiluar aktin e njoftimit të akuzës, duke marrë, ndër të tjerë, si të pandehur edhe shtetasin R. J., për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”; (iv) me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2020, Gjykata Gjirokastër ka vendosur pranimin e kërkesës së R. J. dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” argumentuar me faktin: *“Mënyra e kryerjes së veprës penale, situata shëndetësore e bashkëshortes së personit nën hetim A. J. (grua e moshës së re, e cila vuan nga sëmundje të rënda, si ato në zemër dhe në uterus, pasqyruar në provat shkresore të administruara nga gjykata, dokumente mjekësor, në formën e kërkuar nga ligji), pasja e personit nën hetim e dy fëmijëve të mitur (sipas certifikatës familjare administruar si provë, djali i moshës 14 vjeç dhe vajza e moshës 9 vjeçe), si dhe pretendimi i të qenit përgjegjës për bashkëshorten dhe fëmijët e mitur, parë kurdoherë në raport me momentin procedural në të cilin ndodhet çështja (njoftimi i akuzës dhe përfundimi i hetimeve), janë elementë të cilët merren në konsideratë nga gjykata në zëvendësimin e masës së sigurimit me masën shtrënguese të përshtatshme. Gjatë gjyimit, prokurori Emror Kasaj ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe vendimi, pasi nuk është ankimuar, ka marrë formë të prerë.*

¹²⁹ Shtetasi M. B..

131. Bazuar në sa më lart, në lidhje me mosankimin ndaj vendimit të gjykatës, lidhur me zëvendësimin e masës së sigurisë ndaj të pandehurit R. J., nga aktet në fashikull, trupi gjykues vëren se përkundër qëndrimit të mbajtur në gjykim, duke kërkuar vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës që urdhëroi zëvendësimin e masës së sigurimit për këtë shtetas. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë se ankimi është një mjet procedural i parashikuar nga ligji¹³⁰ që ushtrohet rast pas rasti, sipas vlerësimit që bën prokurori dhe që mbështetet në interpretimin dhe logjikën e tij, vlerëson se mosushtrimi i ankimit në rastin konkret ndaj një vendimi gjykate, që ka vendosur në kundërshtim me qëndrimin e prokurorit gjatë gjykimit, nuk përjashton mundësinë që vetë subjekti të ketë gjetur të drejtë vendimin e gjykatës në vlerësimin e bërë prej tij gjatë afatit të ankimit, sikurse janë në këtë rast arsyet shëndetësore të bashkëshortes së të pandehurit, nevoja për përkujdesje ndaj dy fëmijëve të mitur dhe faza procedurale e çështjes pasi ishte njoftuar akuza dhe, si i tillë, u gjet parelevancë për vlerësimin e sjelljes së subjektit të rivlerësimit.
132. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit për qëndrim favorizues të subjektit të rivlerësimit për të pandehurin L. K., i cili i referohet faktit se për këtë të pandehur, megjithëse në rrethana të njëjta me të pandehurin R. J., subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit ishte shprehur dakord me kërkesën për zëvendësimin e masës, ndërsa për të pandehurin R. J. në gjykim kërkoi rrëzimin e kërkesës, trupi gjykues, referuar fashikullit të procedimit penal konstaton se i pandehuri L. K. me kërkesën e datës 27.01.2020 ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, argumentuar me faktin se gjykata nuk ka mbajtur parasysh gjendjen shëndetësore të bashkëshortes, rrethanat familjare dhe rrezikshmërinë e pakët që ai paraqiste e më pas në gjykim edhe me gjendjen e tij shëndetësore, pasi vuante nga diabeti, si dhe situatën e Covid-19. Gjykata Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 02.04.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi në vlerësimin e saj nuk rezultoi të ishin zbutur nevojat e sigurimit. Gjatë gjykimit, prokurori ka kërkuar rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 22.04.2020. Me kërkesën e datës 04.06.2020, shtetasi L. K. ka kërkuar sërish zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, për shkak të rrethanave që lidhen me situatën e pandemisë nga Covid-19, përkeqësimin e situatës së tij shëndetësore për shkak të luhatjeve me diabetin, shoqëruar me dokumentacion mbi gjendjen e tij¹³¹. Me vendimin (i shkurtuar) nr. {***}, datë 25.06.2020, Gjykata Gjirokastër ka vendosur pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”. Në analizë të kësaj situate faktesh, përveç fazës së njëjtë procedurale, pasi të dy të pandehurve iu ishte njoftuar akuza, trupi gjykues vëren se rrethanat e bëra prezent gjykatës në kërkesat e tyre në drejtim të argumentimit për ndryshimin e kushteve të sigurisë, në kuptim të nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, sikurse parashtruar më lart, kanë qenë të ndryshme, fakt që jo domosdoshmërisht do të kërkonte mbajtjen e të njëjtit qëndrim. Por në vlerësimin e trupit gjykues, ajo që do të merrte rëndësi do të ishte ekzistenca e kushteve për zëvendësimin e masës së sigurisë për dy të pandehurit, sipas parashikimeve të neneve 228 dhe

¹³⁰ Neni 249, pika 1 përcakton: “1. Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 244 të këtij Kodi, lejohet ankim brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës”.

¹³¹ Vërtetim i datës 05.06.2020, nga pleqësia e fshatit H., M., mbi sjelljen dhe përbërjen familjare të L. K.; informacion i datës 11.06.2020 nga Drejtoria e Burgjeve, mbi gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit L. K., shoqëruar me dokumentacion mjekësor; epikrizë e shtetases L. K. e datës 04.06.2020; vërtetim i datës 05.06.2020 nga Bashkia Mallakastër.

229 të Kodit të Procedurës Penale, të vendosur tashmë nga gjykata bazuar në kërkesat e të pandehurve, me aprovimin në gjykim të subjektit vetëm në rastin e L. K. dhe mosushtrimin e ankimit nga ana e subjektit ndaj vendimeve respektivë të gjykatës.

133. Në vijim të analizës në paragrafin më lart, trupi gjykues mori në analizë edhe argumentin e subjektit të rivlerësimit se *dënimet e mëparshme të të arrestuarit nuk janë aspak vendimtare në caktimin e masave të sigurimit dhe se neni 229/2 i Kodit të Procedurës Penale i referohet vazhdimësisë dhe përsëritjes së veprës penale në procesin për të cilin caktohet masa e sigurimit, dhe jo dënime për raste të mëparshme*. Ky argument i subjektit lidhet me konkluzionin e Komisionit se subjekti ka vepruar në kundërshtim me nenin 228, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Penale, pasi në zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me “Arrest shtëpie”, për të pandehurin L. K., duhet të ishin mbajtur parasysh precedentët e mëparshëm penalë. Trupi gjykues i Kolegjit, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, referuar dispozitave procedurale penale, neneve 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe Vendimit Unifikues nr. 7/2011, të Gjykatës së Lartë¹³², që ka interpretuar këto dispozita, vlerëson se kushtet paraprake për caktimin e masave të sigurimit, ndër të cilët edhe masat rënduese të parashikuara nga Kodi Penal, duhet të verifikohen qoftë në momentin e paraqitjes së kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, qoftë për zëvendësimin, revokimin dhe shuarjen e saj¹³³. Ndonëse që në kërkesën e parë për vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, subjekti i rivlerësimit përpos dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga shtetasi L. K., duhet të kishte verifikuar e arsyetuar edhe mbi dënimin për një krim të kryer më parë nga ky shtetas, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore të administruar në fashikullin penal¹³⁴, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur vendimmarrja e gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit të shtetasis L. K. nuk ka ardhur si pasojë e një vendimmarrjeje të subjektit të rivlerësimit, por bazuar në kërkesën e vetë të pandehurit e, më tej, subjekti ka kërkuar gjykimin dhe dënimin e tij, konfirmuar nga gjykata, mbetet e paqartë përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen parelevancë qëndrimin e tij për pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit të shtetasis L. K., në vlerësimin e sjelljes së subjektit të rivlerësimit.
134. Në lidhje me *mosankimin e vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes për të arrestuarit R. J. dhe S. D.*, trupi gjykues, me të njëjtin arsyetim si në paragrafët më lart, vlerëson se mosushtrimi i ankimit në rastin konkret, ndaj vendimit të gjykatës që ka pushuar çështjen penale për dy prej të pandehurve, për të cilët subjekti kishte ngritur akuzë dhe kërkonte gjykimin, nuk përjashton mundësinë që vetë subjekti të ketë gjetur të drejtë vendimin e gjykatës në vlerësimin e bërë prej tij gjatë afatit të ankimit, sikurse konfirmuar prej tij në ankim

¹³² Në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin unifikues se: [...] masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, sa herë që nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet paraprake dhe kriteret e rrezikut të parashikuara nga nenet 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Kjo gjendje “rreziku” mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjyimit. Vendimi lidhur me caktimin e masës së sigurimit apo për zëvendësimin, revokimin e shuarjen e saj jepet për gjendjen në të cilin është procedimi, për gjendjen në të cilën janë aktet, për rrethanat e faktit e të ligjit në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe shqyrtimit të saj nga gjykata [...].

¹³³ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendime_unifikuese_ne_vite_10678_1.php

¹³⁴ Referuar vërtetimit të gjendjes gjyqësore, rezulton se shtetasi L. K. është dënuar 3 (tre) herë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, 2 (dy) herë në vitin 2000, përkatësisht për veprën penale të vjedhjes dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe një herë në vitin 2011 për veprën penale të “Vrasjes me dashje” të mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 25 të Kodit Penal, duke u dënuar përfundimisht me 7 vite burgim.

se nga shqyrtimi gjyqësor ai ishte bindur se vepra penale e kryer nga këta dy shtetas kishte mbetur në tentativë dhe, si i tillë, u gjet parelevancë për vlerësimin e sjelljes së subjektit të rivlerësimit.

135. *Në lidhje me procedimin penal nr. {***} prot, i vitit 2016*¹³⁵, Komisioni ka arritur në përfundimin se rezultojnë mangësi në ndërmarrjen e hapave të duhur proceduralë, si dhe vlerësim i gabuar dhe kontradiktor i tyre, nga subjekti i rivlerësimit, problematika këto që nuk vlerësohen deri në atë masë sa që ndaj subjektit të aplikohet pika 4, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për largimin nga detyra, por në një vlerësim tërësor të kësaj praktike, Komisioni arrin në përfundimin se problematikat e konstatuara e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion, pasi ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota, sipas kërkesave të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, evidentuar në vendimet e gjykatave; (ii) në lidhje me zëvendësimin e masës së sigurimit, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse, pasi ai i referohet gjasave/mundësisë që autor i ngjarjes të ketë qenë shtetasi F. G. i vrarë [...], por që nga hetimi nuk rezultoi asnjë provë apo rrethanë që ta lidhë këtë shtetas me ngjarjen, ndërkohë në vendngjarje u gjet gjurma e gishtit e shtetasit E. M., për të cilin nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave rezultoi se subjekti nuk kishte kryer hetime të plota; (iii) subjekti ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale për zëvendësimin e masës së të pandehurit (E. M.) me masë më të butë në një kohë që i pandehuri ishte ende i dyshuar për vepra penale të rënda; (iv) në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohet mosnjoftimi i vendimit për zgjatje të afatit të hetimit për shkak të përdorimit të metodave speciale ashtu siç ka pretenduar subjekti.
136. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit, ka parashtruar në ankim disa argumente që paraqiten në mënyrë të përmblëdhur si vijojnë: (i) çështja është ende në fazën e hetimit dhe mbulohet nga sekretet hetimor (bashkëpunëtori i fundit i ngjarjes nuk është zbuluar dhe hetimet vazhdojnë nga policia e shtetit); (ii) nga ana e tij është kryer një hetim i plotë dhe se vendimi i gjykatës që nuk ka pranuar pushimin e çështjes është tërësisht abuziv, pasi veprimet hetimore të kërkuara prej saj, si vendosja në përgjim e shtetaseve O. S. dhe E. B., si dhe marrja e tabulateve telefonike të të dyshuarit, janë kryer më së miri prej tij; (iii) zëvendësimi i masës së sigurimit për shtetasin E. M. nga “Arrest në burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është kërkuar pasi nevojat e sigurimit tashmë ishin zbutur, sipas nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, si dhe çështja ishte duke shkuar drejt pushimit, pasi nga hetimi rezultoi se, me shumë gjasa, autori i dyshuar i veprës penale ishte shtetasi F. G., i vrarë në ish- ngjarjen e bllokut; (iv) gjurma e të dyshuarit E. M. nuk është gjetur në vendngjarje, por në një send të lëvizshëm, qese plastike, ku gjendeshin dy paketa cigaresh, e cila ndodhej në automjetin e autorit të identifikuar; (v) mosnjoftimi i vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve shtetasit E. M., lidhet me faktin se ishin duke u kryer hetime me metoda speciale hetimi dhe çështja në ngarkim të tij duhet të mbahej sekret deri në momentin e ndalimit. Me ankimin subjekti i rivlerësimit ka paraqitur tre vërtetime mbi bazën e vlerësuar që i përkasin shtetasve A. G., A. N. dhe E. M., punonjës të Drejtorisë së Policisë, si persona të ngjashëm në paraqitjen për njohje të shtetasës O. S. me të dyshuarin E. M.. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të fashikujve penalë me nr.

¹³⁵ Në aktet e fashikullit penal, viti i procedimit penal referohet edhe “2015”.

{***} të vitit 2015 dhe nr. {***} të vitit 2015, të përcjellë nga Prokuroria Gjirokastrë¹³⁶, trupi gjykses konstaton se:

136.1 Më datë 31.03.2015, Prokuroria Gjirokastrë ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, që ka të bëjë me vjedhjen me armë të banesës së shtetasit N. Ç. në qytetin e Tepelenës. Në datën 11.10.2016, është vendosur ndarja e çështjes penale nr. {***}/2015, në ngarkim të shtetasit E. I. për veprën penale të “Vjedhjes me armë”, të kryer në bashkëpunim, e cila është dërguar për gjykim, nga çështja në ngarkim të shtetasve të paidentifikuar deri në këtë fazë të hetimit për veprën penale të “Vjedhjes me armë” të kryer në bashkëpunim dhe “Plagosje e rëndë me dashje”, të parashikuar nga nenet 140-45 dhe 88 të Kodit Penal, e cila ka marrë numër procedimi nr. {***}. Më datë 10.11.2017, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar pezullimin e procedimit penal nr. {***} i vitit 2016, pasi me gjithë veprimet e kryera, pavarësisht indicieve, nuk janë mbledhur prova të plota për autorësinë e tij;

136.2 Më datë 11.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rifillimin e hetimit të procedimit penal nr. {***}, si dhe ka urdhëruar regjistrimin e emrit të shtetasit E. M., për veprën penale të parashikuar nga nenet 140-25, 278, 88-25 të Kodit Penal, argumentuar me faktin se sipas aktit të ekspertimit daktiloskopik krahasues nr. {***}, datë 01.10.2018, gjurma daktiloskopike e gjetur në vendin e ngjarjes, e shënuar me shkronjën “H”, i përkiste pikërisht atij¹³⁷. Pas këtij urdhri, nga ana e subjektit të rivlerësimit, janë kryer një sërë veprimesh hetimore¹³⁸. Me vendim të datës 11.01.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016 deri në datën 11.04.2019, si dhe njoftimin e këtij vendimi personave të interesuar¹³⁹. Nga përmbajtja e këtij vendimi, rezulton se zgjatja e afatit të hetimeve argumentohet me faktin se: *“Deri në këtë fazë të hetimit nuk janë administruar të gjitha tabulatet telefonike të kërkuara së fundmi, nuk është bërë e mundur pyetja e të gjithë dëshmitarëve që kanë të bëjnë me përdoruesit e këtyre numrave dhe nuk janë realizuar të gjitha ekspertimet e mundshme kryesisht grafike dhe atyre të ADN, nuk kanë përfunduar veprimet hetimore me mjete të specializuara, nuk është bërë shoqërimi i të dyshuarit dhe paraqitja për njohje e këtij të fundit”*;

136.3 Pas vendimit të mësipërm, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar më datë 21.01.2019 ndalimin e shtetasit E. M. argumentuar me faktin se: *“Nga tërësia e akteve hetimore të çështjes penale rezulton se ka prova që krijojnë dyshime të arsyeshme se shtetasit E. M., R. R. dhe një autor tjetër i paidentifikuar, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga nenet 140-25, 278, 88-25 të Kodit Penal. Vepra penale e parashikuar nga nenet 140-25, 278, 88-25 të Kodit Penal paraqet një rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Vetëm vepra e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal parashikon një dënim deri në 20 vjet burgim. Për shkak të dënimit të lartë të parashikuar për këtë lloj vepre, autori i dyshuar ka rrezik të largohet për t’iu shmangur përgjegjësisë”*. Gjithashtu, ka vijuar me kryerjen e një sërë

¹³⁶ Me shkresën kthim përgjigje me nr. {***} prot., datë 01.04.2022.

¹³⁷ Në kuadër të kryerjes së hetimeve për ngjarjen e ndodhur në Tiranë, në datën 04.10.2018, në vendin e quajtur ish-blloku, në të cilën mbeti i vrarë një shtetas dhe u plagosën dy të tjerë, iu morën deklaratimet dhe gjurmët daktiloskopike edhe shtetasit E. M..

¹³⁸ Është kërkuar informacion nga kompanitë e telefonisë celulare mbi të dhënat telefonike të shtetasit E. M.; është kërkuar lejimi i bisedave telefonike të numrit të telefonit të shtetasit E. M.; është autorizuar lejimi përgjimit të fshehtë fotografik ose me video në vende publike të këtij shtetasi, si dhe është kërkuar lejimi i përgjimit ambiantal në vende private, etj.

¹³⁹ Afati i hetimeve është zgjatur; më tej, edhe me vendimin e datës 11.04.2019, deri më datë 11.07.2019.

veprimesh të tjera hetimore¹⁴⁰, ndër të cilat, edhe kryerja në datën 22.01.2019 e veprimit të njohjes së shtetasit E. M. nga shtetasit E. B. dhe O. S.. Referuar procesverbaleve respektive rezultojnë se shtetasja E. B. ka deklaruar se nuk njeh asnjë nga personat që i janë paraqitur¹⁴¹ për njohje, ndërsa shtetasja O. S. cilës iu paraqitën, gjithashtu, për njohje të njëjtët shtetas, deklaroi se dyshon se mund të jetë shtetasi E. M.. Referuar deklarimeve të dhëna nga shtetasja E. B. në datën 12.07.2019, kjo shtetase ka deklaruar se pas dhënies së shpjegimeve në polici ajo ishte kërcënuar;

136.4 Me kërkesën e datës 23.01.2019, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të shtetasit E. M. të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vjedhja me armë e kryer në bashkëpunim”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe “Plagosja e rëndë me dashje”, të parashikuara nga nenet 140-25, 278 dhe 88-25 të Kodit Penal, si dhe vendosjen ndaj tij të masës shtrënguese “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, duke argumentuar se: *“1.Ndaj shtetasit në hetim ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se ka kryer veprën penale të parashikuar nga nenet 140-25, 88-25 të Kodit Penal; 2. Shkallën e rrezikshmërisë që paraqet vepra penale e parashikuar nga nenet 140-25,278, 88-25 të Kodit Penal, dispozitë në të cilën ligjvënësi ka parashikuar vetëm dënimin me burgim nga dhjetë deri në njëzetë vjet; 3. Rrezikun që i dyshuari të largohet për t’iu fshehur hetimit dhe përgjegjësisë penale, për shkak të masës së lartë të dënimit që parashikon vepra dhe për shkak të personalitetit të tij; 4. Personalitetin e të dyshuarit”*. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2019. Me kërkesën e datës 15.07.2019, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me masën e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, për shtetasin E. M., duke argumentuar se: *“Nuk ka dyshime të arsyeshme se autor i veprës penale është edhe shtetasi E. M.. Nga hetimi ka dyshime se autor i ngjarjes mund të ketë qenë shtetasi F. G., i vrarë në ngjarjen e ish-bllokut [...]. Hetimet do të vazhdojnë me gjetjen e numrit të tij të telefonit që ka pasur në kohën e ngjarjes dhe verifikimin e lidhjeve të tij me numrat e personave të përfshirë në ngjarje*. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata Gjirokastrë me vendimin nr. {***}, datë 17.07.2019;

136.5 Më datë 18.12.2019, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr.{***}, në ngarkim të të dyshuarit E. M., pasi ndaj tij nuk ka prova që provojnë se ai është autori i veprës penale, ndërsa me vendimin e datës 19.12.2019 ka vendosur pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}, për autorët e paidentifikuar të veprave penale “Vjedhje me armë” e kryer në bashkëpunim dhe “Plagosje e rëndë me dashje” e kryer në bashkëpunim. Gjykata Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 25.03.2021, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve, duke caktuar detyra konkrete¹⁴². Ky vendim, pas ankimit të Prokurorisë Gjirokastrë, përfaqësuar nga prokurori Emror Kasaj, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. {***}, datë 28.05.2021, me arsyetimin se:

¹⁴⁰ Është kërkuar lejimi i përgjimit të bisedave telefonike të numrit të telefonit të shtetasve O. S. dhe E. B., si dhe është autorizuar lejimi i përgjimit në vende publike të këtyre dy shtetaseve dhe shtetasit E. M., etj.

¹⁴¹ Janë paraqitur personat A. N., A. G., E. M. dhe E. M..

¹⁴² Të verifikohen deklaratimet e personit të dyshuar, lidhur me aktivitetin tregtar të ushtruar në ambientet e marra me qira prej tij së bashku me prindërit, si dhe të pyeten pronarët e dyqaneve; të verifikohet pranë QKB-së apo Drejtorisë Tatimore fakti nëse personi nën hetim dhe familjarët e tij janë të regjistruar për aktivitet tregtar; të merret informacion nga kompanitë telefonike mbi numrin e gjendur në vendngjarje apo numra të tjerë të përdorur nga personi nën hetim, si dhe vendndodhja e telefonit në ditën e vendngjarjes apo numra të përdorur nga familjarët e tij; të kryhen hetime të mëtejshme lidhur me dëshmitaren E. B., të kryhen verifikime në lidhje me babanë e të dyshuarit, si dhe shoqërinë e sigurimit në të cilën ai punon etj.

[...] Gjykata e Apelit gjen të drejtë disponimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për kthimin e akteve për hetime të mëtejshme. [...] në vendngjarje është gjetur gjurma e gishtit e shtetasit të dyshuar E. M., në një qese plastmase me paketa cigare të markës Marlboro. Në vendngjarje është gjetur, gjithashtu, edhe numri telefonik {***}, që nga hetimi ka rezultuar se ka pasur komunikime me deklaruesen E. B.. Prokuroria nuk ka kryer hetim të plotë për të sqaruar se në cilat rrethana është gjetur gjurma e gishtit të të dyshuarit në automjetin në vendngjarje, por ka marrë të mirëqena, pa verifikime të mëtejshme, deklaratimet e të dyshuarit E. M. [...]. Shtetasja O. S. gjatë paraqitjes për njohje ka ngritur dyshime se i dyshuari E. M. mund të jetë personi që ka drekuar me shoqen e saj E. B., në Durrës [...]. Prokurori merr të mirëqena dhe arsyeton bazuar në deklaratimet e shtetasës E. B., duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur faktit të deklaruar prej saj, se është kanosur kur është marrë vesh se është thirrur për deklarime në prokurori. Të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe që gjenden të drejta nga Gjykata e Apelit, konsistojnë pikërisht në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve të shtetasës E. B. dhe të dyshuarit E. M., pasi nga ecuria e deritanishme e hetimit rezultojnë të dhëna që duket se e e implikojnë këtë të fundit në kryerjen e veprës penale”. Pas vrasjes me armë zjarri të shtetasit E. M. më datë 13.11.2021, subjekti i ka kërkuar sërish gjykatës më datë 16.02.2022 pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, në ngarkim të të dyshuarit E. M..

137. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues mori si fillim në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çështja është ende në fazën e hetimit dhe për shkak të karakterit të saj mbulohet nga sekreti hetimor. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues, me konsideratë qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit, cituar në çështjen penale trajtuar më lart, dhe në kushtet kur në rastin konkret veprimtaria hetimore e subjektit të rivlerësimit që ka çuar në kërkesën për pushimin e çështjes ndaj shtetasit E. M., si dhe kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj tij, i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor në mënyrë përfundimtare, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çështja ndodhet nën hetim dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfshihet në kategorinë e çështjeve sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Sa i takon pretendimit të subjektit se çështja për shkak të karakterit të saj mbulohet nga sekreti hetimor, trupi gjykues vëren se në nenin 279, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se: “Aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve”. Në zbatim të kësaj dispozite në rastin konkret, trupi gjykues, referuar fakteve të parashtruara më lart, vëren se shtetasi E. M. nuk rezulton të jetë marrë i pandehur apo t’i jetë komunikuar akuza. Përpos faktit se në shkresën nr. {***} prot., datë 01.04.2022, të Prokurorisë Gjyrokastër, përmes së cilës i përcillen Komisionit kopje të njësuara të fashikujve penalë respektivë, nuk informohet se çështja përbën sekret hetimor, çështja penale, sikurse konfirmuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në prapësime, është një ndër tri çështjet e paraqitura nga vetë subjekti në kuadër të vlerësimit të aftësive të tij profesionale nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Për këto arsye, trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit.
138. Në lidhje me kryerjen e veprimeve jo të plota hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i veprimtarisë hetimore të kryer prej tij, si dhe referuar vendimeve gjyqësore të të dyja shkallëve të gjyqimit, trupit gjykues i rezulton një veprimtari e pamjaftueshme hetimore, në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë së shtetasit E. M.. Kjo pamjaftueshmëri veprimesh vihet re më së shumti nga detyrat që janë lënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjyrokastër,

nevoja e kryerjes të së cilave, në vlerësimin e trupit gjykues, evidentohet dukshëm nga faktet e dala nga hetimi, siç ishin rrethanat mbi prezencën e gjurmës së gishtit të këtij shtetasi në vendngjarje (citurat nga subjekti në vendimin për rifillimin e procedimit penal), deklaratimet e shtetasit O. S., që ngrinte dyshime se personi i paraqitur për njohje mund të ishte shtetasi E. M., apo deklaratimet e shtetasit E. B. për kanosje ndaj saj, të cilat linin situatën të pasqaruar, duke sjellë nevojën për kryerjen e verifikimeve të mëtejshme. Sa i takon akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me ankimin, pavarësisht mosplotësimit të kriterit formal, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, marrja e tyre duket e panevojshme edhe në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi mungesa e veprimeve hetimore e konstatuar nga gjykata nuk i atribuohet moskryerjes së veprimit procedural të paraqitjes për njohje nga shtetasja O. S., por ka të bëjë me mungesën e verifikimeve shtesë pas këtij veprimi hetimor.

139. *Në lidhje me zëvendësimin e masës së sigurimit për shtetasin E. M. nga “Arrest në burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, trupi gjykues, referuar kërkesave të subjektit të rivlerësimit fillimisht për caktimin e masës së sigurimit “Arrest me burg” ndaj shtetasit E. M. e më pas zëvendësimin e saj me masën “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, vëren se në rastin konkret zbutja e nevojave të sigurimit, në kuptim të nenit 260, pika 2¹⁴³ e Kodit të Procedurës Penale, i atribuohet rënies së dyshimeve të arsyeshme, mbi shtetasin E. M. se ai mund të ishte autori i veprës penale, që ekzistonin në momentin fillestar të caktimit të masës së sigurimit. Në rrethanat që, sikurse arsyetuar në paragrafin më lart, veprimtaria hetimore e subjektit të rivlerësimit u gjet e pamjaftueshme në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë së shtetasit E. M., trupi gjykues vlerëson se nuk rezulton të jenë përmbushur kushtet e dispozitës së sipërcituar, për zbutjen e nevojave të sigurimit e, për pasojë, kërkesa e subjektit, për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me masën e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” pas 6 muajsh, nuk është në përputhje me dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit.*
140. *Lidhur me pretendimin e subjektit se mosnjoftimi i vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve shtetasit E. M. lidhet me faktin se ishin duke u kryer hetime me metoda speciale hetimi dhe çështja në ngarkim të tij duhet të mbahej sekret deri në momentin e ndalimit, trupi gjykues, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht neneve 34/a¹⁴⁴ dhe 324/3¹⁴⁵, vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet t’i kishte njoftuar shtetasit E. M. zgjatjen e afatit të hetimeve ndaj tij, për sa kohë që marrja e statusit të personit të cilit i atribuohet vepra penale nga ky shtetas përmes urdhrit të datës 11.10.2018 duhet të shoqërohet me të drejtat dhe garancitë e parashikuara edhe për të pandehurin, një nga të cilat është edhe njoftimi i zgjatjes së afatit të hetimit. Pretendimi i subjektit se mosnjoftimi i këtij vendimi lidhet me faktin se ishin duke u kryer hetime me metoda speciale hetimi vlerësohet jobindës nga trupi gjykues për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit në vendimin e zgjatjes së afatit të hetimeve ka urdhëruar njohjen e të interesuarve me përmbajtjen e tij.*

¹⁴³ Në pikën 2, përcaktohet: “2. Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë”.

¹⁴⁴ Neni 34/a, pika 3 përcakton: “Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe”.

¹⁴⁵ Neni 324, pika 3 përcakton: “3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe viktimës”.

Mangësitë e mësipërme, në vlerësimin e trupit gjykues, afektojnë indikatorët e parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së prokurorit për të hetuar dhe për të ndërmarrë logjistikisht hetimin, si dhe nga neni 74, pika 4 në drejtim të aftësisë së prokurorit në mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

141. **Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2021**, Komisioni ka konkluduar se: (i) subjekti i rivlerësimit ka keqinterpretim të vendimit nr. {***}, datë 30.09.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për sa i përket adresës ku do të ekzekutohet masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, për të pandehurin M. S. Gjykata, me vendimin nr. {***}, datë 30.09.2021, ka specifikuar në pikën 2 të tij se: “Urdhërohet personi nën hetim M .S. të qëndrojë dhe të mos largohet nga banesa, të cilën do ta deklarojë në organin e ndjekjes penale për efekt të ekzekutimit të këtij vendimi”, ndërkohë që subjekti, në urdhër ekzekutimin e vendimit të masës së sigurimit të gjykatës, datë 30.09.2021, është shprehur se: “Me vendimin nr. {***}, datë 30.9.2021, bazuar në rrethanat e mësipërme, gjyqtari i seancës së masës së sigurimit ka bërë korrigjimin material të vendimit nr. {***}, datë 29.09.2021, duke zëvendësuar adresën e caktuar prej tij me një adresë që do të caktohet nga organi i prokurorisë”. Për këtë arsye, subjekti ka urdhëruar “shoqërimin e të dyshuarit M. S. për në banesë, e cila do të jetë konvikti i djemve në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë”; (ii) subjekti duhet të kishte ekzekutuar vendimin e gjykatës, por jo në një adresë të caktuar me iniciativën e tij, çka është në kundërshtim me nenin 237 të Kodit të Procedurës Penale, por ky veprim duhet të ishte bërë me vendim gjykatë; (iii) subjekti, në kërkesën për zgjatje afati hetimesh, nuk ka parashtruar shkaqe ligjore se përse duhen zgjatur hetimet edhe për tre muaj të tjerë; (iv) shpjegimet për mungesën e deklaratës së përkthyeses janë deklarative dhe të pa mbështetura në nenin 126 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni arrin në përfundimin se pavarësisht shkeljeve të konstatuara, në lidhje me këtë çështje, ato nuk konsiderohen të mjaftueshme deri në atë masë sa ndaj subjektit të aplikohet pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 për largimin nga detyra.
142. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të këtyre konkluzioneve, ka argumentuar se: (i) kjo çështje është ende në fazën e gjykimit në shkallën e parë; (ii) konkluzioni i Komisionit se prokurori në mënyrë të gabuar e ka vendosur të arrestuarin në një adresë tjetër të ndryshme nga ajo që do të caktonte vetë i pandehuri nuk qëndron, pasi i pandehuri ose avokati i tij nuk ka paraqitur një adresë të saktë për vendin ku kërkonte të ekzekutohej masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” (i arrestuari është shtetas italian dhe nuk ka banesë të vetën në Shqipëri); (iii) zgjatja e afatit tremujor ka qenë e justifikuar, pasi nevojitej njoftimi i akuzës dhe përfundimi i hetimeve; (iv) referuar praktikës gjyqësore, deklarata e përkthyeses merret në rastet e përkthimit të dokumenteve dhe jo në rastet e përkthimit gjatë deklarimit të shtetasit të huaj.

142.1 Trupi gjykues i Kolegjit mori fillimisht në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se çështja është ende në fazën e gjykimit të shkallës së parë, dhe se duhet të përfshihet në kategorinë e çështjeve të parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se Prokuroria Gjirokastrë, me shkresën nr. {***} prot., datë 01.04.2022¹⁴⁶, ka përcjellë në Komision fashikullin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2021, me sqarimin se ky procedim penal është dërguar për gjykim në datën 02.02.2022. Referuar akteve të këtij procedimi penal, trupi gjykues konstaton se me kërkesën e datës 02.02.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes nr. {***} të vitit 2021, në ngarkim të të

¹⁴⁶ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 04.04.2022.

pandehurit M. S., akuzuar për veprat penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 141/a/1 i Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 168/1 i Kodit Penal. Bazuar në shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se objekt analize në Kolegj janë veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit që lidhen me adresën ku do të ekzekutohej masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, caktuar ndaj personit nën hetim M. S., me vendimin nr. {***}, datë 29.9.2021, të Gjykatës Gjirokastrë, i korrigjuar me vendimin nr. {***}, datë 30.09.2021, të po kësaj gjykate, si dhe mosveprimi i tij në drejtim të marrjes së deklaratës së përkthyesit mbi shkaqet e përjashtimit, të cilat përbëjnë aspekte të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe, si të tilla, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor të themelit të çështjes. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, konkluzioni i Komisionit në lidhje me veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit lidhur me adresën ku do të ekzekutohej vendimi gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, si dhe ato në drejtim të marrjes së deklaratës së përkthyesit mbi shkaqet e mundshme përjashtimi, nuk mund të jenë objekt rivlerësimi, pasi çështja ishte ende nën shqyrtim gjyqësor nga subjekti në fazën e analizuar nga Komisioni e, për rrjedhojë, konkluzionet e Komisionit, pas kontrollit dhe vlerësimit të çështjes, nuk mund të shërbejnë si gjetje, të cilat duhet të analizohen në këndvështrim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

142.2 Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, që kundërshton konkluzionin e Komisionit mbi zgjatjen e afatit të hetimeve me tre muaj në mënyrë të pajustificuar, nga verifikimi i akteve të fashikullit penal, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 15.12.2021 ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve deri në datën 15.03.2022, për kryerjen e veprimeve hetimore si vijojnë: *“Të bëhet njoftimi i akuzës; të pyetet i pandehuri; të njihet i pandehuri me aktet të merret dëshmia e penalitetit; të njoftohet pa vonesë prokurori për përfundimin e këtyre veprimeve dhe të dorëzohet fashikulli”*. Pas ankimit të shtetasit M. S. ndaj këtij vendimi, Gjykata Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 18.01.2022, ka vendosur prishjen e vendimit për zgjatje të afatit të hetimeve dhe urdhërimin e prokurorit që të përfundojë hetimet brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit gjyqësor. Me kërkesën e datës 02.02.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes nr. {***} të vitit 2021 në ngarkim të të pandehurit M. S., akuzuar për veprat penale “Trafikimi i mjeteve motorike” e kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 141/a/1 i Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 168/1 i Kodit Penal.

Bazuar në këtë situatë faktike, trupi gjykues fillimisht vlerëson se referuar jurisprudencës së Kolegjit lidhur me aplikimin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, cituar në çështjet penale më sipër, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk bie në kushtet e ndalimit të parashikuar nga kjo dispozitë ligjore, për sa kohë që i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në mënyrë përfundimtare. Nga analizimi i përmbajtjes së vendimit të zgjatjes së afatit të hetimeve në raport me parashikimet e nenit 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar në vendimin e tij përmbushjen e kërkesave të kësaj dispozite ligjore në drejtim të kompleksitetit të çështjes apo të pamundësisë objektive për të përfunduar hetimin brenda afatit të parë tremujor, sikurse konfirmuar edhe nga shqyrtimi gjyqësor, i cili ka urdhëruar përfundimin e hetimeve brenda 15 ditësh. Kjo kohëzgjatje e pajustificuar konfirmohet edhe nga veprimi i subjektit për dërgimin e çështjes për gjykim brenda afatit 15-ditor të caktuar nga gjykata. Kjo mangësi afekton indikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, që lidhen

me aftësinë e prokurorit për të kryer veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, si dhe të mbledhjes së provave të nevojshme.

143. Për të gjitha sa u arsyetua më lart, trupi gjykues vlerësoi se mangësitë e evidentuara, të cilat nga Komisioni nuk janë konsideruar të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit është i paaftë në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, në vlerësimin e trupit gjykues, janë të vlefshme dhe u konsideruan në vlerësimin tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim pasi vlerësoi: (i) vonesat në njoftime apo mosnjoftime të palëve me vendimet e zgjatjes së afatit të hetimit, vendimeve për mosfillimin e procedimit penal, vendimeve të pushimit apo akteve procedurale; (ii) zgjatje të pajustificuara të afatit të hetimeve, në dy raste, të cilat së bashku me mangësitë në njoftime përbëjnë sjellje profesionale që cenojnë drejtpërdrejt të drejtat e palëve në aspektin e procesit të rregullt ligjor; (iii) mungesë veprimesh hetimore, konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor; dhe (iv) në një rast, kryerje e veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga gjykata e shkallës së parë, pa marrë vendimi i saj formë të prerë, sjellje që dëshmojnë për qasje të pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit. Këto mangësi, në vlerësimin e trupit gjykues, ndikojnë në cenimin e besimit të publikut tek organi i prokurorisë në drejtim të kryerjes së hetimeve të nevojshme dhe me efikasitet për ushtrimin e ndjekjes penale.
144. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të çështjes, sikurse evidentuar në paragrafët 36 dhe 89, mban në konsideratë edhe sjelljet e subjektit të rivlerësimit, shfaqur përmes veprimeve të tij lidhur me pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, të tilla si: (i) deklarime kontradiktore dhe qëllimisht jokohereente gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me çmimin e blerjes së objektit të ndërtuar mbi tokën arë me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Tiranë, si dhe mënyrën e pagesës së tij; (ii) deklaratimet e kryera lidhur me huanë e marrë nga shoqëria “{***}” ShPK në vlerën 140.000 euro, me qëllim për të mbuluar burimin real të huasë së dhënë shtetasit M. L. në vlerën 50.000 euro; (iii) deklaratimet e kryera lidhur me huanë e marrë nga vjehrra për të mbuluar burimin e vërtetë të shumës së dhënë hua në vlerën 50.000 euro. Këto veprime/deklarime të subjektit të rivlerësimit u konsideruan si sjellje të papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
145. Sjellja e subjektit të rivlerësimit për çështjet e kriterit të pasurisë, e ndërlidhur me problematikat e konstatuara në vlerësimin e aftësive profesionale, u vlerësuan nga trupi gjykues, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e përgjithshëm të kriterëve, duke konkluduar që subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
146. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 529 , datë 09.05.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 529, datë 09.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Emrror Kasaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 23.04.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi